

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

DREJTIMI: DIPLOMACI

TEZA:
DIPLOMACIA E PERANDORISË OSMANE DHE ÇËSHTJA
SHQIPTARE 1908-19012

Kandidati:
Ibrahim Ceka

Mentori:
Prof. Dr. Ali Pajaziti

TETOVË, Mars - 2017

Përmbajtja

Abstrakti.....	4
Апстракт.....	5
Abstract.....	6
Hyrje.....	7

Diplomacia e Perandorisë Osmane dhe çështja shqiptare (1908-1912)

KAPITULLI I PARË

1. Një Perandori duke perënduar

1.1. Organizimi politik dhe juridik i Perandorisë Osmane: historiku i përgjithshëm, veçanërisht 1908-1912.....	7
1.2. Perandoria Osmane si superfuqi botërore.....	10
1.3. Ideologjia frymëzuese në Perandorinë Osmane.....	14
1.4. Tatëpjeta e Perandorisë Osmane.....	16
1.5. Koncepti nacional-komb sëmundje shkatërruese e Perandorisë....	21
1.6. Zhbërja përfundimtare e Perandorisë Osmane në marrëveshjen e vitit 1924.....	22
1.7. Një gabim që duhej përmisuar (Perandoria Osmane nuk ishte turke).....	25

KAPITULLI I DYTË

2. Shqiptarët dhe Perandoria Osmane

2.1. Pozita e shqiptarëve në Perandorinë Osmane.....	27
--	----

2.2.	Personalitetet shqiptare në Perandorinë Osmane.....	34
2.3.	Roli i elitës politike shqiptare në formimin e idesë për pavarësi..	43

KAPITULLI I TRETË

3. Lëkundjet e Perandorisë dhe aspiratat nacionaliste, shembull: Kongresi i Manastirit

3.1.	Rruga deri tek mbajtja e Kongresit të Manastirit.....	46
3.2.	Alfabeti i Stambollit.....	48
3.3.	Kontributi i klerit mysliman në hartimin e alfabetit shqip.....	51
3.4.	Hasan Tahsini një figurë e ndritur e popullit shqiptar.....	57
3.5.	Delegatët e kongresit dhe hartimi i Alfabetit.....	60
3.6.	Shkolla e parë shqipe.....	61

KAPITULLI I KATËRT

4. Diplomacia Osmane dhe çështja shqiptare para dhe pas shpalljes së Pavarësisë

4.1.	Shqipëria "e pushtuar" që udhëhoqi Perandorinë Osmane.....	62
4.2.	Ndikimi i intelektualëve shqiptarë në Perandori.....	64
4.3.	Rrethanat dhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë.....	66
4.4.	Delegatët e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.....	69
4.5.	Qëndrimi i diplomacisë osmane pas shpalljes së shtetit të pavarur shqiptarë.....	83

Abstrakti

Diplomacia shqiptare në aspektin e analizimit dhe studimit të ngjarjeve historike, konsideroj që duhet edhe më tej të thellohet në gjurmimin e dokumenteve arkivore sa i perket të kaluarës sonë qindra vjeçare të sundimit osman në trojet shqiptare. Shpesh herë historiografia shqiptare ballafaqohet me vështirësi të përcaktimeve të sakta të ngjarjeve me rëndësi historike, dhe kjo në mungesë të eksplorimit të mjaftueshëm nëpër arkivat e dokumentacioneve osmane. Prandaj, mendojmë që një angazhim serioz i historianëve shqiptarë në hulumtimin dhe perkthimin e defterëve osman, do ta ndihmonte jashtëzakonisht historiografinë dhe diplomacinë shqiptare, në argumentimin real të ngjarjeve historike, dhe pa dyshim që literatura shqiptare do të pajiset me fakte të sakta, që do të na nevojiteshin për t'ia servuar popullit tonë të kaluarën tonë të lavdishme.

Periudha e sundimit të shtetit osman në trojet shqiptare, është periudhë mbi 450 vjeçare dhe një eksplorim serioz, diplomatike dhe politik mbi këtë periudhë të rëndësishme, do ta begatonte mjaftueshëm, në mënyrë faktike të kaluarën tonë historike.

АБСТРАКТ

Албанската дипломатија во однос на анализа и проучување на историските настани, констатирам дека треба дополнително да се продлабочи во пронаоѓање на архивски документи во однос на нашето минато на османлиското владеење на албанските земји. Албанската историографија честопати се соочуваа со тешкотии за точни претпоставки во однос на настаните од историско значење, и тоа во отсуство на доволно истражување во архивите на Отоманските документи. Затоа, ние веруваме дека сериозна посветеност на албанските историчари во истражување и преведување на Отоманските дефтери, ќе помогнеше многу за историографијата и албанската дипломатија во аргументација на вистинските историски настани, и несомнено дека албанската литература ќе беше обезбедена со точни факти, кои ќе служеа на нашите луѓе да им се сервира нашето славно минато.

Периодот на власта на Османлиската империја во албанските земји, е 450-годишен период и едно сериозно дипломатско, политичко и историско истражување за овој важен период, ќе го збогатеше доволно, нашето вистинско историско минато

Abstract

Albanian diplomacy in terms of analyzing and studying of historical events, I consider that it should be further researched and investigated thoroughly the archival documents concerning the hundreds of years of Ottoman rule in the Albanian lands. Albanian historiography often faced with difficulties on precise definitions of events with historical importance, and in lack of exploration in the archives of the Ottoman documents. Therefore, we think that a serious commitment of the Albanian historians is needed in researching and translating Ottoman's books, It will enormously help the Albanian historiography and diplomacy, in the real argumentation of historical events, and without a doubt that Albanian literature will be provided with accurate facts, that will be needed to give to our people our glorious past. The period of the Ottoman's state rule in the Albanian lands, is the 450-year period and a serious exploration, diplomatic and political on this important period, it will prosper it enough, in a factual way our historical past.

Hyrje

KAPITULLI I PARË

1.1. Organizimi politik dhe juridik i Perandorisë Osmane (aspekt i përgjithshëm)

Struktura e organizimit të jashtëm apo të brendshëm të qeverisë në Perandorinë Osmane na jep të kuptojmë se kemi të bëjmë me një arkitekturë interesante qeverisëse dhe mjaft strukturale të organizuar në mënyrë centraliste, mirë të organizuar dhe diciplinueshëm të aplikuar, për kundër faktit se bëhet fjalë për një sipërfaqe mjaft të madhe nën administrim, mbi 23.000.000 km² sipërfaqe tokësore të administruar nga kjo Perandori, që nga Afrika Veriore, Lindja e Afërt, Kaukazi e deri në Evropë. Kemi mbi dhjetëra popuj, nacionalitete të ndryshme si përbërëse të kësaj Perandorie, kultura, doke, zakone e gjuhë të ndryshme.

Duke pasur parasysh këtë diversitet të popullsisë brenda Perandorisë, menjëherë na bie ndërmend një art diplomatik qeverisës por jo edhe aq i lehtë në zbatimin e politikave të saj kur kemi parasysh këtë hapësirë bukur të madhe shtrirjeje.

Rritja e Perandorisë dhe shtrirja e saj në Evropë dhe Ballkan, paraqiti një sfidë të radhës e cila kishte të bëjë me zbatimin e lloj-llojshmërisë së ligjeve apo dokeve zakonore, ngase në çdo shtrirje të saj, në çdo ardhje të një territori ballkanik, ballafaqoheshte me tradita dhe zakone tjera. Mu për këtë, Porta e Lartë luajti një diplomaci elastike e cila përvetësonte kodet të cilat nuk binin ndesh me politikat e saj dhe ligjin e Sheriatit, dhe bëri një kodeks të veçantë me tradita dhe doke të ndryshme që i praktikonte në territoret e saj.

"Prandaj s'ka pse të habitemi kur në përmbledhjet e ligjeve të sulltanëve gjejmë edhe elemente të një legjislacioni tjetër, rrënjët e të cilit janë të ngulura thellë në struktura me zanafillë romake, bizantine, sllave, gjermanike ose mamluke"¹.

Baza juridike në të cilën mbështetej dhe qeverisej Perandoria Osmane ishin: Sheriati, legjislacioni i nxjerrë nga Kurani dhe tradita profetike, si dhe zakonet e popujve që ishin nën qeverisjen e perandorisë. Ndërkohë duhet merret në konsideratë se burimi i tretë, doket zakonore të popujve, zakonisht aplikoheshin në fushën e zhvillimit ekonomik, një politikë kjo e Portës së Lartë e cila synonte që përmes një tolerance të kësaj forme të kishte pajtueshmëri dhe afinitet në bashkëqeverisje nëpër vendet e ndryshme, një tolerancë e cila do të reflektoheshte në moskundërshtimin e vendeve ballkanike ndaj perandorisë në fjalë.

Burimet e së drejtës në perandorinë osmane ishin dy, përmes të cilëve rregullohej jeta, fushëveprimi i perandorisë.:

- E drejta e sheriatit si ligji suprem, i shtrirë në të gjitha fushat dhe porët e jetës, dhe

¹Robert Matrant, *Historia e Perandorisë Osmane*, perkth. Asti Papa, Dituria, 2014, f. 121

E drejta kanunore – laike, pak e aplikueshme, që nuk cenonte legjislacionin islam në perandori

E drejta kanunore realisht ishte një kodeks i cili zbatohej në fushën ekonomike, i njëjti nuk bine ndesh me kodeksin e sheriatit.

Sulltani / Kalifi

Sulltani është udhëheqësi juridik dhe politik i perandorisë, njeriu numër një në udhëheqjen e shtetit osman i cili përfaqësonte Perandorinë brenda dhe jashtë saj. Kjo pozitë në Perandorinë Osmane ishte e rezervuar ekskluzivisht për turqit, rregull që kanë perandoritë për trashëgimin e këtij posti.

Vizareti / Vezirët

Vezirët osmanë ishin përfaqësues të shtetit osman të emëruar nga Sulltani që ishin të ngarkuar me përgjegjësi dhe autoritet në zona të ndryshme administrative. Shpeshherë termi vezir njihet në literatura të ndryshme të historisë si sinonim i fjalës ministër, emërtim që nuk është e saktë, për arsye se sot ministri është i kufizuar, brenda një përgjegjësie të veçantë, është i ngarkuar me një detyrë të caktuar, p.sh., Ministri i Ekonomisë, Financave, Drejtësisë etj. Kurse Veziri kishte autoritet të plotë që të merrte vendime në emër të sulltanit dhe të nënshkruante ferman (dekrete) të sulltanit dhe posedonte nën përgjegjësinë e vet të drejta më të mëdha se sa të tipit ministër të sotëm. Veziri ishte dhe një gjeneral ushtrie, njëkohësisht ishte dhe një guvernator i përgjithshëm i një pjese të territorit administrativ nën perandorinë, siç ishte Ali Pasha guvernator i Egjiptit ose Mahmut Pasha guvernator i Rumelisë.

"Veziri osman kishte autoritet të plotë. Mbante *muhr-i hymajunin* (Vulën e Halifit-Sulltanit) dhe vepronte në emër të sulltanit; ai vuloste dokumentet zyrtare me këtë vulë. Për ca kohë edhe vezirët kishin të drejtën të shkruanin fermane (dekrete të sulltanit) dhe të vendosnin *tugra* (emri i sulltanit i shkruajtur me një shkrim elegant) mbi to.²"

Duke parë që vezirët në perandori kishin funksion të rëndësishëm dhe praktika e këtij institucioni shtetëroë tregonte rezultat, u pa e arsyeshme që në kuadër të emërimit "vezir" i thjeshtë të jetë dhe emërtimi "vezir i madh" emërtim ky që tregon dhe për autoritet më të zgjeruar, dhe siç do ta shohim se një emërtim i këtillë ju dha Ali Pashës i cili emërohet pas babait të tij Hajredin Pashës i cili kishte titullin vezir, pas vdekjes së Ali Pashës, vendin si vezir e zuri biri i tij, Ibrahim Pasha dhe pas vdekjes së Ibrahimit në vendin e tij si vezir i madh kaloi djali i tij Halil Pasha, post të cilin e mbajti për 25 vite. Veziri i parë ishte Alaedin Pasha.

Për ta ditur autoritetin dhe përgjegjësinë e vezirit të madh, i referohemi fjalës së Sulltan Mehmetit II: "Ta dini se kryeveziri është, mbi të gjitha, kreu i vezirëve dhe i komandantëve. Ai është më i madh se të gjithë njerëzit; ai është, në të gjitha çështjet, mëkëmbësi absolut i sulltanit. Defderdari është mëkëmbësi i thesarit, por nën mbikëqyrjen e kryevezirit. Në të gjitha mbledhjet dhe në të gjitha ceremonitë, kryeveziri zë vend përpara të tjerëve³"

Me të drejtë mund të themi se veziri i madh ishte zëvendësi meritator i sulltanit; pothuajse të gjithë krerët institucioneve tjera paraqiteshin tek veziri i madh, përfshirë edhe vezirët tjerë.

² Mehmet Maksudoglu, *Historia Osmane dhe Institucionet*, f. 617

³ Halil Inalcik, *Perandoria Osmane: Periudha klasike 1300-1600*, f. 126

Divani

Divani është një entitet që kishte për detyrë zbatimin e politikave të perandorisë në nivel qendror, dhe ky institucion vete kishte mbledhur të gjitha institucionet tjera varëse të niveleve të ndryshme perandorake. Me të drejtë divanin mund ta quajmë si **Këshill Perandorak**. Nga këtu delegoheshin urdhërat dhe merreshin detyrat për të zbatuar politikat e perandorisë.

Ky këshill perandorak më vonë do të quhej edhe *Divan Hymajun* që nënkupton diçka qiellore, gjë me rëndësi, dhe kjo aludonte në atë se Perandoria Osmane njëhej si perandori islame, se në vete kishte organizim islam, udhëheqja bëhej sipas librit fetar islam-Kur'anit, mu për këtë quhej hyjnore-qiellore. Por jo vetëm kjo, të gjitha institucionet tjera të rëndësishme brenda perandorisë ishin të emëruar me (hyjnore):

- Dekreti i Sulltanit-Halifit Osman quhej **Hatt-ë Hymajun** (Dekret Hyjnor)
- Vula e Sulltanit quhej **Myhr-i Hymajun** (Vula Hyjnore)
- Ushtria osmane **Ordu-ju Hymajun**(Ushtria Hyjnore)
- Flota detare **Donanma -jë Hymajun** (Flota Detare Hyjnore)⁴ etj.

Divani përbëhej prej disa vezirëve, dy **kadiaskerë** (gjykatësve ushtarakë) ai i Rumelisë, i Evropës osmane dhe i Anadollit si dhe Kadiu apo gjykatësi i Stambollit.

Sipas përgjegjësive që kishin, emëronin gjykatës në zonat e tyre ku ishin përgjegjës dhe ushtronin autoritetin e tyre në ato vende.

Gjithashtu në divan bënte pjesë dhe **Shejhulislami** (kryedijetari), pozita e të cilit ishte mjaft e rëndësishme.

Shejhulislami mbante pozitë thujtë të ngjashme me një Sadrazem apo kryeministër, në fushën e arsimit dhe gjykatës ishte supremi në perandori, jepte fetva (përgjigje), vendim, zgjidhje për probleme të caktuara brenda territorit të perandorisë në pajtim me ligjin islam. Shteti osman kishte për detyrë që në të gjitha problemet dhe gjykimet të merrte pëlqimin e tij, ngase ky ishte personi më i ditur në fushën e jurisprudence islame. Pozita e tij ishte aq e lartë sa që edhe Sulltani mund të shkarkohej por vetëm me urdhrin dhe fetvanë e tij.

Një **nishanxhë**, i cili mbante korrespondencën zyrtare.

Defterdari si përgjegjës financiar.

Aga i jeniçerëve ishte komandanti i përgjithshëm i Jeniçerëve.

Bolyk Agallarë ose komandantët e njësive të ushtrisë.

Shkruesit e divanit ose procesverbalistët.

Cila në të vërtetë ishte pozita e Divanit? Funkcioni i këtij institucioni kishte karakter gjykues dhe vendimmarrës. Ky këshill mbledhej çdo ditë pas namazit të sabahut dhe kryesohej nga vetë sulltani. Vinin njerëz të ndryshëm të nacionaliteteve të ndryshme dhe paraqiteshin ankesat e tyre tek këshilli, ku dëgjoheshin me vëmendje dhe pastaj merrej vendim për to. Roli i Divanit ishte i fuqishëm ngase ankesat dëgjoheshin drejtpërsëdrejti nga vetë Sulltani dhe rastet gjykoeshin aty pas një diskutimi mes anëtarëve të këshillit, pra kishte dhe rolin e

⁴ Maksudoglu, , f. 618

gjykatës supreme.

1.2. Perandoria Osmane si superfuqi botërore

Shteti Osman ka qenë gjithnjë në ndryshim – një rrjet islamik i përbërë nga vendet e bregdetit të Mesdheut (përveç Italisë) – zanafillën e ka pasur në vitin 1299 dhe kurse fundin afro 700 vjet më vonë.

Emri i këtij shteti të madh vjen nga themeluesi i parë i dinastisë, Osman I, i cili udhëhoqi Perandorinë. Zona e njohur si Anadoll, ose Azia e Vogël, ishte e ndarë në shtete të shumta turke pas përfundimit të principatës mesjetare bizantine. Në të njëjtën kohë, perandoria bizantine (emri i së cilës iu dha nga Perandoria Romake) ishte duke rënë. Osmani dhe ndjekësit e tij e shfrytëzuan këtë gjendje.

Në fillim, baza e pushtetit osman ishte një nga të shumtët në rajon. Djali i Osmanit, Orhani, ishte shumë i interesuar për pushtime, e zgjeroi tokën e tij deri në Ballkan. Ai gjithashtu bllokoi rrugët e tregtisë për të zvogëluar kontrollin bizantin në perëndim dhe në veri, të cilat lejuan zgjerimin e mëtejshëm të shtetit osman.

Në fund të fundit, thesari më i marrur në të gjithë hemisferën ishte qyteti i Kostandinopojës, selia e Perandorisë Bizantine për 1000 vjet.

Pas luftës me bizantinët, ndërhyrjet e mongolëve, grindjet e brendshme dhe kryqëzatat nga perëndimi, trazirat e luftërat civile gjithashtu nuk mungonin, sidomos kur stërnipi i Osmanit, Sulltan Bajaziti u burgos nga lideri turko-mongol Timur.

Më pas ishte nipi i tij, Mehmed Çliruesi, i cili fitoi reputacionin si njeriu që mori Kostandinopojën. Gjatë kësaj kohe, qyteti u bë i njohur si “Stambolli” që sipas grekëve do të thoshte “qytet”, por nga ana e vetë qytetarëve do të thotë “plotësisht islam” (Islamboll).

Në mes të shekullit të 16, gjatë mbretërimit të Sulejmanit të Madhërishëm (Kanunit), Perandoria Osmane u mburr me një popullsi prej më shumë se 15 milionë njerëz në tre kontinente, një nga forcat ushtarake dhe detare më të forta në planet.

Nga principata në superfuqi

Në fillim të shekullit të katërmbëdhjetë, kur edhe u formua, Shteti Osman ishte një principatë e vogël brenda kufijve të botës islame, ideja lëvizëse e së cilës ishte zgjerimi i tokave islame. Ky shtet i vogël e i parëndësishëm filloi gradualisht t’i nënshtrojë dhe t’i aneksojë ish territoret bizantine në Anadoll dhe në Ballkan. Kurse, më 1517, kur i përvetësoi tokat arabe të Egjiptit, u bë shteti më i fuqishëm i botës islame. Gjatë kohës së Sulltan Sulejmanit, sukseset e pandërprera ushtarake në hapësirën e gjerë prej

Evropës së Mesme e deri te Oqeani Indian i dhanë Perandorisë Osmane statusin e fuqisë botërore. Siç ndërronin rrethanat në disa periudha, ashtu iu nënshtroheshin ndryshimeve strukturat dhe institucionet e kësaj perandorie. Ndërrimet që u bënë në strukturën e saj të brendshme dhe në zhvillimin politik tregojnë se kjo principatë u bë perandori në frymën tradicionale të shteteve klasike të Lindjes së Afërt, siç ishte dinastia abaside. Kah fundi i shekullit të XVI, Perandoria Osmane, me traditën e saj shtetformuese e administrative, me politikën e saj financiare, sistemin agrar dhe organizimin ushtarak, paraqiste shembull të lartë të një perandorie të zhvilluar.

Perandoria Osmane si fuqi ushtarake

Perandoria osmane renditej në mesin e shteteve me fuqi të madhe ushtarake të kohës dhe falë efikasitetit ushtarak e zgjeroi territorin e saj në tri kontinente.

Dhe me të drejte linde pyetja: cilët ishin faktorët që kontribuan drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë në sukseset e kësaj ushtrie që e ngritën Perandorinë Osmane në superfuqi të kohës?

Faktorët janë të shumtë por ne do të mundohemi ti ndajmë në dy grupe.

1. Faktorët materialë-fizikë
2. Faktorët ideologjik-shpirtërorë.

Faktorët materialë-fizikë:

Faktorët materialë-fizikë: Faktori njeri, Faktori Ekonomik, Faktori Hapësinor.

Faktori njeri: Në çdo disiplinë edhe në disiplinat ushtarake faktori njeri është faktori vendimtar. Dihet se themelimi i perandorisë osmane erdhi nga shpirti luftarak i udhëheqësit të saj. Me kalimin e kohës edhe perfeksionimi i artit luftarak dhe rritja e numrit të ushtarëve së bashku me rritjen e territoreve të pushtuara vetëm sa e ngritën dhe më shumë rëndësinë dhe vlerën e faktorit njeri në ushtrinë e perandorisë osmane.

Faktori ekonomik: Suksesin apo mosesuksesin e një ushtrie në masë të madhe e determinon edhe fuqia ekonomike e shtetit të ushtrisë përkatëse. Sa më i fuqishëm të jetë ekonomiksht një vend aq më të fuqishme e ka edhe ushtrinë. Dihet fare mirë se për logjistikën dhe pajimet ushtarake nevojitet buxhet i konsiderueshëm. Vetë pozita gjeografike e perandorisë osmane në tre kontinente, një pozitë kjo gjeo-strategjike, me një tokë pjellore dhe me mjaft xeherorë të arit dhe argjendit i jepte perandorisë avantazhin ekonomik, i cili avantazh reflektohej drejtpërsëdrejti edhe në sukseset e ushtrisë osmane.

Faktori hapësinor: Perandoria Osmane përbante në vete një territor shumë të madh duke përfshirë pjesë nga tri kontinente Azi, Evropë dhe Afrikë, me një popullsi mbi 22 milionë banorë, një shifër kjo e madhe për kohën. Shteti Osman kishte shtrirje të madhe gjeografike dhe përfitimet e kësaj shtrirjeje ishin të ndryshme, që nga sigurimi i ushqimit për ushtrinë dhe ekspeditat ushtarake, sigurimi i kuadrove dhe njohurive të reja ushtarake, avancimi dhe mbështetja më e shpejtë e vijave të frontit.

Faktori ideologjik-shpirtëror:

Dihet fare mirë se në çdo luftë rol të konsiderueshëm në suksesin e një ushtrie ka edhe ideologjia-kauza shpirtërore e ushtarëve. Në masë të madhe, ushtarët e posaçërisht udhëheqësit ushtarakë të perandorisë duke përfshirë edhe sulltanin ishin besimtarë të

devotshëm që përveç kauzës ushtarake mbronin edhe një lloj kauze fetare. Të gjithë ushtritë osmane në flamurin e tyre kishin gjysmëhënën që simbolizon Islamin. Në të njëjtën kohë sulltani osman ishte personi që kishte në zotërim dy vendet e shenjta të islamit Meken dhe Medinën. Faktori ideologjik-fetar më bukur del në pah gjatë pushtimit të Kostandinopojës-Stambollit të sotëm.

Sulltan Fatihu në mendjen e tij vazhdimisht e preokuponte fjala e profetit Muhamed që e kishte thënë për komandantin i cili do ta çlironte Konstatinopojen, me fjalët:

“Do të çlirohet Kostantinopoja, e sa i mirë është udhëheqësi i saj (ushtrisë), dhe sa ushtri e mirë është ajo ushtri“, sdo mend që kjo ishte një nxitje për të qenë vet Mehmet Fatihu komandanti i cituar më sipër nga profeti Muhamed.

Në anën tjetër, ajo me çka del në pah faktori ideologjik-fetar në këtë skenë, është vet fakti që pas çlirimit të qytetit, komandanti i kësaj ushtrie, Mehmeti bie me kokë në tokë, sexhde falenderimi ndaj Zotit që iu mundësua ta çliroi qytetin, parasegjithash që ishte po ky udhëheqës ushtarak që përmendej në fjalët e profetit.

Rrënjët e Shtetit Osman

Në fillim të shekullit XIV, vlimet e vrullshme përbrenda tronditën mbretëritë e mëdha që shtriheshin ndërmjet Oksusit dhe Danubit, mbretërinë ilhanidase në Iran, hordhinë e artë në Evropën Lindore dhe Mbretërinë bizantine në Ballkan dhe në Anadoll. “Në fund të njëjtit shekull, pasardhësit e Osmanit, të një gaziu kufitar dhe të themeluesit të dinastisë osmane do të formojnë perandorinë që shtrihej prej Danubi deri në Eufrat. Këtë shtet e formoi Sulltan Bajaziti I (1389-1402), i njohur me ofiqin, Rrufeja⁵”

Ai në Nikopoja në vitin 1396 i shpartalloi kryqtarët, ushtrinë kalorsiake më krenare të Evropës, i bëri ballë sulltanatit të memalikëve, që ishte në atë kohë shteti më i fuqishëm islam, dhe i përvetësoi qytetet e këtij sulltanati në Eufrat. Dhe në fund e thirri të dalë në fushë të mejdanit Timurlengun e Madh, sundimtarin e ri të Azisë së Mesme dhe të Iranit. Periudha e parë e historisë osmane e imponon pyetjen: si u zhvillua principata e vogël kufitare e Osman Gazisë, me idenë e luftës kundër Bizantit të krishterë, në një perandori aq të fuqishme dhe me shtrirje aq të madhe? Rrënjët e Perandorisë Osmane duhet të kërkojnë në rrjedhat politike, kulturore dhe demografike të Anadollit të shekullit XIII dhe XIV.

Etapën e parë të këtyre ndodhive e karakterizon ekspedita pushtuese mongole në Lindjen e Afërt islame gjatë dekadës së tretë të shekullit XIII. Pas fitores së mongolëve në betejën të Qosedag më 1243, sulltanati i selxhukëve në Anadoll u bë shtet vasal i ilhanidëve iraniane. Pasojë e drejtëpërdrejtë e invazioneve mongole qenë shpërnguljet e turkmenëve, fiseve të fuqishme nomade turke, në drejtim të perëndimit. Ata, me prejardhje nga Azia Qendrore, më parë u vendosën në Iran dhe në Anadollin Lindor, e pastaj vazhduan dyndjet e tyre në perëndim, duke u vendosur përgjatë kufirit të Bizantit dhe Sulltanatit selxhuk në viset malore të Anadollit Perëndimor. Në vitin 1271 në këtë vend filloi kryengritja kundër idhujtarëve mongolë. Forcat e muslimanëve memalikë atëherë depërtuan në Anadoll që t’u ndihmojnë kryengritësve, mirëpo mongolët mizorisht e shtypën kryengritjen. Pas kësaj ngjarjeje, ata duke mbajtur njësitet e tyre të përhershme ushtarake në Anadoll ende më fortë ia vunë zgjedhën vendit. Përsëri gjatë gjysmës së dytë të këtij shekulli shpesh fillonin kryengritje që përcilleshin me hakmarrje të mongolëve. Kështu që provinca kufitare u shndërrua në vendstrehim të forcave dhe të personave politikë që iknin nga sundimi mongol, e

⁵Halil Inalcik, *Perandoria Osmane: Periudha klasike 1300-1600*, f. 13

aty edhe shumë fshatarë e qytetarë të ngratë kërkonin jetë të re dhe ardhmëri. E gjithë kjo ndihmoi shtimin e popullatës në këto provinca kufitare. Duke shfrytëzuar rastin që të vendosen në fushat e pasura përtej kufirit në anën bizantine, këta banorë të shqetësuar - nomadë e nxitnin popullin në *gaza*, luftë kundër bizantit, ndërmjet vitit 1260 dhe 1320, udhëheqësit e gazive, organizatorët e turkmenëve luftëtarë, themeluan principata të pavarura në Anadollin Perëndimor-në tokat që i çlironin nga Bizanti.⁶

Në dekadën e fundit të shekullit trembëdhjetë, depërtimet e gazive turkmenë në Anadollin Perëndimor gati u rritën në invazion të vërtetë. Prej të gjithë bejlerëve, Osman Gazi e mbante nën sundim territorin më të shtrirë nga veriu dhe më afër Bizantit dhe Ballkanit. “Gaziu rreth vitit 1301, filloi rrethimin e Nikesë, kryeqytetit të Bizantit të dikurshëm. Mbreti kundër tij dërgoi ushtri mercenare prej dy mijë ushtarësh, të cilën Osmani e priti në pusi dhe e mundi te Bafeona në verë të vitit 1302⁷”

Kjo fitore ndaj ushtrisë bizantine e bëri atë me famë. Burimet osmane si dhe ato bashkëkohore bizantine njoftojnë se gazitë e të gjitha krahinave të Anadollit u tubuan nën flamurin e tij. Ashtu sikur edhe nëpër principatat tjera kufitare, ata e morën emrin e udhëheqësit të tyre dhe u bënë të njohur me emrin osmanlinj. Modeli i pushtimeve të lehta dhe vendbanimi tërhiqnin përherë valë të reja të ardhacakëve me prejardhje të ndryshme nga Anadoli Qendror. Mirëpo, tanimë pas kësaj fitoreje të vitit 1301, principata osmane, vërtetë do të forcohet. Gaza, lufta në emër të fesë, ka qenë si një ideal, faktor me rëndësi në themelimin dhe zhvillimin e shtetit osman.

Kjo shoqëri kufitare ka qenë njësoj tolerante dhe e përbërë. Toka e përbashkët kulturore i vë trupat kufitare bizantine në kontakt të drejtpërdrejtë me gazitë muslimanë. Mihal Gazi, eprori kufitar grek i cili kaloi në Islam dhe bashkëpunoi me luftëtarët osmanlinj, është shembull i njohur i një procesi të tillë të pranimi të Islamit. Qëllimi i luftës së shenjtë nuk ishte që të zhdukë botën e pabesimtarëve, *daru'l-harb*, por që ta nënshtrojë. Osmanlinjtë e themeluan perandorinë e tyre duke bashkuar Anadollin islam dhe Ballkanin e krishterë nën qeverisjen e tyre, edhe pse administrimi dhe qeverisja e perandorisë bazohej mbi ligjet islame, ajo në të njëjtën kohë merrte përsipër të mbrojtë kishat ortodokse dhe miliona të krishterë ortodoksë, gjë që është edhe parim fundamental i ligjit islam, mbrojtja dhe kujdesja e qytetarit të tij pavarësisht konfesioneve fetare si dhe mundësia e lirë absolute e shprehjes, praktikimit të lirë të jetës fetare, qoftë në privat apo në publik, duke përfshirë këtu dhe tempujt fetarë. “Perandoria Osmane me anë të parimeve islame, të krishterëve dhe hebrenjve iu garantonte jetën dhe pasurinë me kusht që të jenë të nënshtuar dhe të paguajnë tatim. U lejonte që të predikojnë bindjet e tyre fetare dhe të jetojnë të lirë në harmoni me ligjet e veta fetare⁸”.

Osmanlinjtë, pasi që shoqëria e tyre ishte e llojit kufitar dhe lirisht përziheshin me të krishterët, këto parime islame i zbatonin me durueshmërinë dhe zemërgjerësinë më të madhe. Ata në vitet e para të perandorisë së tyre, udhëhoqën aso politike parimore që para se t'i rroknin armët, mundoheshin t'i nënshtrojnë vullnetarisht të krishterët dhe të fitojnë besimin e tyre.

⁶ <http://www.ikub.al/Shkolla/15/05/07/Rrenjet-e-shtetit-osman-0133.aspx>

⁷ Inalcik, po aty, f.15

⁸ Inalcik, po aty, f.116

Administrata mbrojtëse e shtetit islam, me ligjet e tilla fetare që garantonin durueshmëri, me sukses i realizoi depërtimet në zona të ndryshme. Megjithëkëtë, qëndrimi dashamirës ndaj fshatarësisë si burim i të ardhurave ishte politika tradicionale e këtij shteti, politika që cytte tolerancë. Tatimi i quajtur haraç përbënte pjesën më të madhe të ardhurave të shtetit osman, siç paraqitte pjesën më me rëndësi të të ardhurave në ish-halifatin arab, gjithashtu rol të rëndësishëm në zhvillimin e hovshëm të Perandorisë Osmane ka luajtur edhe tregtia, “vetë autoritetet qendrore të perandorisë siguronin zhvillimin e tregtisë⁹.”

Perandoria Osmane për shkak të gjithë kësaj ishte e paracaktuar të bëhej “Perandori e vërtetë kufitare” - shtet kozmopolit në të cilin të gjitha konfesionet dhe racat konsideroheshin pjesë e një tërësie që do t’i bashkojë të krishterët ortodoksë të Ballkanit dhe muslimanët e Anadollit në një shtet.

Me fjalë të tjera, struktura e organizimit qoftë të jashtëm apo të brendshëm e perandorisë na jep të kuptojmë se kemi të bëjmë me një arkitekturë strukturale të jashtëzakonshme, mirë të organizuar, të disiplinuar. Këtë e vërteton fakti kemi një sipërfaqe mjaft të madhe nën administrimin e Perandorisë, mbi 23.000.000 km² nga Afrika Veriore në Lindjen e Afërt, nga Kaukazin deri në Evropë. Ky entitet ngërthente dhjetëra popuj, nacionalitete të ndryshme, kultura, doke, zakone e gjuhë të ndryshme, ku pozitën më të lakmueshme e kishin turqit, shqiptarët dhe boshnjakët, dhe kjo si rezultat i asaj që i bashkonte e njejta fe.

Duke pasur parasysh këtë diversitet të popullsisë brenda Perandorisë, menjëherë na bie ndërmend një art diplomatik qeverisës por jo edhe aq i lehtë në zbatimin e politikave të saj. Rritja e Perandorisë dhe shtrirja e saj në Evropë dhe Ballkan, paraqiti një sfidë të radhës e cila kishte të bëjë me zbatimin e lloj-llojshmërisë së ligjeve apo dokeve zakonore, ngase në çdo shtrirje të saj, në çdo ardhje të një territori ballkanik, ballafaqoheshte me tradita dhe zakone tjera. Mu për këtë, Porta e Lartë luajti një diplomaci elastike e cila përvetësonte kodet të cilat nuk binin ndesh me politikat e saj dhe ligjin e Sheriatit, bëri një kodeks të veçantë me tradita dhe doke të ndryshme e që i praktikonte në territoret e saja, dhe në sajë t të një mirë organizimit, arriti të vlerësohet si superfuqi shtetëror.

1.3. Ideologjia frymëzuese në Perandorinë Osmane

Çdo shtet në të kaluarën por edhe sot, udhëhiqet nga një fuqi e cila në sytë e njerëzve paraqitet si inekzistente, kurse në fakt, është e ngulitur thellë në zemrat e banorëve të tij, në bindjet e tyre, udhëhiqet nga një ideologji frymëzuese, edhe pse ideologjitë në ekzistimin e shteteve sot janë më mikse dhe më të moderuara, sërish në instancë të fundit ekziston e ashtuquajtura nënë e ideologjive progresive mbi trasenë e së cilës rrugëton secili shtet, dhe nga ajo që mund të konkludojmë është se sa më e trasuar mirë dhe e analizuar në mënyrë empirike të jetë ideologjia në fjalë, aq më i rëndësishëm dhe më i zhvilluar është shteti përkatës.

⁹Robert Matrant, *Historia e Perandorisë Osmane*, përkth. Asti Papa, Dituria, Tiranë, 2014, f. 214.

Ndaj kës a jdukurië nuk ka qenë immune as Perandoria Osmane, e cila udhëhiqej nga ideologjia e përhapjes së Fjalës së Zotit, gjegjësisht besimit islam, dhe me të drejtë thuhet se sikur të mos ishte Perandoria Osmane, feja islame nuk do ta kishte këtë shtrirje që e ka sot.

Nëse kthehemi tek fuqitë e mëdha shtetërore dhe ushtarake, shohim se shtytjen drejt korrijës së sukseseve e merrnin nga klerikët fetarë, gjegjësisht nga kisha, ku kryesisht njihen si shtete ose gjysmë shtete teokratike. Perandoria Bizantine frymëzohej nga kisha ortodokse, ashtu dhe Perandoria Romake stimul kryesor e kishte kishën katolike, përkundër divergjencave që kishin hasur mes kishës dhe pushtetarëve në këto perandori, përsëri bekimet merreshin nga kisha.

Diçka e ngjashme ishte dhe në Perandorinë Osmane, por kjo e fundit veçohet me dy karakteristika esenciale që kanë lënë gjurmë në historinë e njerëzimit:

E para është se shteti osman udhëhiqej kryesisht nga ligji hyjnor, baza e legjislacionit shtetëror vinte nga Libri Hyjnor, Kur'ani dhe tradita e Profetit Muhamed, dhe kjo ndodhi deri në kohën e zëvendësimit të këtij legjislacioni me kushtetutë laike;

E dyta është se ekspeditat luftarake që ndërmerrnin osmanët, kishin për qëllim dhe përhapjen e besimit islam, por pa dhunë, pa imponim në krahasim me perandoritë tjera siç njihen në historinë e njerëzimit luftërat kishtarë apo kryqëzatat. Kjo si shembull ilustron me shtetin osman në Ballkan ku përkundër shumë shekujve të qeverisjes, krishterët përbënin një numër të madh të banorëve të perandorisë duke gëzuar të drejtat e tyre si krejt fetë e tjera. Një fakt tjetër për tolerancën osmane është edhe ai se kishat, me urdhër të Sulltanit ishin të lira nga tatimet.

Ja si i drejtohet Sulejman Pasha babës së vet Sulltan Orhan Gaziut: "Nëse më urdhëroni mua, shërbëtorin tuaj të përulur, unë do të kaloj detin, për hir të Allahut dhe Pejgamberit të fundit. Unë do ta çrrënjosh errësirën e jobesimtarëve në atë rajon dhe do t'i ndriçoj ata me dritën e Islamit"¹⁰

A ishte shpata ajo që përhap besimin islam këtu ku është sot ?

Të gjitha argumentet, përfshirë edhe ato fetare, që janë të shumta, që apelojnë për përhapje dhe shtrirje të islamit pa luftë, pa dhunë, si dhe argumentet shkencore, historike flasin se nuk ka qenë forca faktori që e ka përhapur islamën gjithandej. Historiani i mirënjohur Noel Malcolm në librin *Kosova një histori e shkurtër*, thotë se Perandoria Osmane nuk përdori dhunë në konvertimin e popujve të pushtuar. Mendoj që nuk është e nevojshme të zgjërrohemi në këtë pikë, pasi që tema jonë është tjetër.

Cili ishte roli i fesë në Perandorinë Osmane ?

Cilës do kohë që i referohemi gjatë ekzistimit të Perandorisë Osmane do të konstatojmë se roli i fesë islame ka qenë dominant, shumë i rëndësishëm, edhe pse para shpërbërjes së perandorisë ky rol është zbehur, sidomos pas formimit të shteteve kombe në Evropë.

Por kur i referohemi kohës për të cilën flasim, duhet të merren parasysh edhe rrethanat globale, kur feja ka luajtur rol mjaft të rëndësishëm edhe në shtetet tjera, sidomos në shtetet evropiane, me theks të veçantë para Revolucionit Francez.

¹⁰ Maksudoglu, po aty, f. 106

Kristianizmi ka qenë ideologji frymëzuese e shteteve evropiane në kohën para lindjes së kombit si nocion politologjik.

Vlen të ceket se kryqëzatat ishin luftëra fetare në emër të Krishtit. Luftëra të cilat aspak nuk kishin të bënin me mësimet e Jezusit. Dhe më skandalozja e gjithë këtyre luftërave ishte, se ato bekoheshin nga udhëheqësit shpirtërorë të Kishës Katolike, si p.sh. nga Papa Urbani.

1.4. Tatëpjeta e Perandorisë Osmane

Teoritë e ndryshme potencojnë se ngritjet, zhvillimet e fuqive shtetërore janë refleksion i përballjeve me sfidat e ndryshme, i tentimit për të ndryshuar diçka ose për të përmisuar një situatë. Në qoftë se në mënyrë permanente vëzhgohen dukuritë që paraqiten me rastin e aktiviteteve përmes të cilave synohet të zhvillohet një proces, s'do mend se mundësitë reale për t'i tejkaluar sfidat eventuale janë më të mëdha, sikundër është edhe rënia apo dëmtimi i një procesi shoqëror. Nga momenti që nuk mund të tejkalohen problemet e ndryshme gjatë zhvillimeve të proceseve shoqërore, mundësia e dështimit është e madhe. Nga ky kënvështrim duhet të trajtohet edhe rënia e Perandorisë Osmane.

Në shekullin XIX, Perandoria tashmë nuk ishte në fuqinë e saj maksimale, madje ishte cilësuar si “I sëmuri Bosforit”, një term ky i shpikur nga Car Nikolla II i Rusisë gjatë Luftës së Krimesë.

Rusia doli si një nga kundërshtarët kryesorë të Perandorisë Osmane dhe Lufta e Krimesë ishte pjesërisht rrjedhim i rëniës së Perandorisë, si dhe i fuqive evropiane në rritje që synonin të merrnin territoret prej këtij shteti.¹¹

Gjatë luftërave të gjata në shekullin XVIII, peshoja anoi në dobi të Evropës. Fuqia osmane gjithnjë e më tepër dobësohej, pasi në shekullin e tetëmbëdhjetë dominonte bindja se Evropa është superiore, Perandoria Osmane edhe politikisht edhe ekonomikisht u bë e varur prej Evropës. Ekzistimi i gjatë i kësaj perandorie dhe mundësia e rënies së saj, më në fund u bënë problem i politikës evropiane, e ashtuquajtur “Çështje Lindore”. Jeta politike mbahej nën mbikëqyrjen evropiane deri në vitin 1920.

Nga shkaqet e shkaku i rënjes përfundimtare

Përfshirja e Perandorisë Osmane në Luftën e Parë Botërore ishte shkaku kryesor që i dha goditjen përfundimtare kësaj perandorie. “Edhe pse në fillim të luftës perandoria ruajti neutralitetin, dhe për këtë ishin të interesuara fuqitë e Antantës” (fitueset e luftës së parë botërore), mirëpo lidhja e mëvonshme e aleancës me Perandorinë Osmane dhe Gjermanisë pas së cilës aleancë Porta e Lartë nuk mund ti shmangej më përfshirjes në luftë¹², ndryshoi rrjedhat politike.

Ky vendim me aq pasoja dhe detyrime nga pala turke u mor nga një grup tepër i ngushtë drejtuesish. Aleanca turko-gjermane ishte një ndodhi fatkeqe e historisë së Perandorisë Osmane, edhe pse në parim ishte një aleancë mbrojtëse kundër Rusisë.

¹¹<http://www.tiranaobserver.al/news-item/perandoria-osmane-si-nisi-dhe-pse-u-rrezua/>

¹² Matrani, po aty, f. 572

Kjo ishte një aleance interesash, ku Perandoria Osmane kërkonte revanshin ndaj armikut të saj tradicional Rusisë, së cilës i patë bërë mjaft lëshime në Detin e Zi dhe Transilvani. Në anën tjetër interesi gjerman ishte që përfshirja e Perandorisë Osmane në luftë të detyronte Rusinë të dërgonte ushtri në Kaukaz, Anglia të detyrohej ta mbronte Kanalin e Suezit dhe Egjiptin, dhe kështu tryshia në frontin perëndimor të pakësohej.

Një ngjarje që vlen të theksohet që ndihmoi në masë të madhe zhbërjen e Perandorisë Osmane është edhe kryengritja e popujve arabë kundër Perandorisë Osmane, “kjo kryengritje filloi në qershor të 1916, ideatorë i saj ishte sherifi i Mekës, Hyseini¹³”.

Kryengritja arabe u ndie në Stamboll dhe u përjetua si një goditje e vërtetë me thikë pas shpine, dhe shumë shpejt u shndërrua në një nga shqetësimet kryesore për Portën e Lartë, ngase sherif Hyseini nuk vepronte vetëm. Ai kishte mbështetjen e Anglisë me të cilën paraprakisht në janar kishte nënshkruar marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë, sipas së cilës qeveria e Londrës merrte përsipër të njihte pavarësinë e pjesës më të madhe të vendeve arabe dhe si shpërblim për këtë, sherifi i Mekës pranoi të luftonte “për të çliruar popujt arabë nga zgjedha turke”.

Ajo që vlen të theksohet është se pas humbjeve të shumta, Porta e Lartë filloi bisedimet për armëpushim me fuqitë e Antantës dhe kjo njihet si Konventa e Mondrosit e mbajtur më 30 tetor 1918, e cila ishte shumë e rëndë për Perandorinë Osmane. Ajo që ishte më e dhimbshme për perandorinë ishte 8 shkurti i vitit 1919 kur gjenerali i trupave franceze Franshe d'Espere hyri triumfalisht në Stamboll. Pas kësaj gjendje në të cilën u katandis perandoria u rrit fryma nacionaliste turke dhe si udhëheqës i saj ishte Mustafa Qemali. Qeveria e Stambollit duke dashur ta shuante frymën nacionaliste apo qemaliste, organizoi zgjedhje në fund të vitit 1919 por si për ironi të fatit, rezultatet e këtyre zgjedhjeve, parlamentin turk u formua kryesisht nga nacionalistë të vendosur, “cilët me anë të Traktatit të Lozanës më 24 korrik të 1923, arritën ta fshijnë poshtërimin e Traktatit të Sevrit.”¹⁴

Studiuesit e ndryshëm i kanë vënë zvarë shkaqet e rënies së një shtetit kaq të fuqishëm, duke theksuar arsye të ndryshme që kanë ndikuar në rënien e shtetit osman. Tre faktorët kryesorë që kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në dobësimin e Perandorisë Osmane dhe pastaj në zhbërjen përfundimtare të saj janë si më poshtë:

Faktori qeverisës (ndryshimi i legjislacionit) dhe tentimi për turqizim

Mosgatishmëria e parisë qeveritare për t'u përballuar me ndryshime rrënjësore në artin e ri qeverisës ishte evidente, ngase tashmë kishte filluar reforma për ndryshime në shtetin osman nga një legjislaturë hyjnore siç ishte sheriat, në një legjislaturë njerëzore si kushtetuta e Mit'hat Pashës, si kryeministër bashkë me diplomatët shqiptarë që synonin reformimin e Perandorisë Osmane.

Kjo ishte sfida më e rëndë për Sulltan Abdylhamidin e në përgjithësi për shtetin osman. Mendimi politik në shtetin osman ishte i ndarë në dy tabore: në ata që mendonin se duhet të vazhdojë qeverisja me legjislacionin e kaluar dhe reformatoreve që kërkonin reforma rrënjësore në legjislacion. Këtu u paraqit dhe sfida tjetër, njohuritë e pamjaftueshme për nismën e re reformuese, e nga një kushtetutë hyjnore në një kushtetutë parlamentare me tendencë properëndimore.

¹³ Matrani, po aty, f. 578

¹⁴ Matrani, po aty, f. 578

Kështu më 23 dhjetor 1876 Sulltan Abdylhamidi e shpalli kushtetutën e cila theksonte parimin e qeverisë parlamentare që përbëhej nga Asambleja dhe Senati.

Përfaqësuesit e parlamentit ishin nga të gjitha trevat e shtetit osman, dhe nga të gjithë racat dhe fetë. Sulltani ra në kundërshtim me kryeministrin Mit'hat si udhëheqës i lëvizjes turqët e rinj. Sulltani kundërshtonte idenë e një demokracie parlamentare ngase nuk e besonte se kjo ishte zgjidhja më e mirë për liri dhe demokracinë e etniteteve dhe shtetasve.

Sulltan Abdylhamidi që refuzonte kushtetutën atëbotë kishte deklaruar:

"Perandoria Osmane është një shtet ku jetojnë popuj të ndryshëm, kurse demokracia në një shtet si ky është vdekje e elementit esencial të vendin; vallë, në parlamentin anglez a ka qoftë edhe një deputet të vetëm indian? Apo, a ka në parlamentin francez një deputet të vetëm algjerian? ¹⁵"

Me fjalë të tjera, shteti osman filloi të tundet në themelet e tij si shkak i ndryshimit të parimit qeverisës, ideologjisë së sheriatit që përfaqësonte Sulltani dhe parimit të demokracisë perëndimore që përfaqësonte Kryeministri, Mit'hat Pasha, tashmë përfaqësues i lëvizjes reformiste *turqët e rinj*, me ndihmë të madhe të elitës politike shqiptare.

Lëvizja e turqve të rinj kishte marrë hov në shtetin osman, dhe përfaqësohej kryesisht nga studentët që kishin studiuar jashtë shtetit osman që vinin me ide properëndimore, nga elita politike e vendeve ballkanike, kryesisht shqiptarëve të cilëve iu ishin premtuar të drejta të mëdha në vendet e tyre, si zhvillim ideologjik, ndjenjë patriotik dhe kulturor. Ismail Qemali ishte dora e djathtë e Mit'hat Frashërit, gjithashtu dhe Ibrahim Temo. Dinakëria e turqve të rinj nuk zgjati shumë, shqiptarët u gjetën të tradhtuar nga ta, sepse synimi i tyre ishte turqizimi i trojeve shqiptare dhe kufizimi i madh i të drejtës së shqiptarëve për ta folur dhe kultivuar gjuhën amtare shqipe, gjë që para tyre nuk kishte qenë, siç thotë, Müfit Yüksel, sociolog dhe studiuesi turk:

"Neni 18 (i përgatitur nga xhonturqit) në Parlamentin Osmane, në kohën e Tanzimatit, ka qenë antishqiptar dhe ka shkaktuar shkëputjen e Shqipërisë nga Perandoria. Në këtë nen thuhej: "Çdo nëpunës që punon në administratën e Perandorisë Osmane duhet ta dijë gjuhën turke. Shqiptarët më së shumti e kanë kundërshtuar këtë nen. ¹⁶"

Faktori i kryengritjeve

Tronditjet apo trazirat e vazhdueshme e tkurrën bukur shumë hapësirën e shtetit osman.

Luftërat me shtetet perëndimore, kërcënimet e njëpasnjëshme, marrëveshja e Shën Stefanit më 1878 mes Shtetit Osman dhe Rusisë, ndikuan dukshëm në tentimet për zgjerim të mëtutjeshëm të shtetit osman, madje rrezikonin ato territore që i kishte nën qeverisje. Rreziku më serioz erdhi kur brenda shtetit filluan zëra të shumtë për ndryshime të politikës qeverisëse. Tashmë shtetet perëndimore kishin futur ideologjinë e nacionalizmit në thellësinë e shtetit osman që kishte gjetur ithtarë gjithandej. Përpjekjet për kryengritje në vendet e Ballkanit shuheshin shpejt nga fuqia e shtetit por ky ishte një sinjal jo i mirë për Perandorinë Osmane. Tashmë pakënaqësitë e popujve ishin eviente në të katër anët.

¹⁵ DMuhammed Salabi, *Perandoria Osmane, faktorët e ngritjes dhe rënjes së saj*, Prishtinë 2009, f. 437.

¹⁶ "Roli i shqiptarëve në Perandorinë Osmane dhe në Republikën Turke", panel i organizuar nga Qendra Kulturore e Kosovës në bashkëpunim me Forumin Rinor të Shoqatës "Vëllazëria Turko – Shqiptare", 25 janar 2014.

Në vitin 1876 popullata e Hercegovinës çohen në kryengritje për shtet të pavarur, po shpejt kjo kryengritje shuhet nga forcat osmane.

"Në kohën kur u çuan në kryengritje krishterët e Bosnjës dhe Hercegovinës me përkrahjen e Austrisë dhe shteteve të tjera evropiane, veçanërisht Rusisë, edhe bullgarët organizuan një gjë të tillë. Në vendet bullgare u themeluan organizata të ndryshme për shtrirjen e pushtetit rus në mesin e të krishterëve ortodoksë dhe sllavë.

Rusia i përkrahte ata dhe i ndihmonte me armë. Këto organizata bënë çmos për t'i nxitur dhe inkurajuar banorët serbë dhe ata të Bosnjës dhe Hercegovinës për t'u çuar në kryengritje kundër osmanëve¹⁷"

Bota perëndimore ndikonte vazhdimisht tek popullata e Ballkanit për kryengritje të vazhdueshme sepse ishte shansi i vetëm dhe ideal për dobësimin dhe shkatërrimin e Perandorisë Osmane. Sulltan Abdulhamidi II ishte i bindur se qëllimi i shteteve evropiane ishte rrënimi i Perandorisë Osmane. Mes tjerash, në memoaret e tij kishte theksuar edhe këtë: "*Gjatë kongresit i cili u mbajt në Stamboll ku morën pjesë shtetet e mëdha evropiane, e pash se çka kishin planifikuar e kurdisur ato; nuk ishte fjala për siç thonin ata, sigurimin e të drejtave të nënshtetasve të krishterë, por për sigurimin dhe garantimin e pavarësisë së plotë për ata nënshtetas. ...synohej copëtimi i Perandorisë Osmane.*

Për ta realizuar qëllimin e këtij copëtimi, ata përdornin dy metoda:

E para: Nxitja e banorëve të krishterë dhe turbullimi i mjedisit të pastër. ...

E dyta: Propagandimi i demokracisë për të futur përçarje në mesit tonë. Evropianët arritën të gjejnë nga mesi ynë përkrahës dhe ihtarë, të cilët do t'i shfrytëzonin për qëllimet e tyre. Për fat të keq, idetë e armikut ishin joshëse nga pamja e jashtme, kështu që disa të rinj të kulturuar osmanë nuk mund të bënin dallim në mes të praktikimit të lehtë të pushtetit kushtetutar në vendet që kanë veçorinë e unitetit kombëtar dhe pamundësisë së praktikimit të këtij pushteti në vendet që nuk e kanë këtë veçori.¹⁸"

Në realitet Sulltani ishte i vetëdijshëm se nën këmbët e tij tashmë punohej me të madhe dhe se pozitën nuk e kishte të sigurt. Nga ana tjetër, një pjesë e popullatës shqiptare ia kishte dhënë besimin e qeverisjes turqve të rinj dhe fuqishëm i përkrahte ata.

Sulmet e njëpasnjëshme nga shtetet perëndimore dhe marrëveshjet dëmtuese

Përpjekjet për zhbërjen e Perandorisë Osmane ishin të gjithanshme dhe te vazhdueshme. Përkrahja e organizatave revolucionare-reformiste bëhej kryesisht nga vendet perëndimore që donin eliminimin e perandorisë osmane. Atëbotë nuk zgjidheshin format e propagandës për të dëmtuar këtë ngrehin vigane politike. Në këtë mision ata i shfrytëzonin të gjitha metodat e mundshme.

Ideologjia dhe taktika e informatave jo të ishin pjesë e propagandës së shteteve perëndimore në kontekstin osman. Siç potencon dhe profesor Salabi: "Kur Perandoria Osmane vendosi aty (në Bullgari) disa familje çerkeze, bullgarët e ngritën zërin kundër kësaj dhe organizuan një kryengritje, gjatë së cilës Rusia dhe Austria e ndihmonin me armë e pasuri. Perandoria Osmane arriti ta shtypë këtë kryengritje. Më vonë shtetet evropiane filluan

¹⁷ Salabi, po aty, f. 440

¹⁸ Salabi, po aty, f. 442.

të përhapnin lajme për gjoja masakra, të cilat kinse i kishin bërë osmanët ndaj të krishterëve, gjë që s'kishte të bëjë me të vërtetën¹⁹

Kjo bëhej me arsyen për t'i nxitur të tjerët në kryengritje dhe për ta arsyetuar propagandën që bëhej në shtetin osman.

Lufta mes Perandorisë Osmane dhe Rusisë e vitit 1877 ishte me pasoja të rënda për shtetin osman, shumë ushtarë osmanë të vrarë dhe pasuri e shkatërruar. Lufta përfundoi me marrëveshjen e njohur të Shën Stefanit e cila ishte një goditje jashtëzakonisht e rëndë për Perandorinë Osmane. Kjo marrëveshje u bë nën trysinë ndërkombëtare, duke e dëmtuar dhe zbehur dukshëm shtetin osman. Ndërkohë forcat ruse kërcënonin se do të marshonin deri në Stamboll në rast të mospranimit të marrëveshjes.

Osmanët duke mos pasur zgjedhje tjetër, nënshkruan marrëveshjen e Shën Stefanit, që në fakt ishte marrëveshje e kapitullimit të forcave osmane karshi forcave perëndimore.

Kjo marrëveshje përmbante këto pika:

1. Caktimin e kufijve të Malit të Zi për t'i dhënë fund mosmarrëveshjeve; si rrjedhim, kjo provincë do ta fitonte pavarësinë ;
2. Pavarësimin e provincës serbe, të cilës do t'i shtoheshin edhe territore të reja;
3. Pavarësimin administrativ të Bullgarisë, e cila do t'i paguajë Perandorisë Osmane një shumë të caktuar; nëpunësit e shtetit dhe ushtarët do të përbëheshin vetëm prej të krishterëve dhe do të caktoheshin kufijtë me dijeninë e osmanëve dhe rusëve. Princi do të zgjidhej nga ana e vetë banorëve, ndërsa osmanët do ta largonin përfundimisht ushtarinë e tyre nga Bullgaria;
4. Rumania do të fitonte pavarësinë e plotë;
5. Porta e Lartë duhej të garantonte mbrojtjen e armenëve dhe të krishterët nga kurdët dhe çërkezët;
6. Porta e Lartë do të përmirësonte gjendjen e të krishterëve në ishullin e Kretës;
7. Perandoria Osmane do të paguante një gjobë lufte në vlerë prej 2.5 miliardë lira ari; Rusia mund të pranonte edhe toka në këmbim të kësaj shumë;
8. Ngushtica e Bosforit dhe Dardaneleve do të qëndronin të hapura për anijet ruse, si në paqe ashtu edhe në luftë;
9. Muslimanët e Bullgarisë mund të emigronin ku të dëshironin me shpenzime të Perandorisë Osmane.²⁰

Në këtë mënyrë Rusia e copëtoi shtetin osman dhe shtriu pushtetin e vet në Ballkan duke nxitur kështu urrejtje dhe pakënaqësi kjo e fundit tek fuqitë e tjera evropiane si ndaj Austrisë, Greqisë, Anglisë .

Si pasojë e pakënaqësisë së disa nga vendeve evropiane me marrëveshjen e këtyre dy palëve, u vendos që e e njëjta të modifikohet dhe në të të futeshin edhe vendet e tjera evropiane si aktorë për interesa të tyre strategjike. Kështu u kalua në një marrëveshje të gjerë, multilaterale e cila do të mbahet në Berlin, që do të njihej si *Kongresi i Berlinit*, nga ku Perandoria Osmane nuk do të mund të ngrejë kokën më.

¹⁹ Salabi, po aty, f. 440-41.

²⁰ Salabi, po aty, f. 444

Pavarësisht nga kushtet e pavolitshme që u detyrua t'i pranonte, Paqa e Lozanës ishte një fitore e madhe që i dha mundësi Turqisë kemaliste të dilte si një shtet i lirë dhe i pavarur, që hynte në marrëdhënie me shtetet e tjera në kushte të barabarta.

Ishte 3 marsi i vitit 1924 kur Asambleja e Madhe fshihi edhe gjurmët e fundit të të regjimit të vjetër duke vendosur që t'i jepte fund kalifatit.

1.5 Koncepti nacional-komb sëmundje shkatërruese e Perandorisë

Në fund të shekullit XIX shteti osman ballafaqohet me dy probleme esenciale të qenësisë së vet, përveç dobësimit si shtet dhe fuqi ushtarake, i sulmuar nga jashtë, nga të gjitha anët, nga forcat e fuqive të mëdha perëndimore. Ndërkohë e në veçanti atakohej nga Rusia, kurse nga brenda kishte filluar të infektohej nga „sëmundja“ e e nacionalizmit.

Nacionalizmi tek një popull sipas teoricientëve zhvillohet në tri faza:

"Faza A është "zgjimi" kulturor, gjatë së cilës disa intelektualë fillojnë të mbledhin e studiojnë kulturën popullore, faza B është aktivizimi politik dhe faza C është masivizimi i lëvizjes, gjatë së cilës ajo fillon të ndahet në grupime ideologjike.²¹"

P.sh., në rastin konkret tek shqiptarët, koncepti i idesë së kombit shqipëtarë ka ecur nëpër tri fazat e sipër përmendurs duke i dhënë formësim origjinal nocionit kombë, me fjalë të tjera lëvizja nacionaliste shqiptare fillon ta zhvillojë mendimin e vetë politik me kërkesat e tyre për të drejta më të mëdha kulturore dhe gjuhësore në kuadër të një autonomie nën shtetin osman, si rrjedhojë që në të ardhmën të organizoheshin në lëvizje serioze me kërkesat e tyre kombëtare.

Në Perandorinë Osmane, lëvizjet nacionaliste kanë qenë rezultat i:

- Dobësisë së shtetit osman dhe paaftësisë së tij për t'i kontrolluar lëvizjet e mendimeve të ndryshme politike dhe ideologjike, si dhe i paafetësisë për t'i parandaluar këto rryma e kanë dëmtuar rëndë këtë shtet.
- Daljes në skensë të patriotëve të ndryshëm që synonin të bashkonin etnitetin e tyre gjuhësor, kulturor dhe fetar në një çati.
- Pakënaqësisë të popujve të ndryshëm brenda perandorisë me trajtimin e administratës apo shtetit, por edhe i keqtrajtimit që iu bëheshin grupeve apo popujve në hapsirën e perandorisë
- Dobësimit real të perandorisë dhe paftësisë për t'i mbrojtur kufijt e vet.
- Shfaqjes së idesë për shtet demokratik, më pak teokratik, për një shtet me kushtetutë laike dhe jo një kushtetutë fetare siç ishte Perandoria Osmane, ku feja nuk do të jetë në rend të parë, por kombi.

²¹Enis Sulstarova, *Ligjërime nacionaliste në Shqipëri dhe studime të tjera*, Tiranë 2015, f. 127

Në rastin e shtetit osman, rol të theksuar drejt degradimit ka luajtur dhe dalja në skenë e turqëve të rinj, të cilët synonin ta mbanin shtetin osman kompakt por pa ligj fetar, me një kushtetutë laike të ardhur nga ligjet e ndryshme evropiane. Por kjo ju shkoj keq turqve të rinjë, ngase fryma e tyre nacionaliste i frymëzoi dhe popujt e tjerë brenda perandorisë për të menduar drejt idesë për bashkim kombëtar, shtoja kësaj dhe trajtimin jo të mirë që qeveria e turqve të rinj e bënte ndaj etniteteve të tjera kombëtare përbrenda shtetit osman, mes tjerash edhe ndaj shqiptarëve.

1.6 Zhbërja përfundimtare e Perandorisë Osmane me marrëveshjen e vitit 1924

Perandoria Osmane konsiderohet ndër perandoritë më të mëdha në histori, me një sipërfaqe të madhe, e përbërë prej shumë popujve dhe një numër mjaft të madhë gjuhësh, nga Afrika e Veriut, Lindja e Afërt, Kaukazi e deri në Evropë. Por Ballkani ishte shtrati ku shteti osman u rrit dhe ra.

Askush nuk e kishte menduar se një superfuqi gjigande si kjo do të përmbysesh dhe do të zhdukej si kullë kartash. Kryengritjet e njëpasnjëshme, shkëputjet e popujve dhe pavarësitë e fituara nga ky shtet, si dhe disfata që pësoi nga ushtria ruse treguan se s'ka fuqi të pamposhtshme. Por ajo që përfundimisht i shteroi shanset e sulltanit për rimëkëmbje ishte ndarja e shqiptarëve dhe pavarësia e Shqipërisë. Kjo ishte një goditje e pariparueshme për sulltanatin, pasi që shqiptarët konsideroheshin motori i shtetit osman në Ballkan siç shprehet edhe historiani dhe albanologu zvicerian Schmitt se boshnjakët sëbasku me shqiptarët përbënin shtyllën kurrizore të sundimit osman në Ballkan²².

Veprimet e shoqatës “Bashkim e përparim” (*Ittihad ve Terakki*), si dhe planet e tyre për demokratizimin e Perandorisë Osmane, si duket nuk shkuan ashtu siç mendonin ata, ngase me idetë e tyre u frymëzuan shumë popuj të tjerë brenda Perandorisë. Filluan kryengritjet dhe shkëputjet e vendeve duke u pavarësuar nga perandoria. Në një farë mënyre turqit e rinj kishin shpikur idenë apo kishin sjellë ide dhe plane nga bota perëndimore për ta demokratizuar shtetin osman, për ta dobësuar Sulltanin, por këto ide i morën dhe i vunë në praktikë popujt tjerë, duke e shfrytëzuar dhe fuqinë e turqve të rinj, dhe kështu lindën entitet që më vonë u shkëputën nga shteti osman.

Ska dyshim se turqit e rinj, me idenë e përparimit, decentralizimit të sulltanatit ishin shkaktarë për ta dobësuar shtetin e fuqishëm osman, nga parlamentarizmi i Perandorisë Osmane merrej e drejta e popujve që me ndihmën e fuqive ndërkombëtare, të pavarësoshin nga shteti osman.

Përfshirja në Luftën e Parë Botërore, në krah me fuqitë qendrore, Austro-Hungarinë dhe Perandorinë Gjermane, si duket osmanëve iu solli shkatërrimin e plotë të perandorisë.

Lëvizjet nacionaliste turke, me theks të veçantë Bashkimi dhe Përparimi shpallën Republikën e Turqisë në territorin e mbetur, i t'kurrur nga vendet e Ballkanit, i cili kryesisht banohej nga populli turk.

²² Oliver Jens Schmitt, *Shqiptarët: Një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*, Tiranë, 2012, f. 69

Me fillim të sulmeve të Austro Hungarisë në drejtim të Serbisë si pretekst i vrasjes së princit Ferdinand, shtetet aleate të Antantës u gjetën në krah të shtetit serb duke kundërshtuar kështu bllokun e Aleancës që e përbënin Gjermania dhe Austro Hungaria.

Mendohet se pas refuzimit të kërkesës së shtetit osman për t'iu bashkuar Britanisë së Madhe, Francës dhe Rusisë në luftë, ngase këta të fundit kishin planifikuar që të luftonin në dëm të Perandorisë Osmane, shteti osman ndryshoi kursin i veprimit ndaj këtyre të fundit dhe iu lidh bllokut gjerman dhe austro-hungarez, që e mirëpriti kërkesën e shtetit osman për bashkëpunim.

Do të thotë së, Perandoria Osmane zyrtarisht hyri në luftë në pranverën e vitit 1914, edhe pse mendohet se ka patur disa marrëveshje bashkëpunimi interne mes shtetit osman dhe Gjermanisë edhe para kësaj date.

Në kulmin e luftës së Parë Botërore, shteti osman pësoi disa sulme të fuqishme nga forcat franceze dhe angleze në disa fronte strategjike. Megjithë guximin dhe vendosmërinë e trupave osmane që qëndronin ballë sulmeve franceze dhe angleze, përsëri humbasin betejën si rezultat i numrit të madh, armatimit më modern dhe më të përparuar të forcave evropiane. Dobësimi të forcave osmane i parapriu dhe hapja e shumë fronteve ndaj tyre.

“Shteti Osman luftoi në shumë fronte gjatë Luftes së Parë Botërore: në Kaukaz, në Ngushticën e Dardaneleve, në Palestinë dhe Sina, Irak, Izmir dhe Antalja, Galici, Rumani dhe Dobruxha, Hixhaz, me pasojë 3 milionë viktima, Kështu ky shtet arriti kollapsin duke iu nënshtruar armëpushimit poshtërues të Mondrosë, që iu imponia më 30 tetor 1918. Trupat osmane filluan të dorëzonin armët e tyre, si përfundim Stambolli u pushtua nga fuqitë e Antantës.”²³

Epilogu i Luftës së Parë Botërore ishte i dhimbshëm, ngase pati humbje të mëdha si në njerëz ashtu edhe dëme materiale, pasuan ndryshime të mëdha në sistemin politik dhe të kufijve, filloi epoka e themelimit të shteteve modernë dhe përfundimisht u shpërbënë disa perandori: ajo Austro-Hungareze, Prusia, Perandoria Osmane dhe Rusia. Gjermania humbi zotërimet koloniale dhe shtetet evropiane si Çekosllovakia, Estonia, Finlanda, Letonia, Lituania, Polonia dhe Jugosllavia fituan pavarësinë.

Me përfundimin e Luftës së Parë Botërore, u shkërmoq edhe fuqia osmane. Humbja e aleancës së qendrës ndikoi dhe në kursin e ardhshëm politik të shtetit osman.

Kjo ndikoi në zbehjen edhe më tutje të sulltanatit dhe nxiti lëvizjet pro-perëndimore të turqve reformatorë për ta shpëtuar atë pak territor që ju kishte ngelur nga shkaputjet që i ishin bërë Perandorisë.

Lidhur me përfundimin e Luftës së Parë Botërore, e cila ishte e dhimbshme për Perandorinë Osmane, baronesha Shirley Williams thotë: "Perandoria Osmane e cila sundonte mbi pothuajse të gjithë Lindjen e Mesme, dhe që natyrisht udhëhiqej nga Sulltani i Turqisë, arrinte deri në Kaukaz, në zonat që tani ne i njohim gjithashtu si zonat më revolucionare të Bashkimit Sovjetik. Ajo ishte një perandori kyçe dhe u shkatërrua plotësisht nga Lufta e Parë Botërore. Perandoria e dytë e madhe, e cila u shkatërrua për pjesën më të madhe të saj, ishte Perandoria e Habsburgëve, në një farë mënyre një perandori shumë civilizuese, e cila kontrollonte një pjesë të madhe të asaj që sot quhet Evropa Qendrore dhe Evropa Lindore.”²⁴

²³ Maksudoglu, , f. 564

²⁴ Anëtare e Dhomës së Lartë të Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar (Dhoma e Lordëve)<http://www.zeriamerikes.com>, 2 gusht 2014.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore kur Perandoria Osmane doli humbëse, fuqitë e Atantës e copëtuan edhe më shumë këtë të fundit pikërisht me marrëveshjen e Sevrit të 10 gushtit 1920, ku Sulltani detyrohet që para fuqive të Atantës të pranojë kapitullimin duke u shndërruar në qeveri kukull nën shërbimin e shteteve fituese të Luftës së Parë Botërore, në një farë mënyre u shndërruar në protektorat të shteteve fituese të luftës.

Në luftën për çlirimin e Turqisë që tashmë kishte filluar të marrë formën e një shteti të ri, paraqitet një figurë mjaftë kontraverse për kohën aktuale, ai ishte Qemal Ataturku, një strateg luftarak, ideolog i Turqisë moderne. Ai kishte kundërshtuar idenë e turqve të rinj duke fituar popullaritet të madh në masë. Në kohën kur Ataturku fiton betejat për shpëtimin e Turqisë, në pah paraqiten dy qeveri paralele, ajo e Stambollit me në krye Sulltanin dhe qeveria e Ankarasë që udhëhiqej nga vetë Kemal.

Për të shkaktuar diversion në radhët e turqve, anglezët i dërguan ftesë për të marrë pjesë në konferencën e Lozanës edhe qeverisë fitimtare të Ankarasë, në krye të së cilës qëndronte Mustafa Qemali ashtu edhe qeverisë osmane të Stambollit, që drejtohej nga Tevfik Pasha, që, zyrtarisht përfaqësonte sulltanin. Duke para se një gjë e tillë i rrezikonte pushtetin, Mustafa Qemali, më 31 tetor 1922 deklaroi se e vetmja zgjidhje ishte që të shfuqizohej sulltanati dhe, në këtë mënyrë, të rrëzohej regjimi i Stambollit²⁵. Në sajë të deklaratës së Kemalit për ta zhbërë sulltanatin, më 1 nëntor 1922, kuvendi Kombëtar i Turqisë miratoi legjislacionin e ri që përfundimisht të ndajë sulltanatin nga kalifati, dhe kjo e fundit të ketë vetëm funksionin fetar kurse sulltanati (qeveria) të bëjë politikën kombëtare. Kjo ishte goditja e fundit dhe dëshpëruese për Sulltanin kur sulltan Vahidedini detyrohet të largohet nga Turqia.

Me revolucionin kemalist dhe reformat e tij, qeveria tashmë transferohet nga Stambolli në Ankara si kryeqytet i ri i Turqisë dhe përmes Kuvendit të Madh Popullor, më 19 gusht 1923, Turqia u shpall Republikë duke zgjedhur Mustafa Kemal Pashën (Ataturkun) kryetar të parë të shtetit modern turk.

Edhe pse menjëherë politika kemaliste nuk e zhbëri përfundimisht kalifatin, i njëjti ingerencat i kishte tepër të kufizuara. Qëllimi i politikës së Kemalit ishte që të inskenontë një konflikt mes qeveris dhe kalifatit dhe të ketë arsyeje para popullit që përfundimisht ta abrogojë kalifatin.

Pas manovrimeve politike dhe debateve të ashpra, në mbledhjen e Kuvendit, më 1 mars 1924, Mustafa Kemal e mbajti fjalën hyrëse, ku artikuloi domosdoshmërinë e stabilitetit të shtetit dhe një nga kushtet e rëndësishme për ta arritur atë si kusht theksoi ndarjen e fesë nga shteti. Presidenti i Kuvendit tha menjëherë se ka marrë propozime të përfaqësuesve të shoqëruara me 50 nënshkrime për eliminimin e kalifatit dhe largimin e anëtarëve të familjes sulltanore. Zakonet u miratuan dhe menjëherë u bënë të plotfuqishme. Kalifi i fundit, së bashku me të gjithë anëtarët e familjes u larguan nga Stambolli²⁶.

Kushtetuta osmane e vitit 1876 u zëvendësua me kushtetutën laike të Republikës së re turke, pra më 1923 shpallet republika dhe president i parë i saj shpallet Mustafa Kemal Ataturku, ndërsa më 1924 abrogohet edhe kalifati

²⁵ Hasan Bello, *Marrëdhëniet Shqiptaro-Turke (1912-1939)*, Qendra e studimeve albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë 2015, f. 211

²⁶ Amir Muharremi, *Turqia, hyrje në histori, në politikën e brendshme dhe në atë të jashtme*, Botime Artini, f. 98

1.7 . Një gabim që duhej përmisuar: Perandoria osmane ishte turke

Kur sot përmendet Perandorin Osmane menjëherë kujtohet Turqia e sotme, por sa është real ky parafytyrim?

Si në çdo perandori edhe në Perandorinë Osmane fronin e pasonte pasardhësi i familjes, dhe nëse e marrim për bazë vetëm këtë detaj, i njëjti na jep të kuptojmë se Perandoria Osmane ishte turke por nuk duhet të harrojmë se funksionimi i Perandorisë Osmane sa i përket hierarkisë ishte shumë e fragmentuar, roli i kryevezirit në perandori ishte më i madh se një ministër sot dhe se sadrazemi kishte rolin e kryeministrit të shteteve të sotme moderne, edhe pse kishte kompetenca më të pakta se padishahu, Sulltani. Kryeveziri dhe sadrazemi ishin përcaktues faktikë dhe ekzekutues realë të vendimeve. Nëse kësaj ia shtojmë argumentin e pakontestueshëm se në Perandorinë Osmane kishte diku "39 kryevezirë shqiptarë"²⁷ atëherë na del se Perandoria Osmane nuk ka qenë ashtu siç e paramendojmë, pra turke.

Argument tjetër i rëndësisë së veçantë është se nocioni dhe kuptimi për kombin në kohën e ekzistimit të perandorisë ishte shumë me i zbehtë dhe më i padefinuar, dhe mu kur ky nocion për kombin mori rëndësinë që ka sot, filloi shthurja e perandorisë. Nuk mund të themi se ishte shkaku i vetëm po ishte nga shkaqet kryesore së bashku me faktorët e tjerë politikë e historikë të kohës.

Si shembull për ta pasqyruar këtë do cekim xhonturqit, të cilët në 1902 në Paris mbajtën kongresin "Kongresi i Parë i Turqve të Rinj" të cilët ishin të frymëzuar me qasje më shume nacionaliste edhe pse ishin të kamufluar me petkun liberalist e kushtetues. Me ardhjen e tyre në pushtet fryma nacionaliste turke u vendos në sistemin shtetëror dhe me nismën e tyre u formua Turqia moderne që sot ne e njohim²⁸.

Argument tjetër që duhet shtjelluar është përdorimi i alfabetit arab gjatë ekzistimit të Perandorisë Osmane. Gjuha njihet si osmanishte, me formimin e shtetit turk u hoq dorë nga ky alfabet dhe turqit sot përdorin një alfabet me shkronja latine dhe gjuha e tyre njihet si gjuhë turke.

Përdorimi i alfabetit arab dhe përshtatja e tij është e kuptueshme për shkak të rrethanave historike dhe fetare. Shembull kemi edhe persët që për shkaqe fetare adoptuan alfabetin arab, por është interesant dhe aq paradoksal fakti se si turqit hoqën dorë nga përdorimi i alfabetit të osmanishtes, kur e gjithë historia e shkruar e një perandorie të lavdishme nuk mund të lexohet dhe kuptohet nga bijtë e vet! Nëse aq për zemër turqit do ta kishin Perandorinë Osmane, nuk besoj se do të ndodhte një paradoks i tillë.

Nëse ndalemi dhe lëvrojmë thellë në qenësinë dhe përbërjen e perandorisë se a ishte turke apo jo, do gjenim shumë e më shumë argumente që e thonë të kundërtën e asaj që të quhet turke, ngase veç në përbërje ajo ishte me mbi dhjetëra popuj e fe të ndryshme.

Sulltani ishte turk dhe shumica e kryeministrave të perandorisë ishin të nacionaliteteve tjera. P.sh., thuhet se 39 kryeministra kanë qenë shqiptarë, edhe pse saktë numri i tyre nuk dihet, kurse vetëm 8 kryeministra kanë qenë turq. Kjo i bie se shteti osman është qeverisur prej të tjerëve e jo prej turqve, e mos të flasim për vezirë, bejlerë e pashallarë

"Argument mbi çdo argument është se territoret shqiptare në mesjetë nuk u pushtuan nga turqit siç gënjejnë sllavo-grekët dhe pro-sllavo-grekët, por princat shqiptarë të rrezikuar jetësisht nga sllavo-grekët bizantinë thirrën ushtritë osmane në ndihmë për t'u mbrojtur nga

²⁷ <http://www.albeu.com/biografia-kush-eshte/kush-ishin-39-kryeministrat-shqiptare-te-perandorise-osmane/110018/>

²⁸ Mantran, po aty, f. 527

sulmet sllavo-greke dhe principatat vasale të sllavo-grekëve. Pa dyshim po të kishin mundësi principatat shqiptare të mbroheshin vetë nuk do të kishin kërkuar ndihmën e osmanlinjve. Po ashtu ne shqiptarët e sotëm që u rrezikuam jetësisht nga sllavo-grekët (Millosheviqi dhe përkrahësit e tij) po të kishim mundësi të mbroheshim vetë nuk do të kërkonim ndihmën e Aleancës Atlantike²⁹.

Nëse dakordohemi të themi kështu, atëherë do të ishte joserioze që në të ardhmen, gjeneratat e ardhshme të çoheshin në këmbë kundër NATO-s apo edhe vetë Amerikës, që sot i njohim si ndihmësit më të mëdhenj dhe mikun më të madh të kombit shqiptar.

Pra, të gjitha argumentet logjike na çojnë drejt asaj se Perandoria Osmane nuk ka qenë perandori turke. Asnjëherë nuk ka pasur shtet turk para themelimit faktik të tij në vitin 1924 nga Kemal Ataturku. Dhe shteti turk doli nga shpërbërja e Perandorisë Osmane ashtu siç dolën dhe u themeluan shumë shtete të tjerë, sikurse shteti shqiptar që u krijua në vitin 1912 në disa nga territoret e tij, jo në të gjitha, sepse siç dihet, Greqia, Serbia, Mali i Zi u themeluan edhe në kurriz dhe në dëm të popullit shqiptar dhe të territoreve shqiptare.

Ajo çfarë vlen të ceket është se perandoria osmane duhet konsideruar si një perandori e kohës, një konglomerat popujsh, kulturash dhe religjionesh. Dhe për shumë nga karakteristikat ngjason me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

KAPITULLI I DYTË

2. Shqiptarët dhe Perandoria Osmane: Qasje e përgjithshme

²⁹ Sabri Maxhuni-Novosella-, *Rimëkëmbja*, 18 Prill 2000.

"Dua të theksoj se Perandoria Osmane nuk ishte një Perandori Turke por ishte një perandori e përbërë nga grupe etnike të ndryshme dhe shqiptarët, sidomos shqiptarët myslimanë kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në këtë perandori, më shumë se sa grupet e tjera etnike. Nëse i ktheheni pas historisë do gjenim shumë pashallarë, zyrtarë të niveleve shumë të larta që janë shqiptarë dhe mund të thuhet edhe kështu, shqiptarët shpesh kanë pasur rol edhe më të rëndësishëm se sa vetë turqit në këtë perandori."

Mehmet Hacasalihoglu,
historiani turk

2.1. Pozita e shqiptarëve në Perandori

Pas betejës së Kosovës e cila ndodhi në rrethin e Prishtinës në vitin 1389 mes aleancës ballkanike të përbërë nga serbet, boshnjakët dhe bullgarët³⁰ përballë ushtrisë osmane, kjo e fundit doli fitimtare karshi kësaj aleance e cila kishte fashitur mosmarrëveshjet mes vete dhe kishin filluar luftën me osmanët. Kjo ngjarje të madhe dhe historike e cila më pastaj do të orientonte qartë synimet shtetit osman në Ballkan në fakt pasqyron një aleancë të fuqishme shqiptaro-serbe. Dhe tre vjet pas tragjedisë së Fushë Kosovës, më 1392, Karl Topia firmos testamentin për t'ia lënë Venedikut Durrësin mbas vdekjes së tij. Edhe Gjergj Balsha II e pranoi vasalitetin e Venedikut. Kështu pjesa bregdetare e Shqipërisë, nga Ulqini, Lezha deri në Vlorë mbeti nën sundimin e Venedikut, duke ruajtur trashëgiminë etno-kulturore shqiptare dhe civilizimin kristian.³¹ Balshajt u morën vesh me armiqtë e tyre të vjetër, Tvërtkon e Bosnjës dhe mbretin serb Lllazarin që të merrnin pjesë në koalicionin ballkanik kundër Perandorisë Osmane, por për një gjë të tillë nuk e pranuan Muzakajt dhe Dukagjinët të cilët edhe më tej vazhduan të jenë vasalë të sulltanit osman³².

Pas kësaj luftë osmanët si fitimtarështrinë sundimin në Ballkan gjegjësisht në trojet shqiptare.

Administrimi i Ballkanit, respektivisht i trojeve shqiptare përfshin një periudhë mjaft të gjatë, diku mbi 450 vjeçare, këtë temë duhet trajtuar nga shumë këndvështrime, por si pikë referimi duhet ta kemi bashkëjetesën e shumë popujve në perandori, gjegjësisht në trojet shqiptare si dhe pozitën e shqiptarëve gjatë kësaj periudhe.

"Historiografia tradicionale shqiptare e përshkruan periudhën osmane si një epokë të qëndrës së vazhdueshme të shqiptarëve kundër një pushtuesi të huaj. Dija ndërkombëtare dhe dijetarë të veçantë shqiptarë kanë përfaqësuar prej kohësh një tjetër imazh: në vitet shtatëdhjetë, orientalisti kosovarë Hasan Kaleshi ngriti tezën se pushtimi osman i kishte shpëtuar shqiptarët nga kanosja e greqizimit, përkatësisht sllavizimit. Sipas tij shqiptarët si etni kishin mundur të shfaroseshin tërësisht nëse nuk do të kishte ardhur sundimi osman, ku arritën ta ruajmë e tyre si komb³³.

³⁰ Salabi, po aty, f. 81

³¹ Lisen Bashkurti, ligjërata 1 dhe 2 nga specializimi mbi Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Diplomaci, Akademia Diplomatike Shqiptare, Tiranë.

³² Nuray Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Tiranë, 2002, f. 71

³³ Schmitt, Tiranë, 2012, f. 68

Thënë shkurt, prania osmane kaq shumë vite në hapësirën shqiptare nuk duhet shikuar vetëm nën llupën bardh e zi, ngase të sundohet e të shtypet populli shqiptar kaq shumë vite dhe të ngelë përsëri shqiptar duke ju ruajtur asimilimit total, kjo në vetë përbën një mrekulli. Me siguri se do të kishte mjaftuar kjo periudhë mbi 450 vjeç për t'u tjetërsuar populli shqiptar dhe për t'u asimiluar.

Sipas shumë studiuesve sikur osmanlinjtë të mos vinin në Ballkan, gjegjësisht në trojet shqiptare, ka pasur shumë gjasa që shqiptarët të asimiloheshin në serbë, sllav edhe të tjetërsoheshin, siç potencon edhe albanologu Malkolm: "Duke marrë parasysh mbisundimin e serbëve ortodoksë, si edhe të gjuhës serbe në Kosovën mesjetare, ka arsye të mendohet se rrjedha e përgjithshme e asimilimit ka qenë në favorin e serbëve, me disa dallime të vogla. Konkluzioni kryesor duhet të jetë se, pa marrë para sysh se në ç'shikallë ka qenë asimilimi, ai është bërë: shumë veta të cilët iu nënshtruan këtij procesi, duhet të kenë lënë gjuhën e tyre shqipe dhe janë bërë serbë³⁴".

Ardhja e osmanëve në Ballkan, gjegjësisht beteja e përgjakshme e Kosovës, na bën të kuptojmë se kjo perandori ishte pushtuese ngase në këto troje u vendos me luftë, por qëndrimi i saj me shekuj në këto treva nuk ngjan të jetë i tillë ngase katër ose pesë shekuj qëndrim në hapësirën shqiptare nuk mund të quhet më pushtim. Bëhet fjalë për një bashkëjetesë me popujt tjerë, pra ajo ka administruar dhe qeverisur në trojet shqiptare, në fakt ishin vetë shqiptarët që i administronin dhe qeverisnin trojet e tyre dhe hapësirat e tjera ballkanike por edhe më gjerë. Me fjalë të tjera vetë shqiptarët kanë qenë në pozita udhëheqëse në perandori, bile më të larta se vetë turqit, pashallarë, vezirë, kadilerë, e deri te pozita si kryeministra perandorakë. Jo vetëm kjo, gjendja sociale dhe ekonomike ka qenë e shkëlqyer tek shqiptarët, niveli intelektual i tyre i lartë. Pra "gjendja e Shqipërisë ishte e shkëlqyer; vendi ishte i pasur, i lumtur dhe i fuqishëm, fuqia e tij ushtarake ishte e konsiderueshme. Në një kohë kur sunduesit e fuqishëm të Evropës nuk ishin në gjendje të mblidhnin nën armë as 100.000 burra, Shqipëria ishte në gjendje të rreshtonte një ushtri prej 60 - 80.000 vetësh.³⁵"

Nevoja e Perandorisë për shqiptarët dhe anasjelltas

Politika osmane kishte për qëllim zgjerimin e territoreve të veta, gjegjësisht futjen e Rumelisë nën administrimin osman, e që pastaj në Ballkan të gjejë popuj që do t'i ndihmonte sulltanatit në qeverisjen e perandorisë. Në këtë drejtim, shqiptarët dhe boshnjakët dolën më besnikët për ta përmbushur agjendën perandorake të zgjerimeve.

Perandoria në rritje, në trojet shqiptare gjeti popull përmes së cilëve do ta realizonte politiken e saj perandorake, do ta forconte pozitën e vet në Ballkan nga ku do ta sundonte dhe Rumelinë përmes pashallarëve shqiptarë.

Te shqiptarët perandoria gjeti kuadër serioz dhe besnik që do t'i hynin në punë qeverisjes së saj, shqiptarët i gjeti trima të vërtetë dhe sypatrembur karshi padrejtësive, prandaj dhe atyre iu besua udhëheqja e pozitave të larta në perandori.

Në kuadër të kësaj, Pashko Vasa e bën një përshkrim të mrekullueshëm të mundësive dhe aftësive të karakterit të shqiptarit në perandori, duke thënë: "Në qoftë se Porta e Lartë, duke e ditur mirë karakterin luftarak të shqiptarëve, do t'i jepte atyre një organizim ushtarak

³⁴ Malkolm, po aty, f. 53

³⁵ Pashko Vasa, *E vërteta për Shqipërinë dhe shqiptarët*, Paris, 1879, f. 30

të ngjashëm me atë të Zvicrës, atëherë Shqipëria do të ishte në gjendje ta furnizonte atë në 6-8 vjet me 200 batalione, me trupa të organizuara mirë, të stërvitura, të disiplinuar, të bindura dhe trimash, të cilët do të jepnin jetën një nga një për të drejtat dhe interesat e Perandorisë, në shenjë besnikërie të patundur, devotshmërie të palëkundur dhe shenjë mbështetjeje dhe bindjeje ndaj personit të madhërishtëm të sovranit të saj.³⁶

Ne ndajmë mendimin me historianët turq të cilët pohojnë se shqiptarët kanë bashkëqeverisur me perandorinë, sa turqit aq dhe shqiptarët. Shpeshherë pozita e shqiptarëve në udhëheqjen e perandorisë ka qenë më e lartë se e vetë turqve. Këtë e pohon historiani turk Mehmet Hacısalihoglu:

” Perandoria Osmane nuk ishte një Perandori Turke por ishte një perandori e përbërë nga grupe etnike të ndryshme dhe shqiptarët, sidomos shqiptarët myslimanë kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në këtë perandori, më shumë se sa grupet e tjera etnike. Nëse i ktheheni pas historisë do gjeni shumë pashallarë, zyrtarë të niveleve shumë të larta që janë shqiptarë dhe mund të thuhet se shqiptarët shpesh kanë pasur rol edhe më të rëndësishëm se sa vetë turqit në këtë perandori.³⁷”. Mohimi i këtyre të vërtetave nga disa historianë shqiptar do të thotë mohim i një pjesëe shumë të lavdishme të së kaluarës sonë që ka të bëjë me udhëheqjen e një prej perandorive më të mëdha që ka njohur historia e njerëzimit.

Një historian shqiptar pohon se boshnjakët dhe shqiptarët kanë qenë shpirti i perandorisë në Ballkan. Pa pashallarët boshnjak dhe shqiptarë, pa një armatë administratorësh shqiptarë e boshnjakë, shteti osman e ka patur të vështirë t’iu bëjë ballë në de Venedikut dhe në fushat e Hungarisë habsburgëve.³⁸

Një pikë tjetër që është me rëndësi të potencohet këtu është interesi i dyanshëm sa i përket qeverisjes osmane në trojet shqiptare. Elita intelektuale me mprehtësi dhe diplomaci shfrytëzonte fuqinë e perandorisë në trojet shqiptare. Përkundër faktit se shqiptarët tashmë kishin një administrues mbi kokat e tyre ata e shfrytëzuan këtë mundësi për t’u bërë aleatë me ta dhe për t’i mbajtur trojet e tyre unike ngase në vazhdimësi kishte pretendime të shpartallosjes së trojeve shqiptare, gjë që ndodhi më vonë, kur fqinjët përreth copëtuan tokat shqiptare.

Duke qenë se shqiptarët tashmë ishin faktor kyç në perandori dhe trojet shqiptare vend strategjik nga ku administrohej Ballkani dhe Rumelia në përgjithësi, qeverisja e Stambollit i kushtonte rëndësi të posaçme paprekshmërisë së kufijve të perandorisë brenda së cilave ishin trojet shqiptare.

"Prandaj, kur shqiptarët flasin për ardhjen e osmanëve në Ballkan, në këtë rast duhet të flasin për ardhjen e tyre në territoret, të cilat kanë qenë të sunduara prej serbëve. Më saktë, këto territore kanë qenë të sunduara nga Llazar Hrebellanoviqi (pjesa lindore e Kosovës me Novobërdën si qendër), nga Vuk Brankoviqi (me Prishtinën si qendër) dhe nga Toma Preluboviqi, (ky i fundit në Epir). Ata ishin sundimtarë në mbeturinat e dinastisë serbe, e cila filloi të fragmentohej pas vdekjes së Uroshit në Betejën e Maricës (1371), me ç’rast u shua trashëgimia nemanjide. Kjo është pika të cilën duhet ta kemi gjithmonë parasysh, sepse kur kanë ardhur osmanët në Ballkan, nuk ka pasur një shtet shqiptar, ose mbretëri shqiptare, të

³⁶Vasa, po aty, f. 37

³⁷<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=24691>

³⁸<https://www.youtube.com/watch?v=tp4C1Ipgvxo>

cilën ata ta kenë prishur, por ka pasur popull shqiptar që ka qenë i pushtuar prej serbëve dhe në një proces të thelluar asimilimi fetar e kolonizimi etnik.³⁹ⁿ

Dikur shqiptarët thurnin vargje dhe poezi për mbështetjen që sulltanati u jepte shqiptarëve. Këtë e dëshmon kjo këngë e kënduar dikur nga Salih e Feriz Krasniqi:

*"Rrehi teli për Shqipëri i vajti babës (duke aluduar në Sulltanin) haber i zi.
Katër krajla janë ra në Shqipëri,
Cërna Gora (Mali i Zi) me Serbi.
O Junani (Greku) me Bugari (Bullgari),
Presin rob e po presin sabi (fëmijë)."*

Kur ndodhi problemi i vërtetë dhe kërcënimi i territoreve shqiptare? Atëherë kur ra Perandoria Osmane ranë edhe shqiptarët e boshnjakët, me dobësimin e perandorisë u dobësuan dhe shqiptarët, për pasojë në marrëveshjet ndërkombëtare u copëtuan trojet shqiptare nga ku dhe sot vuajmë ndarjet territoriale.

“Eksperienca e pesë shekujve ka provuar se bashkimi i tyre (shqiptarëve) i ngushtë me Perandorinë Osmane përbën shansin e vetëm të shpetimit; Është ky bashkim që siguron një jetë të përshtatshme me dëshirat dhe aspiratat e tyre sepse nuk cenon as mendimet kombëtare, as gjuhën dhe as traditat e tyre, nuk transformon karakterin e popullit dhe nuk kërcënon ekzistencën e tij nga pikëpamja e racës dhe e kombësisë.”⁴⁰ⁿ

Me të drejtë thotë mësuesi Mati Logoreci thotë: "Ne katolikët (shqiptarë) ekzistojmë në sajë të myslimanëve (Perandorisë Osmane). Po të mos ishin myslimanët, sllavët prej kohësh do na kishin asimiluar ose do na kishin përzënë prej këtej.”⁴¹ⁿ

Diplomacia e rilindësve shqiptarë e cila luhej kaq bukur dhe në vendin e kohën e duhur bëri që aleat të fuqishëm ta kishte qeverinë e Stambollit, gjë që ishte edhe në interes të perandorisë. Kjo më bukur përshkruhet në Lahutën e Malsisë:

*"Pse kend fis as vllá nuk kemi,
Na sod Shkjaut s'mund t'i bâjm ballë, Qi po do t'na perpËjë gjallë;
Prandej, thom, se e lypë e mara, Qi edhë sod na si perpara,
Të rrijm njëjtë me mbret t'Stambollit, Per me i bâumun ballë Nikollit.”*⁴²ⁿ

Raporti i shqiptarëve në perandori me identitetin e tij kombëtar

Elita politike dhe intelektuale shqiptare ishte zemra e Perandorisë Osmane, element kreativ në qeverisjen e saj. Ndikimin më të madh shqiptarët e kanë pasur në kohën e turqve të rinj, kuptohet në territore shqiptare ngase ishte parim i diplomacisë osmane që hapësirat me komunitete të ndryshme brenda territorit osman t'ia lë në qeverisje po atij komuniteti. Kjo si rezultat i asaj se pashallarët shqiptarë i njihnin më së miri territoret e veta, shoqërinë shqiptare dhe fqinjët. Pjesa më e madhe e intelektualëve shqiptarë dhe rilindasve ishin edukuar dhe shkolluar në Stamboll, si dhe një pjesë e mirë e tyre tashmë ushtronin veprimtaritë e tyre

³⁹Shenja, shtator 2012,

⁴⁰Vasa, po aty, f. 33

⁴¹ Mati Logoreci, (1867-1941), mësues i shkollës së parë shqipe. "Bota Sot", 17 nëntor 1998.

⁴² Gjergj Fishta, *Lahuta e Malsisë*, Kënga: Lidhja e Prizrenit, f. 160

intelektuale në Stamboll duke dhënë kontributin e tyre në fusha të shumta. Një karakteristikë e tyre ishte se përkundër veprimtarisë në interes të sulltanatit, ata nuk e kishin humbur identitetin e tyre dhe me krenari pohonin se ishin shqiptarë.

Ishte një mundësi e mirë që intelektualët shqiptarë të afirmoheshin dhe të thithnin njohuri të duhura intelektuale dhe përvoja të mira brenda territoreve të gjëra osmane, në veçanti gjatë edukimit të tyre në Stamboll nga ku shumë rilindës do të kthehen me elan të fuqishëm për ta ngjallur vetëdijen e popullit drejtë nacionalizmit shqiptar.

Përderisa lëvizjet e shqiptarëve ishin të pacenuara e shqiptarët banonin e shkonin ku të donin brenda territorit osman, nuk kishte ende një vetëdije nacionaliste e cila do ti lëkundte idetë e shqiptarëve drejt një kombi të vetëm "Territori ku kanë banuar shqiptarët është pak i vështirë të përcaktohet saktësisht, pasi gjatë Perandorisë Osmane nuk kishte kufij dhe popullsia banonte ku të donte."⁴³

Por me lëkundjen e kufijve osman dhe me rëniën e stabilitetit të kësaj perandorie të fuqishme, veçanërisht në Ballkan, intelektualët shqiptarë filluan të lëviznin me të madhe drejt konsolidimit të idesë për nacionalizëm ngase ishte e qartë se me rëniën e osmanëve, bien dhe shqiptarët e territoret e tyre cenoheshin nga fqinjët, siç edhe ndodhi.

Përgjatë periudhës së mesjetës shqiptarët nën administrimin osman nuk u sulmuan në identitetin e tyre, dhe nuk shohim asimilim të tyre, shqiptarët lejoheshin të flisnin gjuhën e tyre dhe krenoheshin me identitetin e vet.

Koncentrimi i forcës udhëheqëse ishte në Stamboll, ku gjuha zyrtare ishte osmanishtja por e drejtë e secilit popull ishte ta flasë gjuhën e vet. Siç thotë Ismail Kadare në librin *Mosmarrëveshjet*: "Në ushtrinë osmane, në Betejën e Kosovës, me 1389, fliteshin 40 gjuhë. Është thënë se Perandorinë Osmane e kanë përbërë 62 milete – popuj".

Fatkeqësisht synimi i qeverisë osmane ishte që të krijonte një shtet të fuqishëm osman që në të ardhmen popullsia të njihej si osmane duke mos u dhënë hapësirë të mjaftueshëm popujve tjerë në zhvillimin e identiteteve të tyre, gjë kjo që shkaktoi kaos në fund shek. XIX kur me të madhe u përhap fryma e nacionalizmit. Natyrisht, kjo frymë i preku edhe ndjenjat e intelektualëve shqiptar

Në momentet kur diplomacia e rilindasve punonte me të madhe që të ngjallte idenë për një komb shqiptar, kur shqiptarët e shquar udhëtonin nëpër botë me qëllim që të gjenin përkrahje për realizimin e idesë së tyre, me marrjen e pushtetit nga turqit e rinj u shfaqën ide për ta turqizuar shtetin multikulturor dhe multietnik osman.

Ismail Qemali nuk dakordohej që për politikat jo të singerta të turqve të rinj që zbatoheshin karshi kombeve joturke, posaçërisht shqiptarëve, të akuzohej Perandoria Osmane si një tërësi. Këtë do ta deklaronte në intervistën e tij dhënë për *New York Times* të vitit 1911: "Shqipëtarët muslimanë, pavarësisht nga vuajtjet e shumta dhe të rënda që i përjetonin nga politika e mjerueshme e pushtetit të turqve të rinj gjatë vitit të kaluar apo dy viteve të fundit, nuk do të qëndrojnë duar kryq, nëse lind nevoja dhe do të bien për mbijetesën e perandorisë në gropen (varrin) e fundit"⁴⁴

Tanzimati dhe zhvillimi i ideologjisë nacionaliste

⁴³ Elena Kocaqi, *Levanti: Planet për zhdukjen e shqiptarëve*, f. 21

⁴⁴ *The New York Times*, 31 dhjetor 1911.

Diplomacia perëndimore i kishte shpallur luftë të hapur zhvillimit osman në Evropë, gjegjësisht në Rumeli.

Sulltan Abdulmexhidi ishte mjaft inteligjent, i mëshirshëm, njeri që kishte dëshirë për reforma, që kishte simpati ndaj sistemeve moderne dhe angazhohej për ndryshime, sa që gjatë qeverisjes së tij u jetësuan shumë reforma në ushtri dhe u bënë përparime të mëdha në zhvillimin e komunikimit, duke u lidhën tela telefonikë, duke u ndërtuar hekurudha moderne.

Më 1839 Abdulmexhidi mori pushtetin dhe rregulloi sistemin udhëheqës, duke e marrë në qeverinë e tij ustafa Rashid Pashën, ambasador në Londër dhe Paris.

Diplomacia perëndimore kishte ndikuar thellë tek Mustaf Rashid Pasha i cili kishte marrë përsipër të fillonte reforma brenda perandorisë, reforma këto që do të ndikonin në fillimin e dobësimit të shtetit osman. Ndërkohë u dha mundësia për futjen e forcave misionare perëndimore si dhe për zhvillimin nacionalist të popujt brenda perandorisë.

Tanzimati (reformat) osmane u nënshkruan në vitin 1839 nga dora e sulltanit me emrin "Hat-i Sherifi i Gylhanes" me protagonist Mustafa Reshid Pashën.

Reformat filluan ta dobësojnë legjislacionin osman i cili ishte sheriat duke futur shuma nga ligjet laike franceze, e zvicerane, duke u mundësuar që brenda shtetit osman të futen shumë tradita perëndimore të cilat binin ndesh me legjislacionin e atëhershëm osman.

Filloi të centralizohet shteti e të bëhën reforma për të drejta të shtetasve jomuslimanë, të drejta për të qenë të barabartë para ligjit pa dallim feje dhe kombi. Por kjo disi ishte fiktive ngase nacionalizmi xhonturk filloi t'i qesë krahët, dhe kjo me vendimin që të gjithë nëpunësit shtetërorë të dinë gjuhën turke, e cila atëherë nuk ishte e vetmja zyrtare, një imponim që iu bë edhe shqiptarëve.

Me shpalljen e kushtetutës së parë laike e cila ishte kopje e asaj franceze, belge e zvicerane disa nga rilindasit shqiptarë si Abdyl Frashëri, Konstatin Kristoforidhi, Jusuf Podgorica etj. u bënë deputetë në parlamentin e parë të posathemeluar osman duke përfaqësuar krahinat shqiptare.

Shtresa intelektuale shqiptare duke shfrytëzuar ato të drejta brenda perandorisë, pati rastin dhe mundësinë që të përfitonte nga mundësia për zhvillim kombëtar nacionalist që ditatë vinte në shprehje me të madhe tek popujt brenda perandorisë. Dhe e dyta ishte largpamësia e diplomacisë së rilindasve shqiptarë rreth të ardhmes së trojeve shqiptare, ngase me reformat osmane do t'u jepej mundësia vendeve perëndimore të ndikojnë në dobësimin e shtetit osman, nga ku pastaj shtetet fqinje do ta kishin më të lehtë uzurpimin e tokave shqiptare.

Pra, Tanzimati ishte fillimi i ndryshimit të ideologjisë së shtetit osman nga e cila pastaj nxirret kushtetuta e Mit'hat Pashës duke u bazuar në praktikën e kushtetutave sekulariste dhe kjo u pa si një mundësi e popujve për të menduar drejtë kombeve të tyre, nga një "ummet" (bashkësi globale e besimtarëve) në "kombe".

Revolucioni xhonturk i vitit 1908 dhe shqiptarët

E tërë kjo ngjarje filloi me idenë e revolucionit nacionalist, i prirë nga një grup reformatorësh turq dhe shqiptarë siç ishte Ibrahim Temo.

Të rinjtë e shkolluar dhe edukuar në botën perëndimore, të frymëzuar me demokraci pro-perëndimore, të frymëzuar nga Revolucioni Francez për *liri, demokraci e përparim*, të nxitur nga grupet misionare që tashmë kishin një platformë të qartë për shtetin osman, e ajo

ishite dobësimi i legjislacionit qeverisës osman i bazuar në shariat, duke u dobësuar dhe larguar Sulltan Abdulhamidin II i cili ishte ithtar i qeverisjes absolute hyjnore, apo së paku trysninë mbi sulltanin për rivendosjen e kushtetutës së vitit 1876 e cila bënte reforma në qeverisje, evropianizim të shoqërisë osmane, dhe decentralizim të qeverisë osmane, duke ju dhënë të drejta më të mëdha në fusha të ndryshme kulturore komuniteteve që ishin pjesë e perandorisë.

Me revolucionin e 1908-ës, diplomacia shqiptare duke qenë si më e konsoliduar në mesin e popujve në hapësirën osmane së bashku me turqit e rinj i dhanë shtytje të fortë idesë për një komb dhe shtet të pavarur.

Turqit e rinj bashkë me shqiptarin Ibrahim Temo themeluan një shoqëri me emrin "Përparim dhe Bashkim" (*Ittihat ve Terakki*) dhe përmes kësaj organizate do të fillonin agjitacionin politik me program demokratik, fillimisht duke propaganduar kundër sulltan Abdulhamidit II, duke e çuar punën deri te fillimi i revolucionit ushtarak.

Shqiptarët e shfrytëzuan këtë shans në të cilën shihnin një rreze drite në fund të revolucionit, ngase ideja nuk ishte të dobësohej Perandoria Osmane, por të fuqizohej roli i kombësive në perandori, duke i dhënë të drejta më të mëdha secilit komb që ishte nën hapësirën osmane, dhe me këtë shqiptarët përfitonin shumë mëqë ideja nacionaliste tashmë kishte filluar të merr hov tek elita intelektuale shqiptare. Ata këtë moment historik donin ta shfrytëzonin.

Përkundër bindjes se revolucioni i turqve të rinj në platformën e vet ishte korrekt me kombet e tjera në shtetin osman, duke iu mundësuar që të ngjallnin ndjenjat kombëtare, në fakt krijohej një përshtypje se populli turk ishte komuniteti më i madh në perandori dhe tendencat për zgjerimin e territoreve të tyre tashmë dukeshin: përmes lirive dhe të drejtave që iu jepte revolucioni kombësive të tjera të përfitonin turqit duke futur ndikimin e tyre edhe tek të tjerët. Neni 18 në programin e turqve të rinj thoshte se "çdo nëpunës i administratës së Perandorisë Osmane duhet ta dijë gjuhën turke". Osmanishtja ishte gjuhë zyrtare, popujt lejoheshin ta flisnin dhe ta përdornin gjuhën e tyre amtare, dhe tani situata ndryshoi. Shqiptarët filluan të mendonin ndryshe lidhur me revolucionin.

Kjo ide më së miri pasqyrohej në debatin e zhvilluar mes një oficeri xhonturk dhe një revolucionari shqiptar, Dervish Himës, në një mbledhje festive për suksesin e revolucionit. "Që këtë e tutje nuk ka më myslimanë, nuk ka më ortodoksë, nuk ka më nacionalistë të ndryshëm, ka vetëm një komb osman, tha oficeri xhonturk Qazim Beu. Ai që ndërprerë nga Dervish Hima: "Shqiptarët, nuk janë veçse shqiptarë dhe ata nuk do të jenë të kënaqur veç kur të jenë të lirë në Shqipërinë e lirë, në mes të konfederatës së shteteve ballkanike nën sovranitetin e sulltanit."⁴⁵

Revolucioni i turqve të rinj i dha diplomacisë shqiptare hapësirë dhe kohë të mjaftueshme për t'iu rrekur angazhimeve që do të ndikonin në ngritjen e vetëdijes kombëtare, duke hapur shoqata dhe revista të cilat kryesisht merreshin me zhvillimin e traditës dhe kulturës shqiptare, identitetit kombëtar, gjithnjë nën një vëzhgim të rreptë të qeverisë xhonturke.

Në një dokument të Arkivit Osman të Kryeministrit të Turqisë shkruan:

"Në Shqipëri është krijuar bindja se me largimin e pushtetit të Abdulhamidit II, dhe me ardhjen e Ittihatistëve (xhonturqve), do të garantoheshin më shumë liri dhe mundësi për

⁴⁵ Peter Bartl, *Mytlimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, f. 197

vëllazëri mes myslimanëve dhe të krishterëve. Mirëpo vërehet se regjimi xhonturk është shumë më i dëmshëm se ai i Abdulhamidit. Sepse regjimi i këtij të fundit, së paku bazohej në besimin në Zot dhe Kur'an. Ndërsa xhonturqit nuk besojnë në asgjë dhe vazhdimisht i torturojnë myslimanët dhe të krishterët.

Ne shqiptarët nuk duhet të shpresojmë asgjë të mirë tek këta njerëz që dëshirojnë të na shkatërrojnë e numri i të cilëve dita-ditës po rritet në Stamboll. Prandaj, ne shqiptarët myslimanë e të krishterë duhet të bashkohemi e të betohemi që ta shpëtojmë atdheun nga këta miq të rremë.

Të gjithë ne, myslimanë e të krishterë besojmë në Zot. Vetëm një dallim kemi. Disa praktikojmë fenë sipas Kur'anit e disa sipas Biblës. Një popull i lashtë e i nderuar siç jemi ne, nuk mund të pranojë që të jetë peng i disa mashtruesve të paskrupullt. Ne, muslimanë e të krishterë, si robër të Zotit, jemi vëllezër me njëri-tjetrin. Gjersa të shpëtojmë fenë dhe atdheun nga dora e tyre, duhet që të bëhemi tok së bashku. Në emër të Zotit rroftë Shqipëria e lirë dhe u shkatërrofshin idhujtarët e Stambollit (Qeveria "İttihat ve Terakki")⁴⁶.

Siç dukej diplomacia shqiptare tashmë kishte vërejtur lajkat xhonturke dhe ishin të zhgënjyer prej tyre.

2.2. Personalitetet shqiptare në Perandorinë Osmane

"Nuk mundemi që duke urryer një popull apo ideologji fetare, ta rrënjosim një të kaluar të lavdishme të popullit tonë shqiptarë."

Mendoj se duhet të largohet pluhuri i urrejtjes nacionale karshi Perandorisë Osmane për ta zbuluar të vërtetën e të kaluarës së lavdishme të shqiptarëve në atë periudhë, ngase shqiptaret kanë bërë histori dhe kanë lënë gjurmë."

Personalitetet shqiptare që mund të kenë qenë burra shteti, ushtarakë, reformatorë, dijetarë, arkitektë, shkrimtarë, poetë, historianë, pasqyrohen gjerësisht në këtë histori, sepse elementi shqiptar ishte pjesë dhe dha ndihmesë të madhe në zhvillimet historike të Perandorisë Osmane, shumë më tepër se në ndonjë tjetër histori shtetesh.

Periudha mbi 500 vjeçare bashkëqeverisëse në Perandorinë Osmane për shqiptarët ka qenë një përvojë e rëndësishme për ndërtimin e së ardhmes së tyre. Nga Stambolli shqiptarët u kthyen me kulturë të gjerë intelektuale dhe njohuri të shkëlqyera shkencore, njohuri të mira luftarake dhe famë të madhe, ngase Stambolli në atë kohë ishte qendër e zhvillimit intelektual dhe kulturor.

Shqiptarët në perandori patën ndikim dhe pozitën më të madhe të mundshme, nga numri dy i qeverisjes pas Sulltanit deri në administratorin më të thjeshtë, siç thotë dhe Kryetari i Institutit Albanologjik të Kosovës, Hysen Matoshi: "Duke qenë më shumë se pesë shekuj pjesë e Perandorisë Osmane, një numër dijetarësh e njerëzish të shquar të kombit tonë, zunë vend në hierarkinë më të lartë shoqërore shpesh është përmendur një numër

⁴⁶Esat Çaglar, *Komiteti i Shqiptar i Stambollit*, 22.10.1909.

sadriazemësh, vezirësh, pashallarësh, udhëheqësish ushtarak shqiptarë që ishin bërë pjesë e njërës ndër perandoritë kryesore të kohës.⁴⁷

Mendoj se hulumtimi i hollësishëm mbi personalitetet shqiptare me ndikim në botën osmane, do të na zbulonte dhe një të kaluar të shkëlqyer të një pjese të historisë sonë kombëtare, ngase populli shqiptar i ka dhënë burra të mëdhenj perandorisë, personalitete që u bënë të njohur në mbarë botën ngase Perandoria Osmane ishte ndër perandoritë më të fuqishme të kohës.

Për një periudhë të gjatë shqiptarët udhëhoqën shtetin osman dhe shpeshherë u bënë shkaktarë të ngritjes së perandorisë pasi që vinte buzë greminës, siç është rasti me familjen e njohur Qypriy që vinin nga Berati.

Pozita e shumicës së shqiptarëve në shtetin osman vinte nga institucioni i "*devshirmes*", selektimit të kapaciteteve më të mira nëpër familjet shqiptare. Këto përzgjedhje shpeshherë bëheshin nga vetë sulltani dhe të rinjtë sillleshin në Stamboll për t'u aftësuar në fusha të ndryshme, dhe nga aty fillonte karriera e shqiptarëve në drejtimin e shtetit osman, siç ishte edhe figura historike e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

Historiografia shqiptare nuk është e përcaktuar definitivisht në numrin e saktë të sadriazemëve (kryeministrave) shqiptarë, siç duket ende ka hapësirë për hulumtimin e arkivave osmane dhe studimin e thukhtë të origjinës së kryeministrave osmanë.

Në një studim rreth origjinës së kryeministrave shqiptarë, gjejmë të jenë 39 kryeministra, në një tjetër na dalin⁴⁸ së paku 35 kryeministra shqiptarë. Ka edhe një studim tjetër nga studiuesi turk Abdul Kadir Ozcani cili thotë se ishin 34 kryeministra shqiptarë që kanë udhëhequr Perandorinë Osmane.⁴⁹

Nikollë Loka në studimin e tij⁵⁰ na nxjerrë 44 kryeministra shqiptarë që udhëhoqën perandorinë, duke ofruar dhe biografinë e secilit veç e veç dhe prejardhjen e tyre. Shifra e fundit nuk është e saktë ngase autori vezirin dhe kryeministrin i paraqetme pozitë të njejtë, kurse dihet fort mir se veziri nuk ka nënkuptuar kryeministrin, por ka qenë në pozitë më të madhe se ministri i sotshëm dhe më të vogël se kryeministri.

Dihet se dinastia e qypriyljeve, mes viteve 1656-1683 ka dhënë ndihmesën e vet në konsolidimin e shtetit osman, i cili në këto vite përjetoi situata të vështira të brendshme dhe të jashtme. Do përmendur edhe shqiptari Koçi Beu, reformator i shquar, i cili në vitet 1630 paraqiti pranë Portës së Lartë projektin e reformave për modernizimin e shtetit osman, dijetarin e madh Hasan Tahsin, rektor i universitetit të parë të Stambollit dhe autor i disa librave shkencore. Sami Frashëri është autor i fjalorit të madh enciklopedik *Kamus u'l-A'lam*, shkrimtar që e nxori letërsinë nga pallati dhe e çoi te populli. Merita të jashtëzakonshme ka edhe Mehmet Akif Ersoj dhe shumë shkrimtarë të tjerë lanë vepra në thesarin e kulturës turke, Arkitekt Sinani, si kryearkitekt në vitet 1595, që projektoi vepra madhore në arkitekturën osmane. Perandoria Osmane kishte nevojë për forca të reja; shqiptarët u bënë besnikët e parë që

⁴⁷ Simpozium Shkencorë mbajtur në Ulqin/Tuz në vitin 2011 me temë: Shqiptarët në Perandorinë Osmane, organizuar nga Qendra për Mirëkuptim Ndërkulturor "Horizonti" Ulqin/Tuz, 06-07.06.2011 <https://www.youtube.com/watch?v=93IBT8n-MW4>

⁴⁸ <http://koha.net/?id=4&l=5888>

⁴⁹ <http://www.albasoul.com/modules.php?op=modload&name=News&file=article&sid=715>

⁵⁰ Nikollë Loka, *Arnautomania, 44 Kryevezirë dhe 170 vjet qeverisje shqiptare në Perandorinë Osmane*, Botues Geer

jetonin në kuadër të kësaj perandorie...Perandoria Osmane kishte 34 sadriazemë (kryeministra) shqiptarë dhe gjatë kohës së ekzistencës së kësaj fuqie botërore, shqiptarët qëndruan në krye të qeverisë afërsisht 150 vjet ose 1/6 e kohës së ekzistencës së kësaj perandorie. I pari kryevezir që erdhi në pushtet ishte Koço Daut Pasha në vitin 1493, i cili ishte me prejardhje shqiptare.⁵¹

Qyprilinj, familja më e njohur që udhëhoqi Perandorinë Osmane për disa breza

Mehmet Pasha Qypriliu ishte nga rrethi i Beratit i cili hapi derën i pari për udhëheqje në perandori nga ku pastaj disa vite e breza me radhë pasardhësit e tij qeverisën shtetin e fuqishëm osman. Në pozitën e udhëheqësit të shtetit më të fortë të asaj kohe erdhi nga institucioni i devshirmes e më pastaj për t'u ngritur në pozitën më të lartë shtetërore. Duke folur mbi familjen Qyprili studiuesi dhe albanologu zviceran Oliver Schmitt mes tjerash thotë: "Famën më të madhe e arritën së fundi vezirët me origjinë shqiptare të dinastisë Qyprili, të cilët stabilizuan, aty nga mesi i shek. XVII, Perandorinë Osmane dhe udhëhoqën luftërat pushtuese kundër habsburgëve, Polonisë dhe venedikasve."⁵²

Një radhitje të udhëheqësve dhe pasardhësve të kësaj familjeje pasqyrohet kështu:

Qyprili Mehmet Pasha (1656-1661), Qyprili Fazil Ahmet Pasha (1661-1676), Qyprili Kara Mustafa Pasha (1676-1683), Qyprili Fazil Mustafa Pasha (1689-1691), Qyprili Hysen Pasha (1698-1702), Qyprili Numan Pasha (1710, dy muaj e tre ditë) dhe përfundon me prof. Dr. Fuad Qyprili, zv/kryeministër, ministër shteti dhe ministër i jashtëm i Turqisë moderne⁵³

Disa nga personalitetet tjera shqiptare të pushtetshme në perandorinë osmane, të cilët kanë lënë gjurmë në historinë osmane por edhe historinë më të re turke janë:

Sadriazemë-Kryeministra

1. **Arnaut Haxhi Halil Pasha** - lindur në Elbasan më 1655 dhe vdekur më 1733 - Sadrazem-Kryeministër.
2. **Ajaz Ahmet Pasha** - lindur në Vlorë dhe vdekur në Stamboll 1539, Sadrazem-Kryeministër.
3. **Turhunçu Ahmet Pasha** - lindur në Mat-Shqipëri, vdiq në Stamboll më 21 mars 1653, Sadrazem-Kryeministër.
4. **Pargali Ibrahim Pasha** - lindur në Pargë, vdiq në Stamboll më 15 mars 1536, Sadrazem-Kryeministër.
5. **Kemankesh Kara Mustafa Pasha** - lindur më 1592 dhe vdekur në Per-1644, Sadrazem-Kryeministër.⁵⁴
6. **Koxha Sinan Pasha** – lindur në Topojanë, krahinën e Lumës në vitin 1506 dhe vdekur në Stamboll në vitin 1596 ende në pozitën e Kryeministrit. Ishte pesë herë kryeministër, Guvernator i Egjiptit, Damaskut, pushtoi Jemenin, ndër më të pasurit në perandori, bamirës i madh. "Kronisti Osman Evlija Çelebi shkruan: "Sinan Pasha ka ndërtuar kalanë e Kaçanikut, xhaminë dhe shumë objekte të tjera, që i dhanë rreth vitit 1600 pamje të zhvilluar kësaj qendre. Siç tregon vakufnameja e tij, zbuluar dhe botuar nga Hasan Kaleshi, në Kaçanik ai ka

⁵¹ Arbër Berisha, *Toleranca Osmane dhe Shqiptarët*, Prishtinë 2012, f. 34

⁵² Schmitt, f. 70

⁵³ <http://bashkiaberat.gov.al/?p=2749>

⁵⁴ Berisha, f. 35

ndërtuar edhe një shkollë, dy hane dhe një banjo publike; ka paguar rrogat e nëpunësve, ka dhënë para për mirëmbajtjen e objekteve të ndryshme⁵⁵"

7. **Mehmed Ferid Pasha** – nga Vlora, lindur në vitin 1852 në Janinë dhe vdiq në Kajro në vitin 1914, gjithashtu ka mendime se vdiq në San Remo të Italisë, kushëri i Ismail Qemalit. Ishte trim, politikan dhe diplomat i rryer, mbi të gjitha ishte patriot, krenohet me kombin e vet si shqiptar. Kur filloi kryengritja e shqiptarëve në vilajetin e Kosovës, mes tjerash tha: "*Mirë po ja bëni djema*". Si një diplomat dhe largpamës që ishte, ai në vitin 1908 derisa ishte kryeministër i shtetit osman tha: "Shqipëria nuk qetësohet vetëm me forcën e armëve dhe me rreptësi. Për Shqipërinë duhen marrë masa të tjera. Këto janë përhapja e diturisë dhe arsimit. Shqiptarët janë besnikë. Unë them me mburrje të plotë se jam shqiptar dhe asnjëri nuk dyshon në besnikërinë time⁵⁶"

Vazhdojmë me disa personalitete tjera që lanë gjurmë në shtetin osman por edhe tek pasardhësit e tyre të Turqisë së sotme, prej tyre ishin:

Mehmet Akif Ersoj

Në vazhdën e famës së personaliteteve me origjinë shqiptare nga Peja në shtetin Osman, pa dyshim se është figura më e spikatur e kohës në të cilën jetoj, Mehmet Akifi, poet, deputet, luftëtar, mësimdhënës dhe mendimtar i madh, i cili lindi në Stamboll në vitin 1873 dhe vdiq po ashtu në Stamboll në vitin 1936.

Figura e Mehmetit paraqet një urë lidhëse mes dy popujve që në të kaluarën kishin ndarë një çati mes vete, të origjinës dhe asaj ku kishte lindur dhe rritur, ngase me krenari shprehte prejardhjen e tij dhe mburrej me të, kurse me zell dhe nder i shërbente vendit ku jetonte dhe vepronte. Figura e tij paraqet njeriun me ide kolosale dhe mendime përparimtare që edhe pas vdekjes së tij, veprat e tij madhështore përkujtohen nëpër simpoziume dhe evenimente të rëndësishme shtetërore. Një ministër turk i arsimit në një simpozium shkencor të mbajtur në Tiranë mbi figurën e këtij kolosi shqiptar ka theksuar: "Kujtimi i figurës së Mehmet Akif Ersoj-it dhe veprave të tij në shtëpinë e gjyshërve të tij është një nder për ne. Për këtë arsye unë falënderoj të gjitha organizatat që kanë dhënë kontributin për organizimin e një eventi të tillë... Veprat e tij vazhdojnë të na ndrisin edhe ditët e sotme. Është i rëndësishëm fakti që veprat e tij vazhdojnë të jenë një burim shprese për civilizimin tonë dhe gjithë rajonin⁵⁷"

Ajo çka e bënë më të spikatur dhe më me vlerë Mehmet Akifin është viti 1921, kur poezia e tij nga deputetët e parlamentit turk u zgjodh për himn kombëtar të shtetit turk.

Disa nga veprat e tij më të njohura janë:

Safahat (Fletët, 1911), Süleymaniye Kürsüsünde (Në fronin e Sulejmanijes, 1912), Hakkın Sesleri (Zërat e Perëndisë, 1913), Fatih Kürsüsünde (Në fronin e Fatihut, 1914), Hatıralar (Kujtime, 1917), Asım (Asim, 1924), Gölgeleler (Hijet, 1933).

⁵⁵ Loka, *po aty*, f. 37

⁵⁶ Loka, *po aty*, f. 90

⁵⁷ „Mehmet Akif Ersoy në vendlindje“, simpozium i organizuar nga Shoqata Alternativa e së Ardhmes „Alsar“ në bashkëpunim me Bashkësinë e Sindikatave Arsimore “Eğitim-Bir-Sen” 11-12 mars 2016, Tiranë.

Dashuria dhe vuajtjet e tij në këtë poezi:

"Tre million njerëz po vuajnë nga tri koka pa tru.

*Shqipëria po digjet... Kësaj here (djegiet) janë shumë të mëdha.
Babë, nëna jote më e dashur, mëmëdheu më i vërtetë,
A të bëhet viktimë e tre horllukëve hajdutë?!
Kudo që të ndodhem, para syve po më del një fushë e përgjakur... A je ti, apo
përfytyrimi yt? Kosovë e pa përkrahur!
Cili është shkaku me mijëra here i pushtimit tënd!
Cili është qëllimi i kalimit të rrugës shkatërruese
e "rrufesë" mbi varrin tënd?
O rrënjët e palidhura të pavarësisë, ku janë?
Të gjitha shpresat, mendoj përjetë u shuan.
Ku je "bashkim" i shkëlqyer, fantazi e lartë e krijuar?
Ty, madje me vite të hutoi ajo ëndërr e mallkuar.
Truallin mos e ke mbytur përnjëherë
Horizonti i mëngjesit të përgjakur?
Malazezi hajdut, Serbi gomar, Bullgari gjarpër,
Pastaj Greku qen, atdheun rreth e përqark e kanë rrethuar.
Shumica prej jush, u mor vesh, rrugën e gabuar s'po e shihni... Hajnin, që tani ju
shërben si këshilltarë, dëbojeni
Dëgjojeni këtë prej meje, që vërtete, jam shqiptar...
Gjë tjetër s'mund të them...Ja, atdheu im është rrënuar!
Ngrihu baba, ngrihu nga varri!
Dhe shih për qejfin e tre vetave kokëkrisur
se si vritet një popull tre milionësh!
Eja shpejt, sepse të gjallët nuk po vijnë të shpëtojnë atdheun tonë...
Shqipëria po digjet ne flakë...
Baba! Nëna jote më e dashur, që është atdheu yt, vendlindja jote po flijohet për
ambiciet e tre vetave kokëtrashë
Tokë e lëvruar nga gjyshërit tanë dhe arat e mbjella po i merr lumi...
Sa keq, që tashmë po ngulitet në tokë kryqi i të huajit...
dhe të vallëzojë ne te këmba e squat (ushtarit serb)... ?
Oh! Kudo më del përpara Kosova⁵⁸"*

Sami Frashëri

Vend të spikatur në qeverisjen osmane zë dhe patrioti, autori dhe eruditi Sami Frashëri.

⁵⁸Revistën "Paqja", nr. 10, 2007

Samiu lindi në Frashër të Përmetit në vitin 1850 dhe vdiq në Stamboll në vitin 1904. Ai ka dhënë përpjekjet maksimale për jetësimin e idesë së kombit shqiptar.

Autorësia e veprave të tij arrin mbi 60, kurse vlen të ceket se Samiu i dha një kontribut të jashtëzakonshëm gjuhës turke duke lënë një bagazh të madh kulturor. Ndër veprat e tij janë:

- "1) Kuçuk elifba (Abetarja e vogël)
- 2) Tasrifat-i arabiye (Konjugacioni i arabishtes)
- 3) Yeni Usul elifbayi turki (Abetarja turke sipas metodës së re)
- 4) Yeni Usul sarf-i turki (Morfologjia turke sipas metodës së re)
- 5) Kavaid-i sarfiye-i arabiyye (Rregullat e morfologjisë arabe)
- 6) Kavaid-i nahviye-i arabiye (Rregullat e sintaksës arabe).

Samiu i shkroi edhe disa vepra leksikografike, me të cilat vetes i ka bërë emër në leksikografinë turke, shqiptare e të tjera. Ai shkroi:

1) Kamus-i fransevi. (Fransizcadan Türkçeye lugat Dictionaire trançais-turc - (Fjalor Fregjinsht-Turqisht), më 1680 faqe, me afër 50 mijë fjalë.

2) Maus-i fransevi. Turkçeden Fraçaizeaya Lugat (Dictionaire turc.– français. (Fjalor Fregjinsht-Turqisht), në 1208 faqe

3) Kamus-i Turki (Fjalor i gjuhës turke, dmth. Turqisht-Turqisht). Ka 1575 faqe dhe është fjalori më i mirë i gjuhës osmane-turke. Deri sot ky fjalor nuk është tejkaluar ende, ndaj është bazë për të gjithë fjalorët e mëvonshëm.

4) Kamus-i arabi (Fjalor arabisht-turqisht), të cilin nuk e kreu.

5) Kamusu'l-a'lam (Fjalor i emrave të përveçëm) ose Enciklopedi historike e gjeografike.⁵⁹ Kjo vepër ka gjithsejt 6 vëllime dhe u botua në vitin 1889.

Fjalorin Turqisht "Kamusu Turki" u botua në Stamboll më 1901 dhe i njëjti më 1932 në një kongres gjuhëtarësh në Stamboll u mor për bazë për gjuhën e re letrare turke.⁶⁰

Me të drejtë albanologu turk Burak Kaba thotë: "Sami Frashëri është emri më i respektuar në Turqi dhe sot në librat e historisë dhe letërsisë turke mësohet për këtë personalitet si figurë që ka bërë hapat e parë në formimin e letërsisë turke.⁶¹"

Figura e Samiut paraqitet në pedestalin më të lartë kur është fjala për dhënien e kontributit për çështjen kombëtare, duke qenë udhëheqës i shumë organizimeve dhe shoqatave për këtë ideal, para së gjithash në fushën e shkronjave dhe alfabetit shqip.

"Sami Frashëri drejtoi revistat e para në gjuhën shqipe "Drita" dhe pastaj "Dituria" (Stamboll, 1884-85)

"Abetare e gjuhës shqipe" (1886),

"Shkronjtore e gjuhës shqipe" (Gramatika, 1886) dhe

"Dheshkronja" (Gjeografia, 1888) në gjuhën shqipe.

⁵⁹ <http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=1314>

⁶⁰ Bartl, po aty, f. 158)

⁶¹ Shekulli, 16 Gusht 2012

Ishte një ndër organizatorët kryesorë të "Komitetit Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare" dhe me themelimin e "Shoqërisë së të shtypurit me shkronja shqip" (1879) u zgjodh kryetar i saj.

Ndër veprat më të njohura që bëri bujë në letërsinë shqipe dhe ngjalli idenë, metodën e propagandës patriotike të popullit shqiptar ishte: "*Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet*", botuar më 1899 në Bukuresht.

Me të drejtë themi se vëllezërit Frashëri, Naimi, Abdyli dhe Samiu janë personalitete të pazëvendësueshme në kontributdhënie për çështjen kombëtare dhe njihen si pishtarët e Rilindjes Kombëtare.

Ismail Qemali

Njeriu bëri histori me personalitetin e vet, me aftësitë udhëheqëse dhe strategjike; nga dija dhe aftësitë e tij përfitoi dhe qeveria osmane. Emri i tij u ngulit thellë në historinë e popullit shqiptar si kontributdhënësi më i madh në drejtim të çështjes kombëtare, arkitekt i pavarësisë së Shqipërisë. Autor, deputet, përgjegjës për marrëdhëniet ndërkombëtare, burrshtetas në qeverinë osmane, së fundmi, kryeministër i parë i Shqipërisë së Pavarur.

Lindi në Vlorë më 1844 dhe vdiq në Itali në vitin 1919.

Në shtetin osman ishte figurë politike të cilës i ishin besuar përgjegjësi të rëndësishme, kuptohet ishte besnik ndaj qeverisë osmane në detyrat e tij siç e deklaroi edhe vetë⁶² pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, gjithnjë duke i ndihuar edhe kauzës shqiptare.

Ismail Qemali, që njihej me ide demokratike dhe liberale, ishte personalitet që një kohë bukur të gjatë e jetës së tij e kishte kaluar në administratën osmane. Sipas dokumenteve dhe studimeve të figurave kyçe në kontributin e tyre për çështjen kombëtare, del se ideja e Ismail Qemalit nuk ishte pavarësia e vendit, por autonomia nën shtetin Osman. Ai angazhohej që brenda shtetit osman, komuniteti shqiptar t'i gëzojë të drejtat dhe liritë që sipas tij i nevojiteshin që në të ardhmen të ishte në gjendje dhe të kërkonte shtetin e vet të pavarur.

Kërkesa e tij për autonomi nuk ishte rastësi, ngase mendja e tij prej politikani dhe diplomati të shkëlqyer e kishte kuptuar se pavarësia e shtetit shqiptar duhej të kalojë më së lehti përmes një autonomie kombëtare nën shtetin osman. Sipas tij, populli fillimisht duhej të konsolidohej në aspektin kombëtar dhe intelektual që pastaj të dilte me kërkesa serioze dhe ta kishte më të lehtë realizimin e idealeve të veta.

Figura e tij prej një liberali në shtetin osman kulmin kishte arritur me themelimin e partisë politike brenda shtetit osman, Partisë Liberale në vitin 1909, duke u zgjedhur edhe drejtues i saj.

Në cilësinë e kryetarit të Partisë Liberale në Parlamentin Osman, "në vitet 1910-1911 në rrafshin diplomatik, Ismail Kemal Vlora do të jetë figura kryesore diplomatike e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ai mendonte se shpëtimi i tokave shqiptare nuk varej vetëm nga

⁶²Bardhosh Gaçe, *Ata që shpallën Pavarësinë kombëtare*, Toena, Tiranë, 2012, f. 187

përpyjekjet e shqiptarëve dhe luftrat e tyre për liri, por edhe nga mundësia dhe aftësia për t'i shfrytëzuar kontradiktat dhe interesat gjeopolitike të fuqive të mëdha të Evropës si dhe rivalitetet e tyre.⁶³"

Kontributi i tij në administratën osmane ishte kryekëput liberal, qëllimi i tij ishte që të ekzistoj një perandori e fortë osmane, por me pikëpamje liberale ku shqiptarët do t' gëzonin të drejtat e tyre. Ai ishte kontribues i madh i hartimit të kushtetutës osmane dhe një përkrahës i fortë i Mit'hat Pashës, (kryeministër i zgjedhur në atë kohë).

"Ismail Qemali bashkëpunoi me Mit'hat Pashën në hartimin e Kushtetutës së parë osmane, shpallur më 1876 dhe neni 108 i saj shënonte se "*Administrata e krahinave do të kishte si themel parimin e decentralizimit*". Një nga idetë e Mit'hat Pashës e sugjeruar nga Ismail Qemali, ishte krijimi i një Vilajeti shqiptar⁶⁴"

Kjo ishte ide e patriotëve shqiptarë për t'i bashkuar të gjithë vilajetet në një, duke ndikuar kështu në unitetin e shqiptarëve në të gjitha aspektet.

Për një bashkim vilajetesh do të shprehet edhe Pashko Vasa⁶⁵, një katolik i cili në qeverisjen osmane në vitin 1882 ishte Guvernator i Perandorisë Osmane në Bejrut: "Është në interesin tonë të përbashkë që e gjithë Shqipëria të bashkohet në një vilajet të vetëm, t'i jepet asaj një administrim i thjeshtë, kompakt dhe i fortë, të integrohen në administrimin e saj elementet e vendit, dhe kështu, të themelojmë nën skeptrin e Sulltanit, një epokë të re të bashkimit, të mirëkuptimit, dhe të vëllazërimit për të gjitha fetë⁶⁶"

Nga kjo kuptojmë se shumica prej rilindësve tanë i kanë shërbyer shtetin osman, secili në formë të ndryshme, por gjithmonë pa harruar kulturën, kombin dhe vendlindjen e tyre.

Veprimet politike të Ismail Qemalit së fundmi ishin së bashku me xhonturqit, që synonin ta reformonin shtetin osman në frymën liberale dhe nacionale, por shpejt prej tyre u gjet i zhgënjyer dhe u largua nga ta duke iu përkushtuar tërësisht çështjes kombëtare deri në pavarësinë e Shqipërisë.

Është interesant të përmendet një detaj nga biografia e tij që si duket ishte përdhosur në kohën e komunizmit.

"Periudha e komunizmit dhe historianët e saj në Shqipëri falsifikuan personalitetin e Ismail Qemal Vlorës (datën e lindjes, emrin dhe mbiemrin). Emri i vërtetë i atij që ata e quajtën Ismail Qemali ishte Ismail Kemal Bej Vlora. Këtë shtrembërim e bënë në emër të luftës së klasave sepse "bejlerët" dhe "agallarët" ishin klasa armike për komunizmin.

Prandaj edhe si Ismail bej Vlora nuk kishte vend në literaturën e komunizmit sepse

⁶³Eqrem Zenelaj, *Diplomacia e Ismail Kemal Bej Vlorës, rivalitetet e brendshme në Shqipëri dhe rruga e Pavarësisë 1912-1923*, f. 272

⁶⁴<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=4352>

⁶⁵Nuk qëndron teza se katolikët ishin të përçmuar dhe maltretuar në Perandorinë Osmane nga pushteti osman. Katolikët ishin mirë të integruar në këtë shtet, gëzonin të drejta dhe privilegje si dhe jetonin në mirëqenie si të gjithë qytetarët tjerë në perandori. Ka shumë personalitete katolike që kishin pozita të larta shtetërore në shtetin osman. Kishat nuk paguanin tatim, te vjetrat riparoheshin, ndërtoheshin të reja aty ku ishte nevoja.

⁶⁶Pashko Vasa, *E Vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët*, f. 36

nuk bënte të përmendej as "Bej" as "Vlora"⁶⁷

Ngjajshëm siç potencon Eqrem Zenelaj u ndryshua dhe datë lindja e tij e cila në fakt ishte siç gjendej në dokumenten osmane dhe austro-hungsteze 16 tetor 1842, mirëpo kjo datë e tij fshihet nga historia për t'i dhënë hapësirë ditëlindjes së Enver Hoxhës 16 tetor 1916, dhe kjo me qëllim që mos të vërsulen pas festimit të ditëlindjes së Ismail Qemalit e ta linin në harresë Enver Hoxhën, prandaj dhe ditëlindja e Ismail Qemali është ndryshuar nga 16 tetori duke u bërë në 16 janar.

Një shpresë për përmirësimin e këtyre gabimeve dhe shumë të tjerave si kjo, do të realizohen me rrënimin e sistemit komunist dhe me intervenimin e stërnipit të tij Darlingut, dhe tash ky gabim gjendet i përmisuar në Akademinë e Shlencave të Shqipërisë .

Shumë figura historike janë anashkaluar nga regjimi, me apo pa qëllim, megjithatë duhet të dimë se historia qëndron vetëm nëse shkruhet me fakte dhe nëse ngjarjet janë të argumentuara, në të kundërtën u japim hapësirë armiqve tanë që të manipulojnë me historinë dhe figurat tona historike.

Isa Boletini

U lind në vitin 1864 në Boletin të Mitrovices dhe u vra nga forcat serbo-malazeze në vitin 1919.

Njihej si luftëtar trim, strateg i shkëlqyer ushtarak, para së gjithash një patriot i sypatrembur.

Një pjesë të jetës së tij e kaloi në Stamboll, por ajo që është më e rëndësishmja të ceket se "në vitin 1902, Sulltan Abdylhamidi II e kishte emëruar Isën komandant të gardës së tij personale, e cila ishte njësi më speciale që kishte Perandoria. Natyrisht, sipas traditës, gardistët gjithmonë ishin shqiptarë të rekrutuar me kujdes. Isa Boletini i kaloi katër vite në këtë detyrë për të cilën gjë Sulltani ia dha titullin bej."⁶⁸

Kur në Selanik e burgosën Abdylhamidin dhe tashmë qeveria osmane kishte filluar reformat rrënjësore të filluara nga xhonturqit, Isa Boletini u rreshtua në krahun e xhonturqve si shumë rilindës të tjerë, por shpejt e kuptoj dredhinë e tyre dhe filloi kryengritjen kundër xhonturqve.

Në anën tjetër, Isa Boletini kishte marrë rrugën bashkë me Riza Kryeziun për Selanik me qëllim që ta shpëtojë nga burgu Sulltan Abdylhamidin siç e potencon edhe historiani dhe diplomati Abdi Baleta⁶⁹ thuhet se Isa Boletini ia kishte dhënë fjalën Sulltanit me t'u kthyer në Kosovë nuk do të luftonte kundër tij.

Fundi i jetës së Isa Boletinit ishte lufta dhe angazhimi i tij i madh për çështjen shqiptare së bashku me Ismail Qemalin.

Turhan Pashë Permeti

Ishte një figurë e lartë në Perandorinë Osmane që dhjetë vitet e fundit ka qenë ambasador i shtetit osmanë në Shën Petersburg.

Ishte njohës shumë i mirë i marrëdhënieve ndërkombëtare, i cili pas moshës 70 vjeçare

⁶⁷ Zenelaj, po aty, f. 434

⁶⁸ <http://telegrafi.com/isa-boletini-mohikani-i-fundit/>

⁶⁹ <https://www.youtube.com/watch?v=zdojbe4JUtE>

kthehet në Shqipëri dhe emërohet kryeministër i dytë i shtetit shqiptar pas Ismail Qemalit. Vlen të theksohet se edhe pse kuptonte gjuhën shqipe ai nuk dinte të fliste dot shqip ngase si i vogël në moshë kishte ikur nga Shqipëria.

Shqiptarët i flisnin shqip kurse ky u përgjigjej në gjuhën turke. Me princin (Vidin) fliste gjermanisht ndërsa me të huajt e tjerë fliste frëngjisht. Ishte zotni i lartë osman.

Ishte guvernatorë në Kretë, ambasador në Paris dhe tre herë kryeministër i Shqipërisë, deri në vitin 1920.

Abdyl Frashëri,

10 vjet deputet në Parlamentin e parë perandorak, 1877-1878,

Vaso Pash Shkodrani

Vali i përgjithshmen i Libanit

Hasan Tahsini

Rektori i parë i Universitetit të Stambollit për të cilin kemi folur gjerësisht në një kapitull të veçantë.

Raif Pasha

"Sipas raportit vjetor të *Foreign Office* për vitin 1909, shqiptari Raif Pasha ishte drejtor i përgjithshëm i doganave në Perandorinë Osmane⁷⁰". Ministër i Tregtisë, Ministër i Bujqësisë, Ministër i Shërbimeve Publike të asaj kohe.

2.3. Roli i elitës politike shqiptare në formimin e idesë për pavarësi

Me zbehjen e fuqisë osmane diplomacia shqiptare ishte e vetëdijshme se trojeve shqiptare iu kanosej rrezik nga fqinjët me tendencë sekuestrimi.

Fuqitë osmane tashmë iu kishin nënshtruar marrëveshjeve ndërkombëtare dhe afër 80 % të vendeve të Ballkanit i rrezikoheshin perandorisë. E kapur ngushtë dhe e pafuqishme në mbrojtje të hapësirës së vet perandoria osmane nënshkruan traktatin e Shën Stefanit në vitin 1878 i cili dhimbshëm copëtonte trojet shqiptare në mes katër shteteve fqinje. Bullgaria do të merrte, përveç të tjerave, krahinat shqiptare të Korçës, të Bilishtit, të Pogradecit, të Strugës, të Dibrës, të Kërçovës, të Gostivarit, të Tetovës, të Shkupit, të Kaçanikut. Serbia do të shtrihej kryesisht drejt jug-perëndimit, do të aneksonte edhe viset veriore e verilindore të Kosovës, deri në afërsi të Mitrovicës. Mali i Zi, sipërfaqja e të cilit do të rritej më tepër se tri herë, do të përfshinte brenda kufijve të vet gjithashtu një varg krahinash shqiptare, si atë të Ulqinit, të Krajës, të Anamalit, të Hotit, të Grudës, të Tuzit, të Kelmendit, të Plavës, të Gucisë dhe të Rugovës. Pjesa tjetër e Shqipërisë do të mbetej nën sundimin e Perandorisë Osmane.

Detyra e politikës shqiptare tashmë ishte e hapur në dy fronte: në mbrojtje të trojeve të veta dhe në ngritjen e vetëdijes kombëtare. Pa këtë të fundit nuk mund të këndellej populli në mbrojtjen e trojeve të veta, ngase tashmë ishte e qartë se shqiptarët gjendeshin para një rreziku real, pa ndihmën e asnjë fuqie evropiane e cila do t'iu bëheshte krah.

⁷⁰ Berisha, po aty, f. 36

Shqiptarët e kishin të qartëse me këndelljen e Ruisë, kur tashmë kishte arritur që ta mposhtë shtetin osman dhe ta detyronte ta ulëj në bankën e të akuzuarve duke i vënë kushte veprimi dhe lëvizjeje, do të pasonte ideja e e shteteve pansllaviste në Ballkan: forcimi dhe zgjerimi i shteteve sllave në kurriz të shqiptarëve, zhdukja e dherave shqiptare nga harta ose së paku tkurrja e trojeve të tyre. Në sajë të idesë megalomane të Ruisë, në vitin 1912u krijua edhe Aleanca Ballkanike ndërmjet monarkive fqinje, kryesisht sllavëve të Ballkanit, të cilëve mbrapa u rrinte politikisht dhe ushtarakisht Rusia. Prandaj themi se shtetet fqinjë të krijuara së voni synonin në i rritjen dhe forcimin e tyre në kurriz të trojeve shqiptare.

Tashmë duke e ditur rrezikun e madh që u kanosej elita politike dhe diplomatike shqiptare , para vetes kishte dy opsione dhe mundësi veprimi për të ardhmen si komb, por të dyja tejet të rrezikshme për gjendjen momentale politike dhe ushtarake të shqiptarëve.

E para, të mbeteshin ende nën shtetin osman me qëllim që ta kishin një fuqi si mbështetje nga pretendimet ogurzeza të fqinjëve, dhe e dyta, të angazhoheshin me të gjitha forcat dhe t'i fusnin në përdorim të gjitha mundësitë e vjeljes së përfitimeve politike, diplomatike dhe ushtarake, me qëllim të dilnin në një status të kombit dhe shtetit të pavarur. E para nuk ishte e pamundur kur kihet parasysh që shteti osman tashmë kishte marrë tatëpjeten dhe nuk ishte në gjendje të ruante kufijtë e vet dhe brenda trojeve shqiptare, dita-ditës dobësohej nga fuqitë e mëdha evropiane dhe Rusia.

E dyta, më shumë e rrezikshme dhe me mundësi më të mëdha të jetësimit. Mundësia e fundit ishte që të angazhoheshin me të gjitha forcat që posedonin për një shtet të tyre të pavarur që do të njihej ndërkombëtarisht nga fuqitë e mëdha dhe të uleshin apetitet e shteteve fqinje në drejtim të shqiptarëve, gjë që nuk do të kalohej shumë lehtë, por ishte mundësia e vetme e veprimit të shqiptarëve.

M arrëveshja në Shën Stefanit dha tri sinjale;

E para, njoftimi i Persndorisë Osmane se epoka e saj tashmë kishte përfunduar, nuk ishte më ajo forcë që tmerronte kë kishte përballë.

E dyta, njoftimi tek fuqitë evropiane se shtetit osman i ka ardhur koha të deportohet apo të largohet nga Rumelia dhe Ballkani, dhe

E treta, për shqiptarët një alarm tejet i hidhur, duke ua bërë me dije se trojeve shqiptare shpejt do t'u kanoset rreziku i copëtimit dhe shkatërrimit të idesë së shtetit të tyre apo edhe më rëndë, rreziku i qenësisë së tyre si shqiptarë.

Mendimi politik shqiptar në periudhën e para shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë

Shikuar në aspektin e përgjithshëm të ngjarjeve të viteve 1908-1912 vijmë në përfundimin se spektri politik shqiptar tashmë kishte konstatuar se kishte ardhur koha e vendosjes për fatin e tyre. E tëra kjo si rezultat i dobësisë së Perandorisë Osmane, në anën tjetër reformat e bëra nga xhonturqit dhe qeverisja arbitrare e revolucionisteve të rinj.

Një vështirësi tjetër vazhdimisht ka përcjellur spektrin diplomatik shqiptarë të ndarë në dy tabore; një tabor përfaqësonte mendimin se duhej shqiptarët të rrinin ende besnik pushtetit osman përkundër rrezikut të dobësimit të tij, ngase ishte shpresa që tokat osmane (brenda së cilës ishin ato shqiptare) të dhëna në traktatin Shën Stefanit të ktheheshin ndonjëherë, dhe tabori tjetër i mendimit shqiptar për kryengritjen gjithpopullore e kombëtare pa dallim feje për t'u ndarë njëherë e përgjithmonë nga qeveria osmane tashmë jo e zonja për t'i ruajtur kufijtë e vet, qoftë edhe me forcë siç edhe ndodhi, me qëllim të mbrojtjes tashmë të

trojeve shqiptare.

Elita politike dhe revolucionare shqiptare kishte parë se në këtë kohë tollovish e turbulencash politike të vetmit që mund t'iu dilnin zot trojeve shqiptare nga copëtimi ishin vetë shqiptarët të cilët ishin të lidhur me omanlinjtë shpirtërisht. Dhe zgjedhja e ndarjes nga qeveria osmane pas shumë shekujsh bashkëjetesë shihej si ide më e mençur, kur kihet parasysh se qeveria osmane me dobësimin e saj zihej ngushtë nga forcat evropiane, kushtëzohej me pazarllëqe me territoret e saja. U konstatua se të vetmit që do ta mbronin në këto momente ndarjen e trojeve shqiptare ishin vet shqiptarët.

Përkundër ofertave joshëse nga qeveria xhonturke dhe pas shumë betejave luftarake, populli shqiptar vendosi për pavarësinë e Shqipërisë, të cilën e realizoi me shpalljen e pavarësisë më 1912.

Shtypi shqiptar si promotor i vetëdijes kombëtare

Diplomacia shqiptare kishte vënë në lëvizje forcat e veta drejt fuqizimit dhe unifikimit të mendimit kombëtar për të realizuar aspiratat për formimin e një shteti të pavarur shqiptar dhe njohjen e tij nga fuqitë e mëdha, ngase kjo ishte e vetmja mënyrë e cila do t'i shpëtonte shpërbërjes së trojeve shqiptare.

Mu për këtë filluan hapjet e shoqatave shqiptare dhe botimet e shtypshqip të cilat kryesisht realizoheshin jashtë.

Kështu, në vitin 1878 themelohet shoqata e parë në Stamboll e cila do të njihet si shoqëria e Stambollit e themeluar nga një grup intelektualësh shqiptarë.

Detyra e saj ishte që përmes afrimit të forcave intelektuale shqiptare të fillojë përgatitjet për hartimin e një alfabeti shqip, dhe për këtë komisioni prej 25 vetash e ngarkoi një grup të ngushtë me 7 anëtarë (Sami Frashëri, Jani Vreto, Pashko Vasa, Hoxha Tahsini, Koto Hoxhi, Ibrahim Bërzeshta, Said Toptani).

Po të njëjtin vit më 12 tetor 1879 një konferencë u nënshkrua statuti i "Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip" ose Shoqërisë e Stambollit, . Kryetar i saj u zgjodh Sami Frashëri. Kjo shoqëri më vonë do të luante rol vendimtar për hartimin e alfabetit shqip.

"Në vitet 80-të qenë hapur të parat shkolla publike me gjuhën e mësimi të vetëm shqipen; më 1881 në fshatin Qestorat (rrethi i Gjirokastrës) nën drejtimin e Koto Hoxhit dhe më 1885 në Vakëf nën drejtimin e Petro Luarasit.

Më 1886 Naim Frashëri ia arriti të nxirrte me shumë mundime lejen nga qeveria osmane për hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë, më 1891 qe ngritur gjithashtu në Korçë një shkollë për vajza nën drejtimin e Gjerashim Qiriazit⁷¹"

Me ardhjen e xhonturqve liria e shtypit ishte më e madhe, ngase programi i tyre i jepte hapësirë më të madhe zhvillimit nacionalist popujve, në anën tjetër intelektualët shqiptarë u rreshtuan krah revolucionit xhonturk me qëllim përfitimit të mundësive nga qeveria e tyre reformiste.

E gjithë kjo përpjekje intelektuale u kurorëzua së fundmi me hartimin e alfabetit në gjuhën shqipe.

KAPITULLI I TRETË

⁷¹Bartl, po aty, f. 180

3. Lëkundjet e Perandorisë dhe aspiratat nacionaliste: Shembulli i Kongresit të Manastirit

3.1. Rruga deri tek mbajtja e Kongresit të Manastirit

Gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra të Gadishullit Ballkanik, ashtu si dy gjuhë të tjera indoevropiane, rumanishtja dhe lituanishtja, por e njëjta ka filluar të shkruhet relativisht vonë. Libri i parë shqip që njohim deri më sot është “Meshari” i Gjon Buzikut i vitit 1555.

Meshari nuk duhet të merret si fillim i shkrimit shqip sepse fakte të ndryshme dëshmojnë se shqipja është shkruar kohe para Buzikut. Këtu nuk është fjala vetëm për dokumentet e njohura si “Formula e Pagëzimit” e vitit 1462 e Pal Engjëllit, “Fjalorthi” i Arnold fon Harfit, por për një traditë shkrimi të shqipes. Për ekzistencën e një tradite janë shprehur edhe disa dijetarë shqiptarë e të huaj si albanologu austriak Norbert Jokli, arbëreshi Gaetano Petrotta, Eqrem Çabej etj.

Në krahasim me disa gjuhë të tjera indoevropiane gjuha shqipe ka filluar të shkruhet relativisht vonë dhe arsyet duhet kërkuar në rrethanat historike dhe politike nëpër të cilat kanë kaluar shqiptarët si popull.

Ajo që vlen të theksohet është e vërteta se gjatë shekujve gjuha shqipe është shkruar me alfabetë të ndryshme, nga ai grek, latin, arab, varësisht prej periudhës historike dhe varësisht prej autorëve të ndryshëm. Shkaku i kësaj “rrëmuje” ishte mospasja e një alfabeti të vetëm që i përgjigjej gjuhës, fonetikës së shqipes.

Sido që të jetë lirshëm mund të thuhet se shumica e shkrimeve që bëheshin nga autorë të ndryshëm në të shumtën e rasteve ishin të karakterit fetar.

Veprat e para në gjuhën shqipe që njohim sot janë shkrime kryesisht me frymë fetare e didaskalike. Të tilla janë veprat e Buzikut, Bardhit, Bogdanit etj⁷².

Këto vepra dolën në kohën kur kisha katolike duke parë rrezikun e përhapjes së fesë islame dhe ideve të reformacionit, filloi të lejonte botimin e disa veprave në gjuhë të ndryshme amtare. Dhe në këtë rast “përfituan” edhe shqiptarët, pra, përkthimin e dogmave katolike në gjuhën e tyre.

Autorët e veprave në fjalë kanë përdorur alfabet latin dhe të plotësuar me disa shkronja cirilike. Ky alfabet u bë tradicional në shkrimet fetare katolike dhe vazhdoi të përdoret në Shkodër deri në vitin 1909.

Gjatë shekullit XVI-XVII gjuha shqipe kryesisht e shkrua prej autorësh të Shqipërisë së veriut, por gjendja ndryshoi në shekullin XVIII kur shkrimi i shqipes u përhap edhe në Shqipërinë e mesme e jugore, sidomos në Elbasan, Voskopojë, Berat etj.

Autorë të ndryshëm shqiptarë që kanë jetuar gjatë shekullit XVIII na kanë lënë vepra të shkruara me alfabetë të ndryshme. Kjo gjë ishte e pashmangshme dhe e kuptueshme për

⁷²https://sq.wikipedia.org/wiki/Let%C3%ABrsia_e_vjet%C3%ABr_shqiptare

kohën në të cilën gjendej kombi shqiptar, nën sundimin e huaj dhe pa një alfabet të vetëm të unifikuar.

Si dëshmi për atë që thamë më lart do të përmendim tre botime të asaj kohe të shkruara në tre alfabete të ndryshme. Gjon Nikollë Kazazi më 1743 botoi në Romë një libër me shkronja latine. Në fillim të shekullit XVIII një autor anonim (me gjasë nga Elbasani) botoi në gjuhën shqipe disa tekste fetare me një alfabet të veçantë prej mëse 40 shkronjash. Theodor Kavalijoti dhe Danil Haxhiu botuan një libër me karakter shkollor, ku pjesët në gjuhën shqipe i shkruajtën me alfabet grek.

Lëvrimi i gjuhës shqipe mori një hov të madh në epokën e Rilindjes Kombëtare gjatë shekullit XIX e sidomos gjatë gjysmës së dytë të këtij shekulli. Pikërisht kësaj epoke i takoi të zgjidhte këtë detyrë të madhe sa historike aq edhe të ngutshme sikurse ishte çështja e njësimi të alfabetit të gjuhës shqipe⁷³.

Epoka e Rilindjes Kombëtare Shqiptare zë një periudhë të tërë historike, shtrihet nga vitet 30-40 të shekullit XIX e deri te Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë më 1912. Rilindja shënoi jo vetëm lëvizjen më të fuqishme dhe më të organizuar politike që shqiptarët kishin njohur deri atëherë, por edhe një zhvillim të gjithanshëm të mendimit politik dhe kulturor kombëtar, të gjuhës dhe letërsisë shqipe.⁷⁴

Rilindja solli përparime të mëdha në kulturën e shqiptarëve, në radhë të parë në lëvrimin e gjuhës shqipe, e cila ishte tipari themelor i kombit shqiptar, nyja qendrore që bashkonte gjithë shqiptarët pa dallim krahine e feje.

Rilindja gjithashtu karakterizohet nga përpjekja për kapërcimin e prapambetjes në shkrimin e shqipes, që u shprehen në marrjen e masave dhe përpjekjeve për vendosjen e një alfabeti të njëjtë dhe në zhvillimin e një letërsie të gjerë artistike, didaktike e publicistike.

Gjatë Rilindjes u hodhën themelet e gjuhës letrare shqipe, të letërsisë dhe të kulturës së sotme shqiptare në tërësi.

Shkrimi dhe lëvrimi i gjuhës shqipe, përpunimi i një alfabeti të njëjtë dhe i një letërsie kombëtare të unifikuar ishte veprim sa i domosdoshëm aq edhe i vështirë. Në të tilla kushte dolën nga gjiri i popullit shqiptar një varg atdhetarësh dhe intelektualësh të shtytur nga dashuria për atëdhenë që iu përveshën punës për lëvrimin e gjuhës shqipe, si Naum Veqilharxhi, Konstandin Kristoforidhi, Naim e Sami Frashëri, Jani Vreto, Vaso Pasha etj.

Gjuha shqipe, përplilimi i një alfabeti të unifikuar, lëvrimi i saj në literature të shkruar dhe përhapja e saj në literature të shkrimit shqip me anë të shkollave amtare, nuk trajtoheshin nga rilindësit vetëm si çështje kulturore por edhe në rrafshin politik, si një përbërës që do t'i shërbente forcimit të unitetit kombëtar⁷⁵.

Pa një alfabet të unifikuar nuk mund të kishte unifikim të mirëfilltë kombëtar, dhe kjo ishte platformë politike e rilindësve, dhe fatmirësisht shpallja e pavarësisë së shtetit shqiptar shqiptarët i gjeti më të përbashkuar pasi më parë kishin unifikuar dhe përdornin një alfabet të vetëm, të miratuar në Kongresin e Manastirit më 14 nëntor - 22 nëntor 1908⁷⁶.

Po ta bëjmë një vështrim kronologjik të historisë shqiptare të Rilindjes, do të konstatojmë se unifikimi i alfabetit para shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptarë, nuk është

⁷³<http://www.slideshare.net/olsi1998/platforma-politiko-kulturore-e-rilindjes>

⁷⁴<http://koha.net/?id=4&l=93262>, 13 Janar 2016

⁷⁵<http://www.slideshare.net/olsi1998/platforma-politiko-kulturore-e-rilindjes>

⁷⁶Demira & Prifti, po aty, f. 43

rastësi historike por një veprim epokal i mirëorganizuar.

3.2. Alfabeti i Stambollit

Një nga çështjet kryesore që tërhoqi vëmendjen e rilindësve ishte vendosja e një alfabeti të vetëm të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Kjo ishte një kërkesë e ngutshme sepse mungesa e një alfabeti të vetëm për shkrimin e shqipes përbënte një pengesë të madhe për përhapjen e diturisë e të arsimimit dhe si rrjedhojë, ishte pengesë për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar dhe për bashkimin e tij. Ky shqetësim i rilindësve kuptohet lehtë nga fakti se para vitit 1879, gjendja ishte shume e vështirë, përdorehin alfabetë të ndryshme për shkrimin e veprave në gjuhën shqipe.

Në Shqipërinë e veriut vazhdonte të përdorej alfabeti tradicional i shkrimtarëve të periudhës së bejtexhinjëve, me këtë alfabet gjatë shekullit XIX u botuan kryesisht vepra fetare të dogmës katolike.

Bejtexhinjtë në shkrimet e tyre me përmbajtje kryesisht fetare përdornin alfabetin arab.

Në disa vepra si *Bibla* e Korfuzit, *Bleta Shqiptare* e Thimo Mitkos u përdor alfabeti grek.

Këtu nuk mund të lihen pa përmendur edhe alfabetet origjinale që patën një përhapje të gjerë gjatë shekullit XIX. Përveç alfabetit të Todorit që vazhdoi të përdorej në Elbasan, Berat e gjetkë, kryesisht në marrëdhënie tregtare e letërkëmbime, pati edhe njëfarë përhapje edhe të alfabetit origjinal të Naum Veqilharxhit prej 33 shkronjash. Këtu duhet të përmenden edhe alfabetet origjinale të Hoxhë Tahsinit dhe Vasil Dhimitri Rusosë⁷⁷.

Se sa ishte gjendja e komplikuar me shkrimin e shqipes para vitit 1879 mjafton të përmendet e vërteta se një njeri që dëshironte të lexonte veprat e Kristoforidhit në dialektin toskë e gegë, duhej paraprakisht të njihnte edhe alfabetin latin edhe atë grek së bashku me shkronjat konvencionale që ishin sajuar për të paraqitur ata tinguj të shqipes që i mungonin greqishtes edhe latinishtes. E për të lexuar edhe vepra të tjera të shkruara me alfabetë të ndryshme, shqiptari i asaj kohe duhej të mësonte një numër jo të vogël alfabetesh.

Para një gjendjeje të tillë intelektualët shqiptarë që ndodheshin në Stamboll, u përpoqën t'i gjenin një zgjidhje këtij problemi. Këto përpjekje filluan që në vitin 1864⁷⁸ por pengesat e qeverisë osmane dhe të Patriarkanës së Stambollit që udhëhiqej nga grekët bënë që zgjidhja e këtij problem të zvarritej.

Por ishte Lidhja e Prizrenit ajo që i dha një shtysë të madhe lëvrimit dhe zhvillimit të gjuhës shqipe, dhe nuk është rastësi se dhjetë muaj pas mbajtjes së mbledhjes së Lidhjes së Prizrenit, patriotët shqiptarë në Stamboll, arritën t'i kapërcejnë dallimet midis tyre, dhe të vendosnin në fund për një alfabet të përbashkët për shkrimin e gjuhës shqipe. Dhe nuk është rastësi që ata në Stamboll në tetor të vitit 1879 nënshkruan “Kanonizmen” e Shoqërisë e të shtypurit me shkronja shqipe.

⁷⁷ Demiraj & Prifti, po aty, f. 20

⁷⁸ Historia e Letërsisë Shqipe II, f. 17

Vendimi i patriotëve shqiptarë për të krijuar një alfabet të përbashkët i cili ka kaluar në histori me emrin “Alfabeti i Stambollit” ishte një vendim me rëndësi të madhe në jetën kulturore dhe politike të shqiptarëve, por arritja e marrëveshjes për këtë alfabet nuk ishte një punë e lehtë. Sipas dëshmive të Jan Vretos ajo u bë e mundur pas diskutimesh të gjata nëpërmjet të cilave u shuan shumë divergjenca . Gjatë diskutimeve disa nga muslimanët shqiptarë të Stambollit kishin shprehur mendimin që shqipja të shkruhej me alfabetin arab, kundër këtij mendimi ishin Ismail Qemali, Pashko Vasa, Konstatin Kristoforidhi dhe Hasan Tahsini⁷⁹.


Edhe mendimi i Hasan Tahsinit për krijimin e një alfabeti origjinal nuk gjeti mbështetje. Jani Vreto ishte për krijimin e një alfabeti të mbështetur në alfabetin grek e latin të plotësuar me disa shkronja të tjera, kurse Pashko Vasa dhe Sami Frashëri, ishin për një alfabet të mbështetur në alfabetin latin.

Alfabeti i Stambollit me 36 shkronjat e tij u përgjigjej plotësisht kërkesave fonologjike të shkrimit të shqipes. Siç dihet alfabeti i Stambollit u ndërtua mbi parimin e alfabetit latin një shkronjë për një tingull, duke përjashtuar sistemin dyshkronjësh për disa shkronja që ekzistojnë sot, si dh, sh e zh etje. Shkronjat në fjalë u zëvendësuan me shkronja greke.

Alfabeti i Stambollit me kohë filloi të konsiderohej si një alfabet kombëtar i shqiptarëve.

⁷⁹ Demiraj& Prifti, po aty, f. 23

Alfabeti i Stambollit, hartuar nga Sami Frashëri në vitin 1909 në Stamboll



3.3. Kontributi i klerit mysliman në hartimin e alfabetit shqip

Një kontribut të pashoq në zhvillimin e gjuhës shqipe, kulturës dhe arsimit kombëtar kanë dhënë dhe klerikët fetarë, gjegjësisht ata muslimanë, gjithmonë duke mos harruar edhe kontributin e klerikëve krishterë.

“Pavarësisht faktit se deri vonë, për arsye ideologjike ka pasur një lloj tendence për t’i vënë në plan të kundërt komponentët “shkollë”, “gjuhë” dhe “identitet kombëtar” me fjalën “kler”, “klerikë” apo në rastin konkret “hoxhallarë”, e vërteta qëndron ndryshe⁸⁰”.

Një numër alfabetesh dhe abetaresh të gjuhës shqipe na rezulton të jenë hartuar pikërisht nga këta personalitete.

Megjithëse ato nuk përbëjnë një numër të madh për nga sasia, përsëri në raport me peshën specifike dhe kohën kur u hartuan dëshmojnë për shkallën e lartë të preokupimit dhe rëndësinë që klerikët myslimanë shqiptar i jepnin zhvillimit dhe mësimi të gjuhës shqipe.

Hoxhë Hasan Tahsini (1811-1881)

Në shfletimin e historisë së popullit shqiptar gjejmë emra të shumtë dhe të spikatur të klerikëve fetarë, por në fakt ne kemi marrë për studimin tonë, trajtimin dhe kontributin e klerit mysliman, që kanë dhënë në zhvillimin e identitetit kombëtar, veçanërisht kontributit të tyre të pashoq dhënë në hartimin e shkronjave shqipe, siç e kemi filluar me emrin më eminent të asaj kohe Hoxhë Hasan Tahsinin.

Në vitin 1857, kur qeveria osmane po përgatitej për hapjen e universitetit të parë, një nga të dy të zgjedhurit e saj për t’u dërguar në Paris, me qëllim për t’u pajisur me dituritë e nevojshme shkencore, ishte Hoxhë Hasan Tahsini. Pas vajtjes atje, brenda një viti ai arriti të fitonte tërë dituritë e nevojshme dhe u regjistrua në fakultetin e shkencave të natyrës. Madje, duke vazhduar studimet në të, ndoqi si i jashtëm studimet edhe në fakultete të tjera. “Bashkëkohës të tij, në veprat e tyre, theksojnë se ai përsosi frëngjishten dhe u thellua në fizikë, matematikë, kimi, biologji, filozofi, fiziologji, botanikë, gjeologji, shkencat shoqërore, e sidomos në filozofi, kozmologji e psikologji⁸¹”.

Pas kthimit në Stamboll në vitin 1869, ai u emërua si rektor i parë i Universitetit të Stambollit (Darülfünun-u Osmanî), ku megjithëse qëndroi për një kohë të shkurtër, u afirmua si një nga personalitetet shkencore më të njohura të Perandorisë Osmane.

Me gjithë faktin se Hasan Tahsini, njihej nga bashkëkohësit e tij si musliman që donte fenë e tij, kishte dhe zëra mospajtimi mes rilindësve dhe kjo më mirë vjen në shprehje gjatë debateve dhe shkrimeve që paraqiteshin nëpër gazeta apo takime të veçanta, se si në fakt do të formulohej alfabeti i ardhshëm kombëtar, prandaj mendohej se Hasan Tahsini anonte që alfabeti arab të merrej si shembull por edhe të përdorej, gjë që kjo nuk ishte e vërtetë ngase

⁸⁰Historia e Shqipërisë, vëll. II, Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1984, f. 429-436.

⁸¹ Hasan Kaleshi, *Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame*, Riyadh: International Islamic Publishing House, 1992, f.73

një gjë të tillë e demanton bashkëkohaniku i tij Jani Vreto : “Çështja për të cilën diskutojmë ka të bëjë me interesin shpirtëror të të gjithë kombit tonë, domethënë me çështjen se si të shkruhet më lehtë gjuha jonë dhe të përparojë dituria e të çlirohet kombi ynë nga turpi i gjendjes barbare dhe nga të këqijat që rrjedhin prej saj... Gjuha jonë nuk mund të shkruhet me anë të alfabetit arab. Prova e madhe bindëse është fakti se ata, midis shqiptarëve që kanë mësuar gjuhën arabe, kur u shkruajnë fëmijëve të tyre, përdorin greqishten e re, të cilën nuk e dinë mirë, e që e kanë mësuar, vetëm duke u shoqëruar me grekë... Ngandonjëherë kur nuk e dinë greqishten, shkruajnë në gjuhën shqipe, por me shkronjat e alfabetit grek, të cilat i mësojnë me rast nga ata që e dinë greqishten... ndonëse shkronjat e greqishtes nuk mjaftojnë për të paraqitur të gjithë tingujt e gjuhës sonë”. “Ne - shkruante Hasan Tahsini - jemi një komb i veçantë, kemi gjuhën tonë të veçantë, andaj duhet të mendojmë më vete, si edhe të tjerët⁸²”.

Përpjekjet e Hoxhë Tahsinit ishin të vazhdueshme për hartimin e një alfabeti unik me të cilin do të shkruhej gjuha shqipe, dhe ky me kujdes planifikonte një projekt të këtillë që do të ishte i pranueshëm në popullatë dhe i lehtë për të punuar me të.

“Hoxhë Hasan Tahsini njihet edhe si autor i një alfabeti origjinal të gjuhës shqipe. Disa studiues janë të mendimit se ky alfabet mund të jetë hartuar nga fundi i viteve 60 të shek. XIX⁸³”.

Por ka dhe zëra nga studiues të ndryshëm që thonë se hoxhë Tahsini kishte hartuar alfabetin e tij shumë më herët, diku në vitin 1858⁸⁴.

Me fjalë të tjera, ky dëshironte që ta unifikonte të shkruarit e shqipes nga të gjithë intelektualët shqiptar, sepse atë e konsideronte si një indikator real për të vërtetuar lashtësinë e popullit dhe të folmes shqipe.

Daut Boriçi (1825-1896)

Daut Boriçi lindi në qytetin e Shkodrës më 20 dhjetor 1825, në një familje të vjetër dhe të njohur për traditat e saj patriotike. Më 16 maj 1848, ai u emërua si imam i xhamisë së Draçinit në Shkodër dhe që atëherë do të quhet Molla Dauti. Pasi shërbeu për rreth dy vjet në këtë xhami, në vitin 1850 u nis drejt Stambollit për të vijuar studimet në medresenë e njohur Çifte Bash Kurshun, e themeluar që në kohën e sulltan Mehmet Fatihut II.

“Si klerik i mbrujtur me ndjenja patriotike, Daut Boriçi ishte një nga themeluesit, veprimtar dhe kryetar i degës lokale të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit⁸⁵”.

Krahas kontributit të tij në Lidhjen e Prizrenit bashkë me rilindësit tjerë, ai në veçanti shquhet për kontributin e madh që ka dhënë në formulimin e shkronjave me të cilat mendonte ta unifikonte mendimin e ideatorëve tjerë për një alfabet që do t’i përshtatet popullit tonë.

Për kontributin e madh që dha në ministrinë e Arsimit në Perandorinë Osmane, ai emërohet përgjegjës i arsimit për Vilajetin e Shkodrës, nga ku do të kursente kohë për të bërë përpjekje drejt hartimit të një abetareje të posaçme shqipe por me germa arabe.

⁸²Jani Vreto, *Vepra të zgjedhura*, Tiranë 1972, f. 268

⁸³Ibrahim D. Hoxha, *Nëpër udhën e penës shqiptare: nga historiku i ABC-së dhe i shkrimit shqip*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1986, f. 134

⁸⁴Necip Alpan, *Arnavut alfabesi nasıl doğdu*, Ankara: Çağdaş Basımevi, 1978 s.16.

⁸⁵Xhafer Belegu, *Lidhja e Prizrenit*, Tiranë, 1939, f. 22

Abetarja e Daut Boriçit e shtypur në Stamboll më 1861 e më pas edhe në vitin 1869, është një abetare shqip-turqisht, me shkronja arabo-turke dhe me krijime origjinale të autorit, pa asnjë shënim në frontespis, pa vit e vend botimi. Me këtë abetare, sipas studiuesve, ai zuri në Veri këndin e trinomit që kishin plotësuar më parë Veqilharxhi në Jug dhe Kristoforidhi në kërthizë të Shqipërisë. “Shqiptari me mënyrën e shkronjave që kam kallzue në alfabetin shqip, mbrenda pak kohe mundet me shkruë gjuhën e vet”. Këtë deklaronte Daut Boriçi si kredo politike, në librin e tij, më 1869.⁸⁶

Abetarja në fjalë ka gjithsej 37 shkronja, nga të cilat 28 janë të alfabetit arab; 2 i ka marrë osmanishtja dhe për të plotësuar nevojat e gjuhës sonë, 7 shkronja Daut Boriçi i hartoi vetë, nga ato fonema që i korrespondojnë gjuhës shqipe. Me këtë, ai provoi se shqipja kishte veçoritë e veta, se alfabetet e grafitë e gjuhëve të tjera nuk i plotësonin kërkesat gjuhësore të saj, se nga ana didaktike duheshin hedhur hapa të tjerë, se nga ana pedagogjike duhej përdorur një metodë e re, se nga ana edukative-kombëtare duhej mësuar në gjuhën amtare, etj.⁸⁷

Abetarja shqipe e botuar nga Daut Boriçi e vitit 1861 konsiderohet ndër abetaret e para të asaj kohe, të botuara në Shqipëri, edhe pse ishte një bashkëdyzim i dy alfabeleve, atij turk dhe arab, përsëri thuhet se përmbajtja e saj ishte kryekëput në vijën kombëtare, shqiptare. Kjo ishte një përpjekje e fuqishme dhe diplomatike e Boriçit që përmes këtij formulimi të abetares, të përcjellte mesazhin e arsimit shqip, tek popullata e pashkolluar.

"Kjo dëshmon për një hop në fushën e arsimit fillor kombëtar, me bazë gjuhën shqipe. Botimi i kësaj abetareje më 1861 si tekst i litografuar në Stamboll, me një tirazh të konsiderueshëm, kopjet e të cilit gjenden pas më vonë se një shekulli në disa familje shkodrane dhe në fondet e bibliotekave të tyre, të bindin se në shkollat e trevës së Shkodrës dhe të territoreve që mbulonte Daut Boriçi, si drejtues arsimit i Vilajetit të Shkodrës, është përdorur abetarja e tij."⁸⁸

Hafiz Ali Ulqinaku (1853-1913)

Hafiz Ali Ulqinaku u lind në vitin 1853 në qytetin e Ulqinit dhe vdiq në vitin 1913.

Siç dihet, kjo ishte periudha kur filloi beteja e Malit të Zi mbi Ulqinin, dhe nga kjo betejë nuk u kursye dhe hafëz Aliu, i cili mori armën dhe doli në mbrojtje të saj.

Me rënien e Ulqinit, ai së bashku me familjen e tij shpërngulet në drejtim të Shkodrës ku edhe filloi mësimet t'ij në medresenë e qytetit, kusipas vetë Hafiz Aliut mori edhe diplomën teologjike (ixhazetnamen). Frymën patriotike të tij e shohim të fjalët në vijim: “Gjuha e jeme asht shqipja. Shkruej e flas arabisht, turqisht, shqip”. Djali i tij, Saiti, në një parathënie të botimit të “Mevludi Sherifit” figurën e të atit na e përshkruan si mëposhtë: “I ndjeri Hafiz

⁸⁶Shefik Osmani, Niazi Kazazi, *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*, Shkodër: Idromeno, 2000, f. 85

⁸⁷Shefik Osmani, po aty, f. 86

⁸⁸Hasan Bello, Kumtesë mbi kontributin e Klerit musliman në hartimin e alfabeleve të shuhës shqipe, Zani i Nalt, Tiranë 2013

Aliu kishte me vedi një shpirt të madh të pajisur me kulturë të naltë teologjike, me natyrë të mprehtë poetike e me ndërgjegje të kullueme dhe të edukueme sipas parimeve të Islamizmës⁸⁹”.

“Në vitin 1882, Hafiz Aliu u emërua si mësues i shkollës fillore në lagjen “Dudas”. Ndërsa në vitin 1884, ai u transferua në Lezhë ku fillimisht ushtroi detyrën e mësuesit dhe imamit, e më pas edhe atë të Myftiut të këtij qyteti deri sa ndërroi jetë në vitin 1913⁹⁰”.

Kontributi i tij u shtri edhe në hartimin e tre fjalorëve shqip-turqisht me gjithsej 1334 faqe, të cilët mbartin vlera të mëdha leksikologjike, leksikografike, dialektologjike dhe për historinë e gjuhës shqipe.

Krahas shumë veprimtarive fetare dhe shkencore, Hafiz Aliu njihet dhe si hartues i një abetareje shqipe me shkronja arabe, e cila ka vlera të veçanta atdhetare, shkencore, gjuhësore dhe didaktike, sepse një përpjekje e këtillë veprimtarie, tregon qartë për një vetëdije të ngritur intelektuale e cila i referohet kontributit kombëtar.

Hafiz Aliu, ishte vërtet një fetar i mirë, por veprimtaria e tij patriotike posaçërisht kontributi i tij i pamohueshëm në gjuhën dhe shkronjat shqip e bën figurën e tij edhe më të mirë e më të spikatur në rrafshin patriotik.

Said Najdeni (1864-1903)

Said Najdeni, lindi në qytetin e Dibrës në vitin 1864, në familjen e Islam dhe Esma Najdenit. Njihet në historinë tonë kombëtare si rilindës, patriot, atdhetar dhe veprimtar i shquar i çështjes kombëtare.

Arsimin fillor Saidi e kreu me sukses në vendlindje në vitin 1882. Inteligjenca dhe zgjuarsia që ai kishte bënë që babai i tij ta dërgonte të birin për ta shkolluar fillimisht në Edirne e më pas në Stamboll, ku Saidi përfundoi me sukses studimet e larta teologjike në medresenë e Hajdar Pashës.

“Në vitin 1888, pas kryerjes së shkollimit në Stamboll, Saidi i frymëzuar me idealin kombëtar, u kthye në atdhe ku iu përvesh punës në shërbim të arsimit. Për këtë, që përpara se të kthehej ai mori me vete një sasi të madhe abetaresh të Shoqërisë së Stambollit me dëshirën e flaktë që të hapte në vendlindje shkollën e parë shqipe⁹¹”.

Në vitin 1900 ai hapi për herë të tretë shkollën shqipe në Dibër. Po në këtë vit në Sofje botoi “Abetare e gjuhës shqip: nde të folë gegënisht” pa emër autori dhe “Fe-rrëfenjësja e myslimanëve⁹²”.

Abetarja e Said Najdenit është hartuar me alfabetin e Stambollit, me të vetmin ndryshim se ajo i është përshtatur dialektit gegë, pjesë e së cilës ishte edhe popullsia e kësaj krahine. Alfabeti ka 36 shkronja të vendosur vertikalisht e horizontalisht bashkëngjitur me alfabetin e gjuhës frënge dhe greke. Në abetare janë vendosur ushtrime gramatikore si dhe

⁸⁹ Bello, po aty.

⁹⁰ Faik Luli, Islam Dizdari, *Hafiz Ali Ulqinaku-jeta dhe veprat*, Shkup: Logos-A, 2005, f. 27

⁹¹ Mahmud Hysa, *Alamiada shqiptare*, vëll.I, Shkup: Logos-A, 2000, f. 44

⁹² „Veteranët e Klerit Mysliman”, *Zani i Naltë*, nr.11, Nanduer 1937, f. 342-343

pjesëza leximi në dialektin e Dibrës, Shkodrës, Tiranës, Elbasanit dhe në dialektin toskë. Said Najdeni i përket atij grupi klerikësh që mendonte se alfabeti më i përshtatshëm për shkrimin e gjuhës shqipe ishte alfabeti latin.

Si përfundim, për këtë figurë po perifrazojmë një thënie të prof. Mahmud Hysës i cili shkruan se: “Saidi jetoi në kohën e Rilindjes, mendoj si rilindësit, veproi si rilindës, shkroi si rilindës dhe vdiq si rilindës.”⁹³

Hafiz Ali Korça (1874-1957)

Hafiz Aliu konsiderohet si një ndër figurat më të spikatura fetare dhe kombëtare në historinë e kombit tonë. Ai kontributin e tij të pasqorë e dha edhe në fushën e gjuhës dhe letërsisë, dhe gjithashtu njihet si publicist i madhë.

"Në Kongresin e Dibrës të vitit 1909, në të cilin morën pjesë 115 burra nga më të zgjedhurit, më fisnikët dhe më patriotët e Shqipërisë ishte Hafiz Aliu ai që propozoi për të parën herë problemin e mësimin të gjuhës shqipe, përmirësimin e modernizimin e medreseve dhe shumë çështje të tjera të rëndësishme. Fjala e tij u dëgjua me vëmendje të madhe dhe me nderim prej të gjithëve dhe kongresi vendosi të bëjë demarshet e duhura pranë qeverisë osmane që gjuha shqipe të ishte e detyrueshme për t'u mësuar zyrtarisht nëpër të gjitha shkollat e Shqipërisë⁹⁴".

Kishte fatin të jetë mësues i shkollës së parë shqipe të Korçës, duke u konsideruar ithtar dhe luftëtar i paepur i rilindjes kombëtare shqiptare.

Botoi abetaren e vet në vitin 1910, duke përdorur dy alfabetet për ta kurorëzuar sa më mirë projektin e vet, atë të Stambollit të vitit 1884 sidhe alfabetin e miratuar në Kongresin e Manastirit të vitit 1908

⁹³ Hasan Bello, Kumtesë mbi kontributin e Klerit musliman në hartimin e alfabeve të shuhës shqipe, Zani i Nalt, Tiranë 2013

⁹⁴ Hasan Bello, Kumtesë mbi kontributin e Klerit musliman në hartimin e alfabeve të shuhës shqipe, Zani i Nalt, Tiranë 2013

ABETARE.

PREJ

Hafëz Ali-ut

Hatib i Korçës



K O R Ç E

ypur ne glypsokronen „Korça“: ne Korçe
1910 (1326).

Rexhep Voka - Tetova (1847-1917)

Rexhep Vokau lindi në fshatin Shipkovicë të Tetovës në vitin 1847. Arsimin fillor dhe atë plotor e mori në vendlindje, ndërsa atë të lartë për shkenca islame e përfundoi në Stamboll. Pas kthimit në Tetovë në vitin 1895 e, sidomos pasi u emërua si myfti i Vilajetit të Manastirit në vitin 1903, Hoxhë Voka, mori pjesë aktive në Lëvizjen Kombëtare.

Voka në veprën e tij *Mendimeshprehtë* emocionin e tij real që dilte nga thellësia e shpirtit për gjendjen e kombit në atë kohë. Paraqiste realitetin që aktualisht mbizotëron dhe mendohej që të gjejë një zgjidhje adekuate, apo përgjigjen e duhur për ta shëruar gjendjen jo të kënaqëshme të popullit shqiptar.

A përpiloi një abetare të gjuhës shqipe me shkronja arabe. Voka ishte ithtarë i alfabetit arab, prandaj thuhet se ai nuk pajtohej me mendimin e rilindësve për hartimin e alfabetit shqip të Kongresit të Manastirit.

Abetarja e Hoxhë Rexhep Vokës kishte gjithsej 20 faqe dhe në hyrje të saj shkruhej: "Popullit të zgjuar shqiptar, që fëmijët të shkruajnë dhe të lexojnë në gjuhën e vet amtare, në mënyrë që të arrihet një përparim material dhe shpirtëror". Në librin *Mendime* ai shkruan se "nuk ka në histori asnjë shembull në jetë, që një popull të ketë përparuar dhe të jetë ngritur pa mësuar në gjuhën e vet..."⁹⁵.

Ai porositi të gjithë shqiptarët që: "Gjuhën tone, bashkë me gjuhën turke, ta mësojmë se është një punë e mençur. Secili e di se deri tani sa të mos mësojmë edhe në gjuhën tonë amtare, kombit dije dhe edukim të përgjithshëm nuk mund t'i japim..."⁹⁶

"Më 1911 ai botoi edhe *Gramatikën elementare shqipe* si dhe një tekst të mësimit fetar *Ilmihal i hollësishëm shqip*. Moto e Rexhep Tetovës për të gjithë shqiptarët mbetën fjalët: "Shkollat t'i hapim dhe në mos paçim mundësi të ndërtojmë ndërtesa të mëdha, në kolibe me kashtë t'i tubojmë fëmijët vetëm që të mësojnë" dhe "ne shqiptarët është turp të mbesim më poshtë se popujt e tjerë"⁹⁷.

3.4. Hasan Tahsini: Një figurë e ndritur e popullit shqiptar

Lindi më 1811 në Ninat afër Sarandës, Shqipëri dhe vdiq më 1881. Ishte rilindës, filozof, matematikan. Dijetar i shkallës botërore dhe pararojë e Rilindjes

⁹⁵Rexhep Vokë Tetova, *Mendime*, Tetovë: Këshilli i Bashkësisë Islame, 1991, f.46 (Transkriptimi dhe përshtatja në gjuhën e sotme shqipe u realizua nga dr. Feti Mehdiu). Kjo vepër është botuar për herë të parë në Stamboll në vitin 1910.

⁹⁶Rexhep Vokë Tetova, *po aty*.

⁹⁷ Hasan Bello, *Kumtesë mbi kontributin e Klerit musliman në hartimin e alfabeteve të shuhës shqipe*, Zani i Nalt, Tiranë 2013

Kombëtare. Përveç gjuhës amtare, zotëronte edhe disa gjuhë të huaja. Ishte njohës i thellë dhe shtjellues i shkencave të natyrës dhe i atyre shoqërore; vëzhgues dhe shkoqitës i dukurive mbi gjithësinë e rruzullimin, themeluesi dhe drejtuesi i të parit universitet shtetëror në sulltanatin osman si dhe i “Xhemijet-i Ilmijje-i Arnavudijje”, Shoqëria e Dijetarëve Shqiptarë apo Kuvendi Shkencor Shqiptar. Hoxhë Hasan Tahsin efendiu u bë dhe mbeti i pari dhe i vetmi shqiptar që organizoi dhe drejtoi një universitet ndërkombëtar; – atë osman, Ishte rektor i parë i Universitetit të Stambollit.⁹⁸

Mendohet se ai ishte i pari që mbolli dhe përhapri në sulltanatin osman shkencat e natyrës dhe ligjet e gjithësisë e rruzullimit, psikologjinë etj.

Personaliteti i tij u bë i fuqishëm në mendjet e shtetasve osman duke bërë përpjekje të fuqishme për fillimin e një epoke të re moderne të ligjerimit në shkencat sociale dhe ato natyrore. Përkundër përpjekjeve të mëdha për të ngritur nivelin arsimor në shtetin osman, dhe duke e dërguar atë në rrafshin institucional, siç ishte themelimi dhe udhëheqja e universitetit të parë në Stamboll, ai përsëri gjeti kohë për ti kushtuar veten çështjes kombëtare.

Roli i veçantë i Hoxhë Tahsinit ishte në alfabetin e gjuhës shqipe, të cilin donte ta kishte të ndryshëm nga alfabetet e gjuhëve të tjera për të treguar personalitetin e popullit të tij. Hoxhë Tahsini qe mësues i Abdylit, Naimit e Samiut, Vaso Pashës, Jani Vretos, Ismail Qemalit e Daniel Oparakut.

I ati i tij, Osman efendi Rushiti, - njëri prej të diturve në sulltanatin osman, - ishte nga fshati Ninat, ndërsa për vet të ndjerin Hasan Tahsini, në asnjë nga burimet e kohës, të gjetura deri më sot, nuk shënohen as vendlindja e as datëlindja e tij. Bashkëfshatarët: Faslli Nuri Cenja, Merso Birbil, Xhafo Kasimi, Musa Shero, Musa Sherifi dhe mësuesi Qemal Ismail efendi Mudeja kanë thënë se Osman efendiu, familjen e mbante përherë pranë vetes, në vend-emërimet me detyrë dhe se të bijtë i mësonte vetë. Rrjedhimisht, mos-gjetja e shënuar në ndonjë dokument e vendlindjes dhe e datëlindjes vjen nga mungesa e amëzës së shkollës fillore dhe asaj të mesme. Shemsuddin-Sami Frashëri, nxënësi i tij më i afërt shkroi se dijetari vdiq në moshën 70 vjeç, e dhënë kjo e rumbullakosur, pa përmendur burimin ku e gjeti. Ndërsa Lemi Elbiri në “Aylık Ansiklopedisi” (Enciklopedi mujore), (Nr. 51, Stamboll, korrik 1948, fq. 1486), shkruan se Hasan Tahsini lindi në vitin 1813. Datëlindjen e tij s’e përcakton me përpikëri as akademiku enciklopedist, Mahmut Kemal Inal. Ky, në veprën e vet “Son Asır Türk Şairleri”, (Vjershëtarë turq të qindvjeçarit të fundit), vëll: X, Stamboll 1970, fq. 1833, shkruan: “hamendësisht 1813 (1228 h.) në njërin prej fshatrave të nënprefekturës së Filatit të Çamërisë.. Deri kur ushtria osmane shembi shtetin gjysmë të pavarur të drejtuar nga Ali Pashë Tepelena (janar 1822), –pra, kur ai ishte rreth 10 vjeç, - qëndronte pranë të atit, me shërbim në Prevezë⁹⁹.

Nga ai vit e deri në vitin 1831 kur shembet edhe vilajetin shqiptar i Shkodrës, Tahsini qëndroi në Shkodër, ku i ati i tij qe marrë në shërbim nga Mustafa Pashë Bushati. Kjo gjë Osman Efendiun e detyroi të zbriste në Berat, ku e emëruan myfti të qarkut. Në Ninat Hoxha

⁹⁸ <http://www.radiokosovaelire.com/hoxhe-hasan-tahsini-1811-1881-rilindes-atdhetar-filozof-dhe-matematikan-shqiptar/>

⁹⁹ Figura e Ali Pashës, Grup Autorësh Tiranë- 2002

Tahsini shkoi kur i vdiq i ati, ku doemos që iu desh të merrej me bujqësi, si tërë bashkëfshatarët e vet. Mirëpo, në kokën e tij vlonin gjykime të tjera. Pas rreth tre muajsh, i vëllai, hoxhë Maliqi, - që i dalloj synimet e tij, - një ditë nga ditët i tha: “Pa pse mo vlla të ka ngrënë sorra trutë e të ka marrë koka erë. Kërkon të marriç syt e tu e të veç prapa diellit. Ne kemi mall e gjë më shumë nga të tërë. Pse do që t’u kthehesh krehet e të humbësh në anë të dunjas?!”. Hasani iu përgjigj qetë-qetë: “U do vete për kërkim nëpër udhën e glatë për të gjetur dituri, atë që e bën njeriun njeri... Mallin e gjërin t’i kam falur, me bar e me gjethe”. Tahsini së pari, u stërvit nga i ati, pastaj erdhi në Stamboll. Pra, meqë mësimet e para i pati marrë nga i ati, - kur qe drejtor arsimit në qarqe e kur ishte myfti, - vetëkuptohet se i ka munguar amëza shkollore. Hasan Kaleshi lidhur me të shkruan:

“Lindi më 1812. Në Stamboll ai shkoi në moshë të pjekur, ndoqi mësimet në medresenë “Fatih”. Ku, ngaqë shkëlqente, drejtori-dijetari me emër, hoxhë Mustafa ef. prej Vidini- i dha edhe mësimet të veçanta dhe cilësimin: “Tahsin” (I pëlqyeshëm, i lëvduar, shembullor). Andej e mbrapa u quajt me emrin e përngjitur: “Hasan-Tahsin”. Si mirënjohje dhe falënderim për mësuesin dhe vlerësuesin e vet, vdekjen e dije-dhënësit të tij, hoxhë Hasan-Tahsin efendiu e përjetësoi me këto vargje: U shkrua me lotët e Tahsinin: vdiq dijetari filozof prej Vidinit. Në përfundim të studimeve, Tahsinin e emëruan muderriz (mësimdhënës) të filozofisë dhe të matematikës në po atë medrese.

Kur qeveria osmane e pa të domosdoshme çeljen e universiteteve në sulltanatin osman, një nga të dy të zgjedhurit e dërguar prej saj në Paris, për t’u pajisur me dituritë e nevojshme shkencore, ishte Hoxhë Tahsini. Njoftimi qeveritar u shpall në fletoren zyrtare “Xheride-i Havadis”, datë 14. Xhemadi-ul-ahir 1273 H.(10.X.1857): “...Ka dalë dekret mbretëror që urdhëron të dërgohen në Paris Lartësitë e Tyre, Tahsin Efendiu dhe Selim Efendiu, dy prej myderrizëve të nderuar, për të mësuar studentët e dërguar në Paris nga zyrat e shkollat mbretërore si edhe për t’ua mësuar gjuhën e bukur turqisht nënshtetasve të krishterë të mbretërisë osmane që ndodhen në Paris¹⁰⁰.

Në mesin e shkurtit 1868 Tahsini u kthye në Stamboll, në përbërjen e grupit qeveritar që shoqëroi kufomën e ish- Kryetarit të Këshillit të Lartë të sulltanatit osman, Mehmed-Fuad Pashait; ai më 11 të atij muaji vdiq në spitalin e Nicës (Francë), ku qe dërguar për shërim. Oborri dhe Porta e Lartë, Tahsinin e ngarkuan me ngritjen dhe drejtimin e universitetit, për çeljen e të cilit kishin vendosur që në vitin 1866, (Maarif Nezaret-i teşkilat-i) dhe (Türk Tarih Encümen Mecmuası, Nr. 17(94), 1927), po deri atëherë s’ishte gjetur ende njeriu i duhur. Doemos që në atë shoqëri gjendeshin plot dijetarë, mjaft të zotë, po jo “Tahsin”. Dijetari i ndritur arriti që të gjente mësimdhënësit e aftë prej kombesh të ndryshëm, asokohe brenda shtetit osman. Ai, gjithashtu, ndërmjet një deti talebesh të diplomuar nëpër medresetë osmane, zgjodhi studentët e përshtatshëm; dhe - siç dëshmon Shemsuddin-Sami Frashëri, - “ditën e caktuar, në pallatin “Nana Mbretëreshë” e çeli me aq madhështi universitetin e parë në sulltanatin osman¹⁰¹”.

¹⁰⁰<http://www.forumivirtual.com/personalite-t-shquara-shqiptare-63/hoxhe-hasan-tahsini-61551/>

¹⁰¹Ali Arslan, *Darülfünun ‘dan Üniversiteye*, Istanbul: Kitabevi, 1995

3.5. Delegatët e kongresit dhe hartimi i Alfabetit

Përpyjekjet individuale të rilindësve shqiptar për të kontribuar në alfabetin dhe gjuhën shqipe, kishin treguar rezultat jo të mjaftueshëm për ta mbushur boshllëkun që ishte në popullin shqiptar, kështu që me komunikimin e rilindësve dhe kontibutdhënësve në fushën e përpilimit të një alfabeti unifikues, më 14 nëntor - 22 nëntor 1908 në Manastir, ndodhi takimi për përcaktimin dhe hartimin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe.

Gjatë takimeve dhe diskutimeve në këtë kongres ishin të hartuar dhe erdhën në propozim disa alfabete të ndryshme. Në mesin e shumë propozimeve ishte edhe ai i krijuar në Stamboll nga patriotët shqiptarë, i njohur si alfabeti i Stambollit. Ska dyshim se një alfabet i njësuar dhe plasuar në popullatën shqiptare do të ishte fillimi i letërsisë mbarëshqiptare dhe suksesi më i madh i arritur ndonjëherë në fushën e alfabetit shqip.

Kongresi i Manastirit me të drejtë quhet kuvendi më i rëndësishëm kombëtarë gjuhës dhe për gjuhën shqipe. në këtë kongres ishin tubuar masa intelektuale dhe diplomatike shqiptare, të ardhur anë e mbanë botës për ta dhënë kontributin e tyre intelektual në këtë fushë.

Në këtë kongres ishin të pranishëm 50 delegatë, të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, si dhe nga komunitetet shqiptare në Rumani, Itali, Greqi, Turqi, Egjipt, Amerikë etj. Tridhjetë e dy delegatë me të drejtë vote ishin shkrimtarë e publicistë të njohur, veprimtarë të lëvizjes kombëtare dhe përfaqësues të klubeve shqiptare në emigracion si: Mithat Frashëri, Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Shahin Kolonja, Dhimitër Buda, Ndre Mjeda, Gjergj Qiriazi, Bajram Topulli, Nyzhet Vrioni, Grigor Cilka, Nikollë Kaçori, Fehim Zavalani, Dhimitër Mole, Rrok Berisha, Thoma Avrami, Hilë Mosi, Ekil Eftemiu, Adham Shkaba, Mati Logoreci, Aziz Beu, Shefqet Frashëri, Simon Shuteriqi, Leonidha Naço, Zejnel Glina, Sami Pojani, Refik Toptani, Mihajl Grameno, Hafiz Ibrahim Efendiu, Emin Haxhiu, Rauf Beu, Salahedin Beu¹⁰².

Siç dihej, Kryetar i Kongresit u zgjodh Mithat Frashëri, i biri i Abdyl Frashërit. Mithat Frashëri ishte në atë kohë redaktor i dy revistave që botoheshin në Selanik: *Liria* dhe *Dituria*.

Kumtesa e mbajtur nga Gjergj Fishta, nga Shkodra, preku të gjithë pjesëmarrësit, sa një hoxhë rendi ta përqafoje para të gjithëve. Kërkesa e kombëtaristëve shqiptarë ishte që gjuha shqipe të mos shkruhej as me shkronja arabe, as me shkronja greke, por me alfabetin latin, gjë që nënkupton mosnënshtrimin qoftë ndaj osmanëve, qoftë ndaj grekëve. Kongresi vendosi me votë unanime të lënë mënjane alfabetin e Stambollit, dhe ta shkruanin gjuhën shqipe vetëm me alfabetin latin me 36 shkronja, cili përdoret deri më ditët tona. Gjithashtu, u vendos që pas dy vjetësh të mbahej një Kongres i dytë në Janinë për të shqyrtuar problemet drejtshkrimore e letrare, si dhe për të bërë përpjekje për shkrirjen e dialekteve gegë dhe toskë në një gjuhë të njësuar shqipe. Duke qenë se para Kongresit të Manastirit, gjuha shqipe ishte shkruar me shkronja arabe, greke, sllave, apo përshtatjet e tyre, vendosmëria e delegatëve për t'i kthyer sytë nga Përfundimi ishte haptazi një shpallje kulturore e pavarësisë, gjë që nuk kaloi

¹⁰² Demiraj & Prifti, po aty, f. 84

pa u vënë re as nga qeveria turke e as nga kisha ortodokse greke dhe aleatët e tyre sllavë.¹⁰³

Në Manastir u hap edhe shtypshkronja, e cila financohej nga një grup tregtarësh atdhetarë myslimanë shqiptarë. Shtypshkronja e Manastirit shpejt u bë e njohur në të gjithë Shqipërinë si shpërndarëse e librave dhe gazetave në gjuhën shqipe. Në këtë punishte ishin të punësuar 17 vetë, të cilët punonin me një makinë të re elektrike, që vihej në lëvizje me dorë, për të shtypur gazetën e përjavshme *Bashkimi i Kombit* si dhe abetaret shqipe dhe tekstet shkollore. Ndërkohë çështja e gjuhës shqipe shpesh bëhej shkas për shpërthimin e dhunës së fanatikëve që sulmonin pa mëshirë përparimin e gjuhës shqipe. Babë Dudë Karbunara (1842-1917) i lindur në Berat, bashkëpunonte ngushtë me Kostandin Kristoforidhin. Babë Karbunara shumë herë filloi gjatë krenimit të meshës të lexonte ungjillin në gjuhën shqipe dhe kështu i filluan kërcënimet e para nga eprorët klerikë ortodoksë dhe më 1895, fanatikët i dogjën të tërë shtëpinë. Prifti ortodoks kapedan Stathi Melani vraponte me librat shqip në gjë dhe me pushkën në krah fshat më fshat në Shqipërinë e jugut për përhapjen e shkollës shqipe dhe kishën shqiptare mësuesve të rinj.¹⁰⁴

3.6. Shkolla e parë shqipe

Mësonjëtorja e Korçës

është shkolla e parë e gjuhës shqipe. Ajo u hap më 7 mars të vitit 1887 në Korçë në shtëpinë e ofruar për mësimdhënie nga Diamanti Terpo. Kjo ndërtesë është sot muzeum kombëtar i arsimit. Mësues dhe drejtor i parë i saj ishte Pandeli Sotiri. Ai e filloi mësimin në gjuhën shqipe fillimisht me 35 nxënës. Hapja e kësaj shkolle për nga karakteri kishte tipare demokratike, pasi në të mësonin fëmijët e të gjitha shtresave, të varfër e të pasur.

Hapja e shkollës ishte një ngjarje dhe një fitore e madhe për gjithë lëvizjen kombëtare. Mësonjëtorja e Korçës ishte qendër e rëndësishme për formimin kulturor dhe ngritjen e ndërgjegjes dhe moralit në popull. Ajo nxiti edukimin patriotik të brezit të ri e të masave të gjera. Shkolla tërhoqi interesin dhe admirimin e shumë shqiptarëve, nën shembullin e saj u frymëzuan më vonë edhe banorë të viseve dhe trevave të tjera shqiptare¹⁰⁵.

Edhe pse në kushte të vështira, kur mësimi i gjuhës shqipe për shkak të kushteve të ndodhura nën sundimin osman ishte rreptësisht i ndaluar, mësonjëtorja e Korçës qëndroi e hapur për gati 15 vjet. Drejtues të saj ishin figura të njohura të Rilindjes shqiptare si Paneli Shtiri, Petro Nini Luarasi, Nuçi Naçi, Thoma Avrami, etj. Kontributi i madh që këta atdhetarë dhe veprimtarë të shquar dhanë për kombin dëshmohet nga dëshira e zjarrtë që ata kishin për të përhapur dijen në popull. Me ato mundësi që kishin ata u bënë iniciatorët e krijimit të

¹⁰³<http://www.albaniapress.com/lajme/15224/Kongresi-i-Manastirit-1908.html>

¹⁰⁴ Demiraj & Prifti, po aty, f. 86

¹⁰⁵<http://shqiptarja.com/aktualitet/2731/7-marsi-126-vjet-nga-mesonjeterja-e-pare-shqipe-ne-korce-146429.html>

teksteve të para shkollore të dokumentuara. Ata i përkushtuan një rëndësi të madhe pajisjes me mjetet e duhura të mësimdhënies për të bërë më tej edhe shpërndarjen e tyre te nxënësit. Të edukuar me frymën e lartë të patriotizmit, këta nxënës do të bëheshin në të ardhmen dhe pasuesit e denjë të ideologjisë së mësuesve të tyre dhe luftëtarë të devotshëm për luftën për liri dhe pavarësi. Mësonjtorja Shqipe e Korçës nuk ishte thjesht një arritje arsimore, por edhe një akt me vlera të mëdha politike. Në këtë kuadër, shkolla kishte si detyrë që nëpërmjet përhapjes së gjuhës shqipe të ndihmonte në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare, në rritjen e përpjekjeve të shqiptarëve për autonomi¹⁰⁶.

Rëndësia e hapjes së shkollës së parë shqipe, në aspektin politik dhe kombëtar ishte një fitore e madhe e rilindësve shqiptarë në atë kohë, ngase tashmë shkolla u bë vatër e ngritjes së vetëdijes dhe ndërgjegjies kombëtare, krahas zhvillimit të gjuhës shqipe dhe letërsisë kombëtare.

Siç dihet, veprat e rilindësve, përfshirë abetaren dhe gramatikën e Sami Frashërit, të Naimit, aritmetikën e Jani Vretos, përfshinin kryesisht përmbajtje patriotike, ato veçoheshin me një shkrim strategjik në të cilën trajtohej projekti i ngritjes së vetëdijës kombëtare.

KAPITULLI I KATËRT

4. Diplomacia Osmane dhe çështja shqiptare para dhe pas shpalljes së Pavarësisë

4.1. Shqipëria "e pushtuar" që udhëhoqi Perandorinë Osmane

Duke filluar nga beteja e Kosovës 1389 kur edhe bëri hapë Perandoria Osmane për tu vendosur në trojet shqiptare e deri tek shpërbërja e saj në vitin 1924, shqiptarët luajtën rol të rëndësishëm në perandori.

Si zakonisht, politika ushtarake në çdo regjim, grumbullon koka të afta për t'i rekrutuar dhe i shfrytëzon aftësitë e tyre, dhe tek kjo pikë shqiptarët shquhen, për trimëri dhe strategji luftarake. Duke u nisur nga kjo, shteti osman nga shqiptarët përfitoi më shumë se çdo etnitet tjetër, sikundër që shqiptarët në Perandorinë Osmane arritën pozitat më të larta të mundshme më shumë se çdo etnitet tjetër, dhe kjo si rezultat i aftësive dhe besnikërisë së shqiptarëve.

Perandoria Osmane përbëhej nga shumë etnitete dhe popuj të ndryshëm në administratën e saj, prandaj me të drejtë thuhet se edhe shqiptarët ishin pjesë përbërëse e perandorisë, bile edhe për nga pozita ishin të barabartë me turqit sa i përket udhëheqjes.

¹⁰⁶https://sq.wikipedia.org/wiki/Mësonjëtorja_e_Korçës

Shqiptarët bashkëqeverisën me Perandorinë Osmane dhe bashkëjetuan me ta siç dhe thotë historiani Ferid Duka: "Sot ne duhet të gjykojmë duke e njohur realitetin osman siç duhet.

Historianët e mëdhenj e kanë parë periudhën osmane si histori zhvillimi ekonomiko-shoqërore me tiparet e veta shumë origjinale, shumë specifike, e kanë parë si bashkëjetesë të popujve nën çatinë e perandorisë, popuj të cilët para se të vinte këtu perandoria, ishin në luftë, në grindje permanente me njëri-tjetrin, dhe shteti osman e jetësoi atë që u quajt *Pax Ottomana* (paqja osmane). Shteti osman vendosi një sistem politik, ekonomik dhe një legjislacion që ishte rregullator i kësaj bashkëjetese që ka tërhequr me të vërtetë vëmendjen e studiuesve në korniza globale. Populli shqiptar ka jetuar si element përbërës i perandorisë në kushtet e funksionimit të shtetit osman, me të njëjtat të drejta si qytetarët e tjerë dhe nuk është e vërtetë teza se shteti osman i la shqiptarët të pazhvilluar, të prapambetur. Ishin vetë shqiptarët që e lanë veten e tyre në gjendje të dekadencës.¹⁰⁷

Shqiptarët i dhanë perandorisë figura të rëndësishme shtetërore, kryeministra, vezirë, shkrimtarë e poetë, arkitektë të cilët lanë gjurmët e veta në ekzistencën e perandorisë por edhe të Turqisë së sotme, siç është autori i himnit të Turqisë moderne, Mehmet Akifi, shkrimtar dhe kontribues më i madhe në gjuhën dhe letërsinë turke, Shemsedin Samiu i njohur si Sami Frashëri tek ne, e shumë e shumë figura të rëndësishme.

"Shqiptarët qeverisën perandorinë osmane si kryeministra, për një periudhë prej afro 150 vjetësh. Kryeministrat shqiptarë i dhanë osmanëve Anadollin, Stambollin, Irakun, Jemenin, Egjiptin, Algjerinë, Libinë, Arabinë, Sirinë, Hungarinë, Krimenë, Kretën etj. Pra, me punën dhe mendjen e shqiptarëve, u ngrit perandoria osmane. Ky është një fakt që pranohet nga vetë turqit dhe historianët që studiojnë këtë periudhë të historisë. Gjatë shekullit XVIII-XIX, nuk ka pasur shumë shqiptarë në rangun e kryeministrit dhe shihet që perandoria pati disfatë të tmerrshme që vunë në pikëpyetje ekzistencën e saj. Po të mos donin disa shtete perëndimore ta mbanin për kundërpeshë ndaj Rusisë, patjetër që do të kishte rënë. Këta dy shekuj shqiptarët nuk ishin pa pushtet, por kishin fituar pavarësinë nga sulltani, dhe qeverisnin për llogari të vet në disa shtete, si në Arabi, Siri, Egjipt etj.¹⁰⁸

Lidhur me pushtimin e përmendur në vazhdimësi nga historianë, publicistë e gazetarë, si në sarkazëm historian turk Mehmet Hacisalihoglu thotë: " Në fillim ka qenë pushtim, por më pas situata ndryshoi. Nëse ju (shqiptarët) doni të shihni gjyshërit tuaj si pushtues, atëherë mund t'i shihni. Të gjithë ata pashallarë shqiptarë që kanë udhëhequr në Perandori, nga vendet e afërta deri në Egjipt... kanë qenë pjesë e Perandorisë 'pushtuese'. Këto janë fakte e duke qenë kështu, atëherë do të thotë se këta qenë pushtuesit shqiptarë. Brenda Perandorisë Osmane, shqiptarët qenë pushtues gjithashtu, jo vetëm turqit.¹⁰⁹"

¹⁰⁷ https://www.youtube.com/watch?v=_f-5sii1Ke4

¹⁰⁸ <http://www.albeu.com/biografia-kush-eshte/kush-ishin-39-kryeministrat-shqiptare-te-perandorise-osmane/110018/>

¹⁰⁹ <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=24691>

4.2. Ndikimi i intelektualëve shqiptarë në Perandori

Ndikimi i popullit shqiptar dhe personaliteteve të zgjedhura shqiptare që bënë nam në perandori është për t'u admiruar, sepse ishte i gjithanshëm, duke filluar nga politika, ushtria, arkitektura, letërsia, me një fjalë ndikimi dhe kontributi i tyre ishte i pazëvendësueshëm, dhe mund të thuhet se Perandorisë Osmane, populli shqiptar i dha atë që nuk i dha asnjë popull tjetër.

Përkundër angazhimeve të shumta të tyre në funksione të larta të shtetit osman, shqiptarët nuk e harruan asnjëherë gjuhën dhe kombin e tyre, siç edhe thotë Ismail Kemal Bej Vlora për katragjyshin e tij Sinan Pashën, kur fletë për gjenealogjinë e familjes së tij, se edhe pse i shërbeu besnikërisht perandorisë, ndërsa në të njëjtën kohë mbajtën pastër e të papërlyer ndjenjën kombëtare prej shqiptari¹¹⁰.

Kontributi dhe ndikimi i intelektualëve në Perandorinë Osmane ishte i gjithanshëm, sepse shqiptarëve u ishte lejuar e drejta që të ngjiteshin në shkallën më të lartë të udhëheqjes osmane. Në vazhdim do të ndalemi te pozita e ideologëve të kombit shqiptar në atë periudhë të nxehtë kohore, atëherë kur turqit e rinj filluan të bënë ndryshime, kur disa popuj ishin shkëputur nga shteti osman dhe kishin themeluar shtetet nacionale të tyre. Mu kjo është periudha që më së paku është studiuar dhe analizuar nga studiuesit tanë, ose qëllimisht është lënë anash, ngase vitet 1908 deri 1912, ose më mirë të themi fundi i shekullit XIX është periudha më e nxehtë në Ballkan si dhe kriza më e madhe që e kishte përjetuar ndonjë herë shteti osman dhe populli shqiptar në veçanti. Është kjo periudha kur formoheshin shtetet kombe të reja, në të cilën sfidë kishte hyrë dhe populli shqiptar, kohë kur shënohej angazhim serioz politik dhe diplomatik i elitës shqiptare, përprjekje kjo që do të kurorëzohet me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Në kohën e krizës ballkanike, kur Aleanca e sapoformuar Ballkanike kishte marrë hov në drejtim të tokave shqiptare, lëvizja kombëtare shqiptare u gjet para një terreni jo të përshtatshëm për të vepruar në dobi të territoreve të saja, sepse forcat osmane ishin dobësuar dhe në vazhdimësi territori i administrimit të tyre tkurrej, një territor shqiptarësh ende nuk ishte skicuar. Vështirësia sa vjen e shtohet, ngase Aleanca Ballkanike synonte që Greqisë t'i bashkohej Epiri, Malit të Zi t'i bashkohet një pjesë e brigjeve të Liqenit të Shkodrës së bashku me Shkodrën, Durrësi kërcënohej nga serbet, me çka rrezikohej territori i shqiptarëve gjithandej.

Duke parë se çështja shqiptare ishte vënë në pazar dhe rreziku i tokave ishte permanent, Ismail Qemali me rilindësit tjerë kërkonin që shqiptarëve t'iu jepeshin të drejta më të mëdha, një autonomi nën qeverinë osmane, duke u përkrahur dhe nga Fuqitë e Mëdha, me qëllim që të mënjanohej rreziku i copëtimit dhe aneksimi i tokave shqiptare nga fqinjët.

¹¹⁰Eqrem Zenelaj, poa aty, f. 461

Në vazhden e këtij projekti, Ismail Qemali dhe Ferid Pasha dakordohen në vitin 1911 që autonomia nën shtetin osman të jetësohet e cila do të jetë nën sovranitetin Hidivëve të Egjiptit (Dinastisë së Mehmet Ali Pashës)¹¹¹

Është e rëndësishme të dihet se në këtë periudhë tranzicioni që e kishte kapluar shtetin osman, turqit e rinj bënë politika të dyanshme me shqiptarët, në njërin anë thirrshin në implementimin e të drejtave që duhej t'i gëzonin shqiptarët, kurse në anën tjetër synonin që ta ngjallnin nacionalizmin në popullin e vet, duke synuar kështu që t'i turqizonin popujt tjerë të Ballkanit. Kjo politikë e dyfishtë e tyre nuk iu shkoi mirë, duke e ditur tashmë se diplomacia shqiptare kishte ndarë mendjen që përfundimisht t'i përcaktonte territoret e veta dhe të quheshin shqiptare, t'i bashkonte vilajetet shqiptare në një vilajet, kjo ishte mundësia e fundit e unitetit kombëtar, por fatkeqësisht, siç dihet shqiptarët, u detyruan që ta shpallin pavarësinë në një territor tejet të vogël duke lënë kështu shumë troje tjera shqiptare jashtë vijës së shtetit shqiptar.

Historishkruesit shqiptarë do të ishte mirë të merreshin më detajisht me periudhën 400 apo 500 vjeçare të shqiptarëve nën shtetin osman. Në përgjithësi është e nevojshme të dihet statusi real që e ka pasur shqiptari në atë kohë, brenda asaj periudhe qindra vjeçare, me qëllim që ta kuptojmë drejt rolin dhe funksionin e Perandorisë Osmane në Ballkan. Në fakt pa një studim të mirëfilltë të kësaj periudhe, historia e popullit shqiptarë nuk do jetë e kompletuar për derisa na mungon një pjesë krenarisë nën pluhurin e këtyre viteve.

Është e drejtë legjitime që ta parashtrijmë pyetjen pse arritën gjithë këta shqiptarë të jenë në këtë pozitë të lartë shtetërore?

Përgjigja e kësaj pyetje do studim të hollësishëm dhe është trajtuar shumë pak apo me mirë me thënë në mënyrë simbolike nga historiografia shqiptare për arsye politike.

"Shqipëria i ka dhënë Perandorisë Otomane vezirët e mëdhenj më të mirë dhe gjeneralët më trimë. Mehmet Pashë Qypriliu, Ahmet Pasha, Lutfi Pasha, Sinan Pasha, Mustafa Pashë Bajraktari, dhe sa e sa të tjerë burra shteti e gjeneralë, meritat e të cilëve janë të pakufishme, kanë marrë në periudhat më të vështira, qoftë udhëheqjen e ekonomisë, qoftë komandën e ushtrisë, dhe nëpërmjet aftësive të tyre, nëpërmjet guximit të tyre kanë dalë fitimtarë, si ndaj armiqve të jashtëm, po ashtu edhe ndaj vështirësive të brendshme, duke ndihmuar në mënyrë që fuqia dhe pushteti i perandorisë, e cila shpeshherë për shkak të administrimit të keq, ka qenë në prag të rrënimit, të rigjenerohet dhe të qëndrojë në këmbë"¹¹²

Në kuadër të kësaj historiani dhe studiuesi, Paskal Milo shprehet: "Janë dy arsye të fuqishme se pse shqiptarët nuk kishin një pjekuri apo ndërgjegjësi kombëtare për të krijuar shtetin e pavarur;

Epara, shqiptarët ishin të integruar në perandori dhe posedonin postet më të larta në këtë shtet që asnjë komb tjetër nuk i kishte, dhe;

¹¹¹Zenelaj, po aty, f. 278

¹¹²Pashko Vasa, po aty f. 31

E dyta, shumica e shqiptarëve identifikoheshin me osmanllin, ngase i përkisnin fesë islame dhe gëzonin të drejta të barabarta si dhe trajtim të mirë, ngase feja luan një rol të jashtëzakonshëm në ngjizjen e kombit.¹¹³

Ishte guximi dhe trimëria që na karakterizon si popull, ishte besa shqiptare, ky vrytit që na veçon si popull dhe e kemi kartë identiteti në arenën ndërkombëtare, aspekti fetar sepse shumica e popullit shqiptar e pranuan islamin, që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në drejtim të asaj që perandoria osmane të ketë një trajtim të veçantë ndaj shqiptarëve si komunitet.

4.3. Rrethanat dhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë

Luftërat Ballkanike u zhvilluan me një intensitet jashtëzakonisht të lartë dhe një periudhë të shpejt, dhe ambiciozët kishin filluar pushtimet e trojeve të cilave ua kishin vurë në syrin. Një forcë e madhe e serbëve marshonin në drejtim të Durrësit, një fuqi ushtarake prej 15.000 forcash ishte nisur po në këtë drejtim me 9 nëntor për ta marrë portin e këtij qyteti, vend strategjik, ekonomik dhe politik. Ndërkohë Ismail Qemali vendos që të ndërmerret diçka serioze rreth fatit të Shqipërisë. Ideja dhe plani i tij për pavarësi u shndërruan në një vendim të vështirë dhe me përgjegjësi. Kjo ishte mënyra e vetme për ta shpëtuar qenien shqiptare nga luftërat ballkanike, meqë qeveria osmane tashmë ishte dobësuar dhe i shihej fundi.

"Në disa gazeta të Bukureshtit ai (Ismail Qemali) ka dhënë intervista dhe unë i kam zbuluar këto nëpërmjet kërkimeve në arkivin e bibliotekës së Akademisë së shkencave Rumune. Ata kanë gazeta ku Ismail Qemali ka dhënë intervista dhe këto ishin të paeksploruara, dhe isha shumë kurioz t'i shikoja për ta parë se nëse ai kishte folur për pavarësi në datën 5 nëntor 1912,. Shiko, këtu flasim me data, nuk flasim me javë, me muaj jo, por flasim me ditë. Me datën 5 nëntor kur lufta ballkanike po zhvillohej, në këtë kohë Serbia kishte pushtuar krejt Vilajetin e Kosovës, qytetet kryesore, përfshirë edhe Prizrenin, dhe në datë 5 ose 6 nëntor kur ai ka dhënë intervistat në Bukuresht, ai kishte folur për autonomi, "Ne duam autonomi" – kishte thënë: Ismail Qemali¹¹⁴"

Në Taksim ndryshoi rrjedha historike e popullit shqiptarë

Qeveria osmane në fund të shekullit XIX gjendej para tronditjeve të mëdha, si nga sulmet sporadike ideologjike të shteteve evropiane përreth, me theks të veçantë Rusisë e cila tashmë atakonte qeverinë osmane dhe shtypte kokën e saj kur dëshironte, shtuar këtu dhe sulmet e ideologjive nacionale të popujve të ndryshëm brenda perandorisë.

Realisht, me ndryshimin e strukturës ligjore dhe reformave të bëra nga turqit e rinj, shqiptarët morën një freski të momentit e cila do t'i zhgënjente shpejt, e për pasojë do të shtohet trysnia mbi ta, por në anën tjetër ky siklet dhe presion mbi shqiptarët do t'i përshpejtonte angazhimet dhe përpjekjet e tyre drejt zgjidhjes së çështjes shqiptare përfundimisht.

¹¹³Ismail Qemali dhe Pavarësia e Shqipërisë, <https://www.youtube.com/watch?v=p9llgOFBmiw>

¹¹⁴<https://www.youtube.com/watch?v=Y92YoB89eVI>

Të kthehemi atje ku filluam. Në fund të vitit 1911, gjatë punimeve parlamentare të shtetit osman, u hap tema e diskutimit mbi çështjen shqiptare, konkretisht të bëmat e shtetit osman mbi shqiptarët dhe raportet e brishta me administratën në Shqipëri. Në fakt, kishte filluar shtypja osmane mbi ideologjinë e nacionalizmit shqiptar në Shqipëri, dhe kjo i shtyri që gjatë seancës të diskutohet dhe të paraqiten fakte mbi situatën aktuale atje.

Si duket, shqiptarët për ta elaboruar të vërtetën e situatës në Shqipëri, ia kishin lënë patriotit Hasan Prishtinës që të diskutojë. Pas një debati mjaftë të ashpër dhe argumentues, ai mori guximin dhe e tha një fjali e cila tronditi parlamentin osman dhe qeveritarët e saj, si dhe i dha sinjal të qartë diplomacisë shqiptare se diçka e madhe po vinte, ngase ende nuk diskutohej çështja e pavarësisë së Shqipërisë. Mes tjerash Hasan Prishtina para parlamentin osman tha: *"Në kjoftë se Qeveria nuk ndërron politikë e administrim në Shqypni, në kjoftë se shqiptarët nuk i gëzojnë të drejtat e tyre politike, asht për t'u vu oroe qi kanë me shpërthye një varg ndodhinash të përgjakshme t'idhta... Po due me thanë qi ni kioftë se "Jeunes Turcs" vijojnë në zbatim të këtij sistemi mizuer në lamë të politikës së përmbrëndshme, kam me kenë njëni, e ndoshta i pari i atyne, qi kam për ta ngreh flamurin e kryengritjes"*¹¹⁵. Kjo deklaratë i erdhi si bombë qeverisë osmane e cila edhe ashtu kishte telashet e saja me qetësimin e situatave jostabile që ishin krijuar, por në anën tjetër, tek shqiptarët kishte jehuar si fitore e madhe dhe një rrugë e cila do të shpiente drejtë fitores së vërtetë. Pas këtij momenti, Ismail Qemali e thërret Hasan Prishtinën në ndeje tek shtëpia e vet ku do ta gostisë me darkë dhe do të bisedojnë rreth situatës së krijuar. Në mbrëmje diskutimet mes Ismail Qemalit dhe Hasan Prishtinës rreth situatës së krijuar në Shqipëri vazhduan deri natën vonë dhe të dy u dakorduan për një fillim të një kryengritjeje të popullit shqiptar, por meqë gjendja ishte serioze, u propozua që të njëjtën bisedë ta bënin të nesërmen në prezencë edhe të dy personave të tjerë.

Në hotelin *"Pera Palace"* në Taksim pas gati tre orë diskutimesh nën udhëheqjen e Ismail Qemalit u vendos që: *"Për me i dhanë fund politikës tyrke në çështje të kulturës kombëtare e për me sigurue disa privilegje politike për Shqypni nuk ka tjetër mjet veçse me fillue me një kryengritje të përgjithshme"*.

Nga këtu filloi kryengritja e përgjithshme e popullit shqiptar kundër qeverisë osmane, e që si synim kishte përmirësimin e kushteve për shqiptarët dhe liri më shumë për identitetin shqiptar, gjë që u kurorëzua me pavarësinë e shteti shqiptarë shpallurmë 28 nëntor 1912.

Shqiptarët nuk dëshirojnë të ndahen nga shteti osman

Jeta shoqërore, politike dhe diplomatike pas vitit 1908 në Perandorinë Osmane ishte mjaft komplekse, kryengritje të shumta që ndodhnin në atë kohë brenda shtetit osman, e detyruan Sulltan Abylhamidin të mendojë paksa më ndryshe lidhur me kursin politik të tij. Nëse i kthehemi arsyes se pse Sulltan Abdylhamidi në vitin 1908 e riktheu kushtetutën e suprimuar të vitit 1876, do të shohim se arsyet ishin kryesisht politike. Siç dihet kryengritjen brenda shtetit osman kishin marrë hov, të ndihmuara fuqishëm dhe nga turqit e rinj, por ajo që e tronditi Sulltanin ishte fakti që tashmë shqiptarët, kryesisht shqiptarët e vilajetit të Kosovës për të cilët kishte respekt të veçantë dhe tek të cilët mbante shpresa të fuqishme mbështetjeje, kishin filluar kryengritjen.

¹¹⁵ Bardhosh Gaçe, *Ata që shpallë pavarësinë kombëtare*, Toena, Tiranë, 2012, f. 218

Kushtetuta e shtetit ofronte mundësi më të mëdha për kulturën dhe zhvillimin e gjuhës shqipe, dhe këtë rast e shfrytëzuan menjëherë shtresa intelektuale shqiptare, me theks të veçantë Ismail Qemali.

Është me rëndësi të thuhet se Ismaili Qemali tashmë si deputet në parlamentin osman, kishte bërë projekte dhe memorandume me të cilat kërkonte që në trojet shqiptare të hapeshin shkolla shqipe, biblioteka, klube dhe organizata përmes së cilave do të zhvillohej kultura shqiptare, por kurrë nuk kishte kërkuar pavarësi për Shqipërinë¹¹⁶. Ai kishte kërkuar një zhvillim kulturor apo ekonomik për shqiptarët, kurse në aspektin politik Ismail Qemali nga Sulltani kishte kërkuar autonominë.

Në bazë të dokumenteve dhe studimeve mbi gjendjen e shqiptarëve në shtetin osman, konkludohetse paria shqiptare deri në momentin e fundit apo deri në muajt e fundit të 1912 nuk kishte kërkuar pavarësinë e Shqipërisë, e tëra që ata kërkonin ishte autonomia. "Unë kam përshtypje se në Shqipëri ka pasur një keqkuptim të madh për sa i takon asaj që quhej ndarje nga Turqia. Pavarësia nuk është shfaqur deri në nëntor të 1912 në asnjë rast; flitej për autonomi autonomi kulturore, linguistike dhe gjuhësore apo një qëndrim brenda Perandorisë Osmane. Kjo ndau Abdyl Frashërin i cili ishte deputet i atëhershëm i Parlamentit Osman që kërkonte autonomi dhe krijimin e një vilajeti shqiptar me të tjerët. Për fatin tonë të keq, ata që ishin për vazhdim me Perandorinë Osmane ishin shumë herë më shumë se sa ata që ishin në rrymën autonomiste"¹¹⁷

Në dokumentet arkivore osmanee ekzistojnë dokumente mbi këtë ngjarje, të dokumentuara se shqiptarët nuk donin të ndaheshin nga shteti osman.

Dokumenti 1

"Një pjesë e madhe e trevave shqiptare që kanë mbetur nën sundimin e shtetit serb, bullgar dhe grek edhe pse vendet e tjera që ende nuk janë nën sundimin e tyre, janë në rrezik, përkunder popujve tjerë në Rumeli. Shqiptarët që i përkasin besimit islam po edhe ata të krishterë, për ta ruajtur identitetin e vet nuk duan të ndahen nga shteti osman. Në marrëveshjen e Berlinit është paraparë që reforma shqiptare është kundër shqiptarëve të besimit islam, dhe nëse zbatohen këta reforma shqiptarët e besimit islam do të mbeten pakicë në vendin e vet. Bullgaria për ta ndezë "Çështjen e Maqedonisë" dërgon çeta të armatosura në Selanik, Maqedoni dhe Kosovë. E vetmja zgjidhje ishte që të gjitha vilajetet dhe sanxhaqet shqiptare të mblidhen nën një vilajet dhe ta detyrojnë (ta angazhojnë) një vali më të dalluar, nëse nuk merren parasysh kërkesat e popullit shqiptar. Ekziston frika se shumë shpejt shteti osman do ta humbë fuqinë e vet në Rumeli. Kërkesa i shtrohet Sulltan Abdylhamidit II prej përfaqësuesve shqiptarë."¹¹⁸

(27 Gusht 1879)

Dokumenti 2

¹¹⁶ <https://www.youtube.com/watch?v=TubSgKKajb4>

¹¹⁷ <https://www.youtube.com/watch?v=Y92YoB89eVI>

¹¹⁸ Vilajeti i Kosovës në dokumentet arkivore osmane, Republika e Turqisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Shtetërore të Qeverisë së Turqisë, Departamenti i Arkivave Osmane, Stamboll 2007, f. 31

"Dokument mbi vendimet e marra në mbledhjen e themelimit të Lidhjes se Prizrenit"

Në këtë dokument theksohet themelimi i Lidhjes se Prizrenit, kundër ideve te shteteve evropiane për përjashtimin e myslimanëve nga Ballkani (Rumelia) dhe shkëputjen e trojeve shqiptare nga shteti osman. Lidhja themelohet me pjesëmarrjen e klerikëve nga sanxhaqet e Manastirit, Dibrës, Prishtinës, Shkupit, Jeni Pazarit, Prevezës, Janinës, Ergirit dhe Beratit. Takimi mbahet me 2 tetor 1879 në teqenë "Marash" të Prizrenit nën kryesimin e Myderriz Haxhi Ymer Efendiut. Në këtë takim merret vendimi që dhjetë vilajetet shqiptare të cilat planifikohej të themeloheshin nga Qeveria Osmane, të bashkohen në një vilajet

të vetëm dhe të emërohej një vali më i aftë (kompetent). Klerikët shqiptarë nuk do të pranojnë asnjë reformë para përmbushjes së kërkesave të lartpërmendura¹¹⁹."

(3 Tetor 1878)

Duke pasur parasysh se aleanca ballkanike tashmë kishte marrë hov të furishëm kundër shtetit osman, shqiptarët menduan që t'i bashkoheshin kësaj aleance, por në fakt doli që luftërat ballkanike kishin projektuar shpërbërjen e tokave shqiptare apo copëtimin e tyre ndërmjet aleatëve sllavë, Malit të Zi, Serbisë e Greqisë. Mu për këtë shqiptarët u gjetën jashtë procesit të aleancës ballkanike kundër shtetit osman.

Qenia shqiptare tashmë ishte në rrezik të dyanshëm: shteti osman po dorëzohej para fuqisë ballkanike me mbështetje ndërkombëtare, shqiptarët rrezikoheshin seriozisht nga fqinjët sllavë që e përbënin aleancën ballkanike dhe synonin t'i merrnin tokat shqiptare.

Të gjendur para një rreziku shumë të madh, elita politike dhe patriotët shqiptarë kërkonin rrugëdalje nga kjo situatë. Kështu më 28 nëntor të viti 1912 mbledhet kuvendi i delegatëve në Vlorë prej të gjithë përfaqësuesve nga trojeve shqiptare dhe shpallën pavarësinë e Shqipërisë.

Ky ishte shansi i fundit për t'i shpëtuar trojet e mbetura shqiptare.

4.4. Delegatët e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë

Shqipëria u vetëshpall e pavarur në Vlorë më 28 nëntor 1912 nga Ismail Qemali. Në shpalljen pavarësisë morën pjesë 83 delegatë nga të gjitha trevat shqiptare ndërsa 40 firmëtarët ishin ata të cilët nënshkruan aktin e Pavarësisë. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, Asambleja e Vlorës formoi qeverinë e parë të Shqipërisë së Pavarur të drejtuar nga Ismail Qemali si dhe Pleqësinë (Kuvendin).

Në vazhdim do t'i cekim disa nga figurat kryesore që firmosën shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, duke bërë një përshkrim të shkurtër të jetës dhe veprimtarisë së tyre:

Ismail Qemal bej Vlora (1844-1919)

¹¹⁹Vilajeti i Kosovës, po aty, f. 39

Ngriti flamurin në Vlorë. Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Kryetar i Qeverisë së Përkohshme, Ministër i Jashtëm, diplomat, guvernator, atdhetar. Deputet në Parlamentin Osman si dhe burrështetas i pozitave të larta në qeverinë osmane.

Deklaroi në Vlorë pavarësinë e Shqipërisë. Firmosi i pari Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë me siglën “Ismail Kemal”.

Në deklaratë shkruhej ; “Në Vlorë më 15/28 të Vjeshtës së Tretë 1328/ 1912. Pas fjalëve që tha z. Kryetari Ismail Kemal beu, me të cilat tregoi rrezikun e madh në të cilin ndodhet sot Shqipëria, të gjithë delegatët me një za venduan që Shqipëria më sot të bahet në vehte, e lirë e mosvarme”.

Ismail Qemal bej Vlora u zgjodh kryeministër i Qeverisë së Përkohshme Ndihmoi lëvizjen e armatosur të shqiptarëve në kryengritjet e përgjithshme të viteve 1910-1912. Më 22 janar 1914 jep dorëheqjen dhe pushtetin jia dorëzon Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Largohet nga Shqipëria për në Itali ku edhe vdes në rrethana të dyshimta më 24 janar 1919.

Dom Nikollë Kaçorri (1862-1917)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Klerik i lartë, atdhetar, patriot dhe veprimtar i Rilindjes Kombëtare. Mori pjesë në lëvizjen politike-kulturore-kombëtare. Gjatë kryengritjes së Kurbinut 1905-1907, hyri si ndërmjetës midis popullsisë dhe administratës osmane që të shmangte gjakderdhjen. Pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit (1908) dhe në Kongresin e Elbasanit (1909).

Përfaqësues i krahinës së Durrësit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës ku u zgjodh nënkryetar i qeverisë së përkohshme. Firmosi Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë me siglën ”Kaçorri “.

Vehbi Dibra Agolli (1867-1937)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Klerik i lartë. Veprimtar i lëvizjes kombëtare shqiptare. Mori pjesë në vitin 1909 në Kongresin e Dibrës, mbështeti alfabetin me shkronja latine të Kongresit të Manastirit.

Më 28 nëntor 1912 në krye të delegatëve të Dibrës, mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës ku u zgjodh kryetar i Pleqësisë. "Haxhi Vehbi Dibra (Agolli) merr pjesë aktive në punimet e Kuvendit Kombëtar. Ai është bashkëpunëtor i ngushtë i Ismail Qemalit. Dora e tij bashkë me dorën e Ismail Qemalit ngritën flamurin e pavarësisë në Vlorë. Goja e tij e ëmbël e bekoj për herë të parë veprën e shenjtë të ngritjes së flamurit. Flamuri ynë i shenjtë do të valojë gjithmonë pse pati fatin e lumnueshëm që të fillojë tallazin e parë me bekimin dhe uratën e një fetari të vërtetë ¹²⁰”

Ka luajtur rol të rëndësishëm në organizmin e kryengritjes shqiptare të vitit 1913 kundër pushtimit serb në zonën e Dibrës. Në vitin 1920 mbështeti përpjekjet për rimëkëmbjen dhe demokratizimin e shtetit të pavarur shqiptar.

Jorgji Karbunara – Bab Dud Karbunara (1842-1917)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Atdhetar dhe veprimtar i Rilindjes Kombëtare. Punoi shumë për hapjen e shkollave shqipe në Berat. Jorgji Karbunara ishte përfaqësues i Beratit në

¹²⁰Zani i Naltë, Prill 1937, f. 108

Kuvendin Kombëtar të Vlorës, ku firmosi Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë me siglën ” J. Karbunara “. Në këtë Kuvend, ai u zgjodh anëtar i Pleqësisë.

Elmas Boce (1850-1925)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Mori pjesë në organizimin e degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në qytetin e Gjirokastrës në vitin 1880.

Elmaz Boce, ndihmoi pa kursyer hapjen e shkollës shqipe të Gjirokastrës “Liria”. Në nëntor të vitit 1912 u zgjodh delegat i Gjirokastrës në Kuvendin e Vlorës, ku firmosi Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë me siglën ”Elmas Boce ”

Qazim Kokoshi (1882-1945)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Veprimtar për përhapjen e gjuhës shqipe, patriot, njeri me bindje dhe pikëpamje demokrate. Zgjidhet delegat i Vlorës në Kuvendin e Gërçes në vitin 1911. Merr pjesë në kuvendin e Vlorës në nëntor 1912, ku firmosi Aktin e Pavarësisë me siglën ”Qazim Kokoshi”.

Në vitin 1921, zgjidhet deputet i qarkut të Vlorës në Këshillin Kombëtar. Rregjimi komunist e arreston dhe burgos. I izoluar në hetuesinë e Vlorës, vdes nga torturat.

Jani Minga (1872-1947)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Veprimtar i shkollës shqipe, i Rilindjes Kombëtare dhe i lëvizjes demokratike 1920-1924.

Ishte ndër nismëtarët e hapjes së klubit patriotik ”Labëria ” dhe të shkollës së parë shqipe në Vlorë (1908). Në nëntor të vitit 1912 u zgjodh delegat i Gjirokastrës në Kuvendin e Vlorës, ku firmosi Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë me siglën ”J. Minga”.

Rexhep Mitrovica (1888-1960)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Veprimtar i lëvizjes kombëtare, intelektual, deputet, ministër, kryeministër. Mori pjesë si delegat i Pejës në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe ishte njëri nga nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë. ”Në Vlorë ai ndihmoi në organizimin e shtetit të ri shqiptar dhe mori pjesë në protestat e mitingjeve kundër shovenistëve serb dhe grekë në jug e veri të vendit”¹²¹

Një nga themeluesit e Partisë Kombëtare (1914), anëtar i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. Zgjidhet senator i Kosovës në Këshillin Kombëtar të Lushnjës.

Dhimitër Tutulani (1875-1937)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Veprimtar i lëvizjes kombëtare.

Në nëntor të vitit 1912, zgjidhet delegat i Beratit në Kuvendin historik të Vlorës, ku nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë, me siglën “Dh. Tout.”. Në vitin 1918 ishte delegat në Kongresin e Durrësit dhe në vitin 1920 në Kongresin e Lushnjës. Në vitin 1925 kreu detyrën e kryetarit të Bashkisë së Beratit.

Abas Dilaver (Çelkupa) (1850 – 1926)

¹²¹ Gaçe, po aty, f. 132

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Veprimtar i lëvizjes kombëtare.

Gjatë viteve 1905-1907 u lidh dhe bashkëpunoi me atdhetarët e njohur të asaj kohe si Dom Nikoll Kaçorri etj. Priti në Durrës Ismail Qemalin e më pas, bashkë me delegatët që e shoqëronin atë, mori pjesë në mbledhjen e parë Kuvendit të Vlorës. Delegat i Durrësit, Deklaratën e Pavarësisë, e firmosi me siglën “Abas Dilaver”.

Shefqet Dajiu (1882-1946)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Veprimtar i përhapjes së gjuhës shqipe dhe i lëvizjes kombëtare.

Në nëntor të vitit 1912, zgjidhet si përfaqësues i Elbasanit në Kuvendin historik të Vlorës për shpalljen e Pavarësisë Kombëtare. Firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Shefqet Daji”. Në vitet 1920-1923 është deputet i Elbasanit në parlamentin shqiptar. Shefqet Dajiu arrestohet dhe burgoset në vitin 1945. Vdes në burg në vitin 1946.

Xhelal Koprencka (1876-1919)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Nismëtar për hapjen e shkollave shqipe në vitin 1908 në Skrapar, veprimtar i lëvizjes kombëtare për pavarësi

Zgjidhet delegat i Skraparit në Kuvendin e Vlorës. Deklaratën e Pavarësisë e firmosi me siglën “Xhelal Ko. Zgjidhet anëtar i Pleqësisë.

Hajredin Cakrani (1860-1940)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë.

Në vitet 1908-1909, bashkëpunoi ngushtë me klubet atdhetare “Labëria ” të Vlorës dhe të Filatit. U zgjodh delegat i Mallakastrës në Kuvendin historik të Vlorës në nëntor të vitit 1912, ku firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Hajredin Cakrani”. Pjesëmarrës në luftën e Vlorës kundër pushtuesve italianë.

Iljaz Vrioni (1882-1932)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë.

Në nëntor të vitit 1912 zgjidhet delegat i Beratit në Kuvendin historik të Vlorës, ku nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë, me siglën “Iljas Vrijon”. Në vitin 1920, zgjidhet delegat i Beratit në punimet e Kongresit të Lushnjës. Katër herë Kryeministër i Shqipërisë dhe disa herë Ministër i Jashtëm dhe Ministër i Plotfuqishëm i Shtetit Shqiptar në Paris.

Murad Toptani (1867-1918)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Poet, publicist.

Mori pjesë në Kuvendin historik të Vlorës në nëntor 1912 si delegat i Tiranës dhe firmosi Deklaratën e Pavarësisë me siglën “Murad Toptani”. Pas rënies së qeverisë së Vlorës, Esat Pashë Toptani (kushëri i tij) i dogji shtëpinë dhe një pjesë të madhe të pasurisë së tij që ndodhej brenda saj si libra, korrespondenca, antikuarë.

Luigj Gurakuqi (1879-1925)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Veprimtar i lëvizjes kombëtare, ministër, deputet, gjuhëtar, poet, publicist.

Pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit (1908), ku u zgjodh edhe anëtar komisioni për njehsimin e alfabetit. Pjesëmarrës në kryengritjen e malësorëve të Mbishkodrës dhe bashkë hartues me I. Qemalin i Memorandumit të Greçës. Gjatë vitit 1912, ishte ndër organizatorët e kryengritjes së përgjithshme. Në Kuvendin e Vlorës për shpalljen e pavarësisë, si përfaqësues i Shkodrës, firmosi Deklaratën e Pavarësisë nën siglën "Luz Gurakuqi".

Ministër i Arsimit në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës. Anëtar i delegacionit në Konferencën e Paqes në Paris. Deputet i Shkodrës në Këshillin Kombëtar dhe përsëri përfaqësues i Shkodrës në Kuvendin Kushtetues në vitin 1924. Ministër i Financave në qeverinë e Nolit. U vra në Bari në 2 mars 1925. "Humbja e Gurakuqit asht një humbje shumë e madhe, një humbje e paharrueshme jo vetëm për Shqipërinë e pavarur, por edhe për ata shqiptarë që patën fatin e zi të mbesin jashtë kufirit të Shqipërisë së sotme"¹²²

Spiridon Ilo (1876-1950)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Patriot, atdhetar.

Shoqëron Ismail Qemalin në udhëtimin Trieste-Durrës-Vlorë. Merr pjesë në Kuvendin historik të Vlorës në nëntor 1912, ku firmosi Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë me siglën "Spiro T. Ilo". Në vitin 1914, përfshihet në çetën e Themistokli Gërmenjit në luftimet kundër shovinistëve grekë.

Thanas Floqi (1884-1945)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Jurist, veprimtar i lëvizjes kombëtare, publicist, gjuhëtar, botues, kompozitor, përkthyes.

Mori pjesë në Kuvendin historik të Vlorës në nëntor 1912, ku firmosi Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë me siglën "Thanas V. Floqi". Më pas punoi si jurist në administratën shtetërore në Vlorë.

Lef Nosi (1873-1946)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Veprimtar i lëvizjes kombëtare, albanolog, studiues, deputet, ministër, arkivist.

Në nëntor 1912 ishte delegat i Elbasanit në Kuvendin e Vlorës, ku firmosi Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë me siglën "Lef Nosi". Në qeverinë e Ismail Qemalit, Lef Nosi caktohet në detyrën e ministrit. Anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris. Në vitin 1945 u burgos dhe u dënua me vdekje. U pushkatua në vitin 1946.

Nuri Sojliu (1870-1940)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë.

Mbështeti Kongresin e Elbasanit dhe atë Manastirit, ku përkrahu alfabetin latin të gjuhës shqipe. Në nëntor të vitit 1912, u zgjodh delegat i Strugës në Kuvendin e Vlorës, ku firmosi Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë me siglën "Nuri". Nuri Sojliu ka mbështetur edhe lëvizjet politike me frymë demokratike të viteve '20.

¹²²Ajet Haxhiu, *Hasan Prishtina*, Tiranë, 1981, f. 189

Ferit Vokopola (1887-1967)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Teolog, ekonomist, poet, publicist, ministër, deputet.

Në nëntor të vitit 1912, u zgjodh delegat i Lushnjes në Kuvendin e Vlorës, ku firmosi Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë me siglën "M. Ferit Vokopola". Ferid Vokopola ishte përfaqësues i Beratit, në Parlamentin shqiptar nga viti 1923-1939. Ministër i Bujqësisë në kabinetin e Iljaz Vrionit (1927-1928).

Ymer Deliallisi (1873-1944)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë.

Në nëntor të vitit 1912, u zgjodh delegat i Shijakut në Kuvendin e Vlorës, ku firmosi Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë me siglën "Ymer". Në vitin 1920, përfaqëson nënprefekturën e Shijakut në Kongresin e Lushnjes, ku edhe zgjidhet senator.

Xhemal Deliallisi (1880-1941)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë.

Në nëntor të vitit 1912, u zgjodh delegat i Shijakut në Kuvendin e Vlorës, ku firmosi Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë me siglën "Xhemmalyddin bej". Ngarkohet me detyra në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës dhe më pas në administratën e Princ Vedit.

Mustafa Merlika Kruja (1887-1958)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë. Deputet, ministër, Kryeministër, albanolog

Si delegat i Krujës në Kuvendin Kombëtar të Vlorës më 28 nëntor 1912, firmosi Aktin e Pavarësisë kombëtare, me siglën "Mustafa Asim Kruja" ku u zgjodh dhe anëtar i Pleqësisë. U caktua nënprefekt në Vlorë dhe më pas sekretar i parë i Qeverisë së I. Qemalit.

Më 1919 ishte sekretar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris. Ishte deputet i Kosovës në zgjedhjet e para parlamentare të vitit 1921. Pas ardhjes së komunizmit u detyrua të arratisesh. Mustafa Kruja vdiq në SHBA më 27 dhjetor 1958, në moshën 71-vjeçare.

Abdi Toptani (1864-1942)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, ministër.

Në vitin 1902 organizoi kryengritjen e armatosur të malësorëve të Shëngjergjit e të Shupalit kundër dhunës së administratës osmane.

Në Kuvendin e Vlorës ai firmosi Aktin e Pavarësisë me siglën "Abdi". U zgjodh ministër i Financave në Qeverinë e parë shqiptare.

Veli Harçi (1850-1914)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, intelektual.

Veli Harçi ishte një intelektual i formuar. Veprimtar i klubit patriotik të qytetit, ai përfaqësoi Gjirokastrën në Kuvendin e Vlorës dhe firmosi Aktin e Pavarësisë me siglën "Veli Harçi".

Nebi Sefa (1861-1942)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, atdhetar.

Mori pjesë në kryengritjen e përgjithshme të viteve 1911 dhe 1912. Në nëntor të atij viti u zgjodh delegat i Lushnjes për në Kuvendin e Vlorës. Ku nënshkroi Aktin e Pavarësisë me siglën “Nebi Sefa Lushja”. Në vitet ’20 përkrahu kursin politik të ndjekur prej forcave fannoliane.

Mit’hat Frashëri (1880-1949)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, intelektual, deputet, patriot, ministër

Mori pjesë në Kongresin e Manastirit, më 1908 ku u zgjodh kryetar i Kongresit dhe nënkryetar i Komisionit të hartimit të alfabetit. Në Kuvendin e Vlorës, Frashëri ishte delegat i Elbasanit dhe firmosi Aktin e Pavarësisë me siglën “Mid’hat Frashëri”. Në qeverinë e Ismail Qemalit zgjidhet ministër i Punëve të Përgjithshme. Në janar 1923 fillon detyrën e ministrit Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Athinë, deri në dhjetor 1925.

Mit’hati vëmendje të veçantë iu kushtoi botimeve, publikimeve të ndryshme me karakter patriotik. Nga dora e tij u hapën shumë biblioteka dhe u botuan shumë revista. “Në vitin 1908, bëhet themelues dhe drejtuesi i gazetës “Liria” të Selanikut e cila luajti një rol të madh në pasqyrimin e jetës politike të vendit tonë. Po këtë vit ishte njëri ndër organizatorët e Kongresit të Manastirit, në komisionin e hartimit të alfabetit të gjuhës shqipe¹²³”

Më 1941 është një nga themeluesit e Organizatës Nacionaliste – Balli Kombëtar. U detyrua në nëntor 1944 të largohet nga Shqipëria dhe të vendoset në Itali. Nuk u pajtua kurrë me komunizmin. Komunistët e detyruan të birin e Mit’hat Frashërit, të ikte nga Shqipëria. Vdiq në Nju Jork, SHBA, më 3 tetor 1949.

Zihni Abas Kanina Hamzaraj (1885-1957)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, atdhetar, ministër.

Mori pjesë në kryengritjen e përgjithshme të vitit 1911. Në Kuvendin e Vlorës, si delegat i Vlorës, firmosi në Aktin e Pavarësisë me siglën “Zihni Abbas Kanina”. U zgjodh drejtor i përgjithshëm në ministrinë e Punëve të Jashtme. Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, Kanina u bë pjesë e Ballit Kombëtar, përkrah Mit’hat Frashërit. Në vitin 1951 u arrestua dhe u burgos, ku qëndroi derisa vdiq, më 1957.

Qemal Karaosmani Elbasani (1875-1949)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, patriot, deputet.

Në nëntor 1912 u zgjodh delegat i Elbasanit në kuvendin e Vlorës dhe u caktua të shoqëronte Ismail Qemalin nga Durrësi për në Vlorë. Firmosi Aktin e Pavarësisë kombëtare, me siglën “Qemal Elbasani”. Mbështeti qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjes dhe për disa vite ishte asamblist.

Ai u persekutua nga regjimi komunist.

Sali Gjuka (1876-1925)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, atdhetar.

¹²³ Gaçe, po aty, f. 75

Mori pjesë në kryengritjen e përgjithshme të viteve 1910-1912.

Si përfaqësues nga Kosova dhe delegat i Pejës, Gjakovës, Plavës e Gucisë, mori pjesë në shpalljen e pavarësisë kombëtare dhe firmosi Aktin me siglën “Salih Gjuka”. U zgjodh këshilltar i Pleqësisë. Në janar 1913 filloi punën si drejtor i arsimit për qarkun e Beratit.

Dhimitër Berati (1888-1970)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, diplomat, ministër

Firmos Aktin e Pavarësisë së 28 nëntorit 1912, nën siglën “D. Beratti”, si delegat i kolonisë shqiptare të Bukureshtit. Berati u emërua sekretar i kryetarit të Qeverisë, anëtar i Pleqësisë si dhe u caktua drejtor i përgjithshëm në gazetën e qeverisë së Vlorës. Në Konferencën e Paqes më 1919 ishte delegat i shqiptarëve të Bukureshtit.

Dhimitër Mborja Emanoil (1884-1945)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë.

Më 28 nëntor 1912, firmos Aktin e Pavarësisë me siglën “Dh. Emmanuel” në emër të kolonisë së Bukureshtit. Në shkurt 1915 zgjidhet këshilltar pranë shoqërisë së “Komunitetit Ortodoks Shqiptar të Bukureshtit”. Më 1924 mbështet qeverinë e Nolit. Ishte kundër rregjimit komunist.

Dimitër Zografi (1878-1945)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, atdhetar.

U zgjodh delegat i kolonisë shqiptare të Bukureshtit për të marrë pjesë në Shpalljen e Pavarësisë. Më 28 nëntor 1912 firmosi vendimin e Pavarësisë me siglën “Dimitri Zografi”. Anëtar i Pleqësisë. Kundërshtoi vendimet e padrejta të Konferencës së Parisit në kurriz të popullit shqiptar dhe firmosi protesta drejtuar kryesisë së saj në qershor 1919.

Pandeli Cale (1879-1923)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, atdhetar, ministër, deputet.

Në kryengritjen e përgjithshme të vitit 1910 – 1912 drejtoi çetat e zonës së Korçës. Mori pjesë në mbledhjen e Bukureshtit të 5 nëntorit 1912 dhe e shoqëroi Ismail Qemalin për në Shqipëri.

Me 28 nëntor 1912, si delegat i Korçës, firmos Aktin e Pavarësisë me siglën "Pandeli Cale". Zgjidhet anëtar i qeverisë së parë shqiptare. Merr pjesë aktive në lëvizjen patriotike që çoi në Kongresin e Lushnjës më 1920. Po atë vit ishte Prefekt i Korçës, ndërsa në shkurt 1921 deputet në të parin parlament shqiptar.

Qemal Mullaj (1881-1966)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, atdhetar, deputet

Si delegat i Lushnjës, në nëntor 1912 mori pjesë në Kuvendin historik të Vlorës dhe firmosi Aktin e shpalljes së Pavarësisë me siglën “Qem. Mullaj”. Pas rënies së qeverisë së Vlorës dhe me nisjen e Luftës së Parë Botërore u largua nga Shqipëria. U kthye në atdhe rreth vitit 1920, për t’u rimarrë përsëri me politikë. Deputet në parlamentin e parë shqiptar.

Bedri Pejani (1885-1946)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë.

Delegat në Kongresin e Dytë të Manastirit (1910) dhe sekretar i Komitetit të Kosovës (1918-1924).

Në nëntor 1912, mori pjesë si përfaqësues i Plavës, Gucisë, Gjakovës dhe Pejës në mbledhjen e Vlorës dhe firmosi Aktin e Pavarësisë me siglën “Bedri Pejani”. Në vitin 1943 ishte nga nismëtarët për krijimin e “Lidhjes së Dytë të Prizrenit” dhe deri në vitin 1944 kryetar i saj. Pas luftës u arrestua në Shqipëri. Vdiq sapo doli nga burgu, në vitin 1946.

Qemal Mullaj (1881-1966)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, atdhetar, deputet

Si delegat i Lushnjës, në nëntor 1912 mori pjesë në Kuvendin historik të Vlorës dhe firmosi Aktin e shpalljes së Pavarësisë me siglën “Qem. Mullaj”. Pas rënies së qeverisë së Vlorës dhe me nisjen e Luftës së Parë Botërore u largua nga Shqipëria. U kthye në atdhe rreth vitit 1920, për t’u rimarrë përsëri me politikë. Deputet në parlamentin e parë shqiptar.

Dr. Myrteza Ali Struga (Dibra) (1876-1937)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, mjek, patriot

Në nëntor të vitit 1912, Dr. Myrteza Ali Struga, së bashku me Zyhdi Ohrin dhe Nuri Sojliun u zgjodhën delegatë të Ohrit e Strugës për në Kuvendin e Vlorës, ku firmosi Aktin e Pavarësisë me siglën “Dr. H. Myrteza Aliu”. Përsëri si përfaqësues i Ohrit e Strugës ishte delegat në Kongresin e Lushnjës më 1920.

Aristidh Ruci (1875-1950)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, atdhetar.

Merr pjesë në kryengritjen e përgjithshme më 1911. Ishte delegat i Vlorës në Kuvendin që shpalli pavarësinë dhe firmosi Aktin me siglën “A. Ruci”. U zgjodh anëtar i kryesisë së Bankës Kombëtare Shqiptare më 1937.

Zyhdi Ohri (1872-1938)

Firmëtar i Aktit të Pavarësisë, atdhetar, senator.

Në vitet 1898-1900 u përfshi në veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare të Pejës. Në nëntor 1912, i zgjedhur nga Ohri si delegat, mori pjesë në Kuvendin e Vlorës dhe firmosi Aktin e Pavarësisë me siglën “Zuhdi Ohri”. Ishte pjesë e Senatit të dalë nga qeveria e Ismail Qemalit. Në janar 1920 mori pjesë në Kongresin e Lushnjës.

Sulejman Delvina (1884-1932)

Ministër, Kryeministër.

Kryeministër i qeverisë i dalë nga Kongresi i Lushnjës. Përfaqësues në Konferencën e Paqes në Paris. Mori pjesë në Revolucionin e Qershorit 1924 dhe në qeverinë e kryesuar nga Fan Noli u emërua ministër i Punëve të Jashtme për periudhën nga 16 qershor 1924 – 23 dhjetor 1924. Pas dështimit të këtij revolucioni, Delvina u largua nga Shqipëria. Më vonë i

sëmure u kthye në Shqipëri dhe vdiq në Vlorë në vitin 1933. Në korrik të vitit 1911 udhëhoqi manifestimin e studentëve shqiptarë në Stamboll për të mbështetur alfabetin dhe kërkesat shqiptare.

Menjëherë pas shpalljes së shtetit të pavarur shqiptar, Ismail Qemali filloi përgatitjet intensive për organizimin administrativ të shtetit, zgjodhi burrat më të spikatur të kombit mbi të cilët do ta mbështeste qeverisjen e shtetit të ri. Dhe kështu më 4 dhjetorë 1912 kuvendi zgjodhi kabinetin qeveritar me dhjetë ministri në këtë përbërje :

Ismail Qemali – Kryetar i Qeverisë dhe Ministër i punëve të Jashtme,

Dom Nikollë Kaçorri – Nënkryetar

Luigj Gurakuqi – Ministër i Arsimit

Myfti Bej Libohova – Ministër i Punëve të Brendshme

Abdi Bej Toptani – Ministër i Financave

Mehmet Pashë Dërralla – Ministër i Luftës

Petro Poga – Ministër i Drejtësisë

Mit'hat Frashëri – Ministër i Punëve Botërore

Pandeli Cale – Ministër i Drejtësisë

Lef Nosi – Ministër i Postë -Telegrafëve¹²⁴

¹²⁴ Gaçe, po aty, f. 9

Në Vlonë më 15/28 të Gjeshtës së tretë 1329/1912.

Pas fjalëve që tha L. Kryetari Binal Kamel. Beu, me të cilat tregoi vendimin e madh në të cilin ndodhet sot Shqipëria të gjithë delegatet me një të venduan që Shqipëria me sot të bëhet në vetë, e lirë e e mosvarme.

Imamkhan Haxhaxhi
J. Karabucana
Umar boga
vel. kare,
i. Kruje
Abdi Abas Dilever
Mehmet Raci
Cefcet L. K.
Zihni Abas Kanina
X. led 100
Hajredin
Cakhar
Aemal
elbasani
Elhasbyon
Salih Gjeka
Boratty Hammon
Dimitri Zograf
Murat Topani
Pandis Caka
Luz Gurakuz
Boru Refoni
Ipiriot. Flo
Thana, V. P. Lag,
Lef Nozi
D. H. Murtaz
Murtaza
M. Ter A. 2000000

¹²⁵ Studjuesi dhe historiani Eqrem kryeziu thotë se kjo është vendim (procesverbal) mbi shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë më 28 nëntor 1912, dhe jo deklarata e pavarësisë siç edhe quhet. *Pas fjalimit që tha z. kryetar, Ismail Kemal beu, me të cilat tregoi rrezikun e math në të cilin ndodhet sot Shqipëria, të gjithë delegatët me një zë venduan, që Shqipëria më sot të bëhet në vehte, e lirë e mosvarme.* Zenelaj, po aty, f. 445

Në fakt, zbulimet e fundit në historiografinë shqiptare na paraqesin dy shpallje të pavarësisë së Shqipërisë, e para në Durrës¹²⁶ që ka të ngjarë të jetë 26, 27 nëntor dhe e dyta në Vlorë më 28 nëntor.

Është folur që më herët për një deklaratë të pavarësisë së Shqipërisë në Durrës, por asnjëherë nuk është ofruar diçka serioze sa i përket kësaj ngjarjeje.

Një hulumtim serioz i bërë në arkivat e Austro-Hungarisë nga studiuesi dhe historiani, Eqrem Zenelaj në Vjenë të Austrisë, dokumentohet se ekziston dhe një deklaratë e tillë në këto arkiva.

Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë e shpallur në Durrës gjendej në gjuhën osmane dhe ishte firmosur nga 20 delegatët që kishin qenë edhe bashkudhëtarët e Ismail Qemalit.

Teksti i Përkthyer nga origjinali:

"Konsullatës së Shtetit të ndershëm të Austro-Hungarisë në Durrës.

Shpallje

Duke mos iu nënshtruar asnjë shteti, tani u bë Pavarësia. Andaj në këtë cilësi ju lutemi me përgjërëm që ta mbronë sovranitetin tonë që të mos nëpërkëmbet nga qeveria e Serbisë.

Më 26/27 nëntor të vitit 1912.


Përfaqësuesi i popullsisë së Durrësit (pasojnë nënshkrimit):

Myderrizi i Durrësit - Jusufi, nga ulema Hysejn (Tartari), nga ulema Aliu, myderriz Jusufi, nga ulema (Muhamed Rexhepi), nga paria Myrteza (?), nga paria Hamid Toptani, nga paria Ismail, nga paria (Mahmud) Shefkiu, nga paria (?), nga paria Muhamedi, nga paria Musa Qazimi, nga paria Ismail, nga paria Hysejn Hakiu, Kryeplaku i komunitetit katolik Filip Sereqi, nga paria Abdullahu, nga paria Kristaq Rama, nga paria Mehmed Akifi, nga paria Hasan Bakin ose Bakifi, nga paria Hysejn Bala, nga paria Bahtijar Dervishi.¹²⁷"

¹²⁶Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë në Durrës gjendet në Arkivin e Monarkisë së Austro-Hungarisë, në Arkivin e Shtetit: HHStA.Wien.P.A.Türkei, Liasse 45.Kartoni Nr.417/Fol 9/10

¹²⁷ Eqrem Zenelaj, Diplomacia e Ismail Kemal Bej Vlorës, rivalitetet e brendshme në Shqipëri dhe rruga e Pavarësisë 1912-1923, f. 327

Deklarata e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në Durrës¹²⁸ më 26-27 Nëntor



¹²⁸ Deklarata e Durrësit është e shkruar në osmanisht, dhe ka pak rreshta dhe në fund të tekstit janë vënë nënshkrimet e pjesëmarrësve.

Sipas prof. Zenelajt, kjo deklaratë është e vetmja Deklaratë e Pavarësisë së Shqipërisë që është dërguar jashtë Shqipërisë dhe e vetmja Deklaratë e Pavarësisë së Shqipërisë që ruhet qe 100 vjet në Arkivin e Monarkisë e Austro-Hungarisë me titullin Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë. Zenelaj, po aty, f. 321

Dhe kjo deklaratë i është dërguar konsullit Austro-Hungarez në Durrës, Rudnay, Athinës. Gazetat vjeneze, greke të kohës kanë shkruar mbi këtë deklaratë që është shpallë në Durrës

Pra, sipas dokumenteve arkivore ka të gjarë që Pavarësia e Shqipërisë fillimisht të jetë shpallur në Durrës dhe kjo nuk nënkupton që ishte shpallje lokale e pavarësisë, por shpallje që përfshinte tërë Shqipërinë.

Nga arkivisti i qeverisë së Ismail Qemalit, Lef Nosi, na paraqitet kjo dëshmi e radhës:

"Proklamim i Independencës Shqiptare

Nr. 13300, Fjalë 95 O.T

Durrës, 13 Vjeshta e Tretë 1328-1912

7.30 ora e ditës

Popullit të ndershëm të qyteteve:

Elbasan, Berat, Janinë , Delvinë, Gjinokastër, Lushnje, Korçë, Starovë, Vlonë, Permet.

Ju apim lajmen e gëzushme, se me hirin e të Naltit Përëndië , ndashti shpallëm independencën, n'emën të kombësiës tonë të shenjtë e të gjithë Shqipniës.

Nga memorandumët që u shkruan, njani i u-dha konsullit t'Austriës, tjetri konsullit të Francës, dhe i treti po ati t'Austriës, si përfaqësues të Shtetit Italian.

Ju bajmë me ditë se nesër do të bahet ceremonia e zakonshme.

Myderriz Isuf Ramë, Myderris Abdyl Qerim Kurti, Myderris Hysein Mulla-Alushi, Myderris Ali Kuli, Myderris Hafëz Jusuf Gjoni, Ismail Benja, Mahmut Benja, Hysein Dakoli, Hasan Tartari, Ismail Usta Sula, Rexhep Abdurrahman Berberi, Hysein Peni, Filip Sereqi, kryeplak i katolikve, Aqif Çelkupa, Bahtiar Dervishi, Aleks Duka, Kristaq Rama, Sotir Veveçka, Hamza Tahir Himi, Muhamet Qepaxhiu, Ymer Lutfi Mallkuçi, Musa Milaqi"¹²⁹

Kjo deklaratë u firmos nga udhëheqësit e popullit të Durrësit, ulemaja (hoxhallarët, dijetarët, islamë).

"Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë e shpallur në Durrës është një dokument historik, është një dokument kombëtar dhe ka karakter të një dokumenti ndërkombëtar. Është e vetmja Deklaratë e Pavarësisë së Shqipërisë që është dërguar jashtë Shqipërisë dhe e vetmja Deklaratë e Pavarësisë së Shqipërisë që ruhet që 100 vjet në Arkivat e Monarkisë së Austro-

¹²⁹Lef Nosi: *Dokumente historike përr t'i shërbyer historisë sonë kombëtare*, e boton Lef Nosi, Nji herë në muejt, Viti I-rë, Mars 1924, Nr. 3, Shtypshkronja "Elbasani, Elbasan , f. 72

Hungarisë me titull Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë .¹³⁰

Kjo deklaratë së pavarësisë përkon me datën 27 nëntor 1912 dhe shpallja ndodhi me rastin e udhëtimit të Ismail Qemalit nga Triesta drejtë Durrësit.

Mendohet se Ismail Qemali kishte dy opsione për shpalljen e pavarësisë dhe jo rastësisht i koncentruar në këto dy qytete, por me faktin se përshpejtimi i shpalljes së shtetit të pavarur ishte imediate dhe do ta ndërpriste urgjentisht aneksimin sllav të tokave shqiptare, ku në këtë drejtim shihte një rrezik serioz për Durrësin sepse forcat serbe afroheshin drejtë Adriatikut dhe duhej sa më shpejtë të shpallej pavarësia në Durrës ose eventualisht në Vlorë. Me këtë rast përkon edhe kërkesa e Ismail Qemalit nga kontin Berchtold që t'ia mundësojë një anije për në Durrës para se të arrij ushtria serbe¹³¹.

4.5. Qëndrimi i diplomacisë osmane pas shpalljes së shtetit të pavarur shqiptar

Me pavarësinë e Shqipërisë u shtuan tensionet në Ballkan, apetitet sllave qëndronin mbi mundësitë e tyre të realizimit, por këtë situatë nuk mund ta kapërdinte shteti osman i cili jo vetëm që kishte kontribuar në formimin e shtetit shqiptar, por synonte që një pavarësi e shpallur mos të cenohet, pasi që kushti për t'u tërhequr nga Ballkani forcat osmane, fillimisht kishte qenë formimi i një shteti shqiptar brenda kufijve osmanë.¹³²

Diplomacia osmane, vë në lëvizje aktivitetet e veta në dobi të shqiptarëve pikërisht kur shqiptarët kishin nevojë më së shumti për aleat, dhe këtë e bënte për ta mbrojtur pavarësinë e Shqipërisë që ishte në rrezik. Atëbotë rrezikohej Shkodra nga forcat e Malit të Zi, Durrësi nga serbët, Greqia gjithashtu kishte sytë nga dherat shqiptare. Ndonëse tashmë trojet shqiptare ishin të humbura për Perandorinë Osmane dhe kthimi i tyre ishte i pamundur, përsëri në mbrojtje të Shkodrës u shfaq solidarizimi dhe fryma miqësore osmane në favor të politikës shqiptare.

Nëse shohim drejt ngjatjen dhe situatën e krijuar në këto momente, vërejmë se shteti osman nuk i kishte mbetur gjë në Ballkan, por e gjitha që ata e bënë për shqiptarët, për mbrojtjen e Shkodrës, me sa duket ishte rezultat i bashkëjetesës qindrvjeçare dhe kontributit të dhënë të shqiptarëve në Perandorinë Osmane, siç thotë Eqrem Bej Vlora: "Kur u nënshkrua më 3 dhjetor të vitit 1912 armëpushimi midis Bullgarisë dhe Perandorisë Osmane, edhe malazezët para Shkodrës i ndërprejnë menjëherë veprimet luftarake dhe njoftuan komandantin ushtarak osman se ata ishin gati t'i bashkoheshin këtij armëpushimi në rast se garnizoni

¹³⁰Eqrem Zenelaj, po aty, f. 321

¹³¹Ismail Qemali, *Kujtimet*, Tiranë, 2009, f. 416

¹³² <https://www.youtube.com/watch?v=p3Pu1vmNVU0>

osmano-shqiptar tërhiqej nga Shkodra, meqë mbrojtja e qytetit tani nuk kishte më kuptim ushtarak. Hasan Riza Pasha u përgjigj kështu: Shkodra i përket Shqipërisë dhe popullit shqiptar, i cili nuk është i gatshëm që me dorën e vet të hedhë në zverk zgjedhën sllave. Kurse trupat osmane do të qëndrojnë besnikërisht dhe miqësisht në anën e shqiptarëve, si shërbim të fundit për bashkëpunimin e gjatë në qindra vjet¹³³."

Hasan Riza ishte Vali i Shkodrës, nëpunës i shtetit osman i cili nuk i kishte për qejf politikat e turqve të rinj, por që interesi i tij për mbrojtje të qenësisë shqiptare në Shkodër ishte i pasqyruar. Ai me mbi 28.000 ushtarë osmanë luftoi heroikisht në mbrojtje të Shkodrës, sa që një dëshmitar i asaj lufte shprehet: "Turqit ishin të gatshëm për të bërë gjithçka veçse për ta shpëtuar Shkodrën¹³⁴".

"Me 2 dhjetor 1912, Ismail Qemali i telegrafoi Vezirit të Madh lajmin e formimit të qeverisë provizore. Ky vendim motivohej me izolimin e plotë të Shqipërisë dhe me pazotësinë e Perandorisë Osmane për ta mbrojtur atë nga armiqtë e jashtëm. Ai e siguroi Mehmet Kemail Pashën (Kryeministër i atëhershëm i Perandorisë Osmane) se Shqipëria do të përpiqej që t'i ruante lidhjet fetare me Kalifatin dhe të zgjidhte një organizim politik i cili do të përshtatej sa më mirë me interesat e Perandorisë Osmane. Në këtë telegram, Ismail Qemali, e kishte evituar me kujdes fjalën pavarësi¹³⁵".

Si një diplomat me përvojë dhe njohës i mirë i shtetit osman, politika e tij ishte që mos i kundërshtojë interesat e shtetit osman, por edhe nuk donte që shteti osman ta pengonte Shqipërinë në mekanizma ndërkombëtare.

Njohja e pavarësisë së Shqipërisë nga fuqitë e mëdha nën sovranitetin e Sulltanit, pastaj dhe nga konferenca e Londrës ishte një nga arsyet se pse forcat osmane nuk i kishin lëshuar ende trojet shqiptare, gjegjësisht Shqipërinë, dhe mbronin me ngulm territoret e sajnga malazezët dhe serbët, gjë që kjo shkaktoi revoltë të madhe tek forcat sllave sepse u shuhej mundësia për t'u zgjerruar në trojet shqiptare.

"Marrëdhëniet shqiptaro-serbe u ashpërsuan edhe më tepër, kur Serbia pa të drejtë u bëri presion Fuqive të Mëdha, përmes Rusisë, që t'i detyronte të shfuqizonin vendimin e 17 dhjetorit 1913, pasi Shqipëria njihej në kufijtë e saj etnik nën sovranitetin e Sulltanit. Me rastin e njohjes së Shqipërisë Etnike nga Fuqitë e Mëdha, Kryetari Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemali, do t'i shprehë falënderime delegacionit shqiptar në Londër, në krye me Rasih Dinon: "Urime për liri e Pavarësi të Shqipërisë¹³⁶".

Me vendimin e 17 dhjetorit të 1912 të ambasadorëve në Londër, ishin të kënaqur të gjithë shqiptarët. Më në fund paria udhëheqëse që kishte marrë përsipër ta realizonte një shtet të pavarur shpëtar po triumfonte. E mira e gjithë këtij vendimi ishte ngase, Shqipëria si shtet i

¹³³Eqrem bej Vlora, Baronesha Marie Amelie von Godin, *Ndihmesë për historinë e sundimit turk në Shqipëri*, vëll. II, Tiranë, 2010, f. 236

¹³⁴Hasan Bello, *Marrëdhëniet shqiptaro-turke 1912-1939*, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, Tiranë 2015, f. 20

¹³⁵Hasan Bello, po aty, f. 24

¹³⁶Vebi Xhemali, *Konferenca e Londrës me dy vendime për Shqipërinë-Sovrane dhe e robëruar*, <http://gazetadielli.com/>, 30 nëntor 2013

pavarur njëhej brenda territoreve ku kishte shqiptarë, gjegjësisht, të katër vilajetet e përbënin Shqipërinë.

Fatkeqësisht kjo pavarësi e plotë nuk u gëzua gjatë kohë, ngase pas tre muaj, me lobimin e serbëve dhe diplomacinë e tyre që bënin tek Rusia, këtë të fundit e detyruan që të bëjë presion në Konferencën e Ambasadorëve në Londër dhe si rezultat i këtij presioni nga rusët, me 22 mars 1913, ndryshoi gjithçka për shqiptarët, pavarësia e Shqipërisë u suprimua duke reformur projektin e pavarësisë, vendim ky që ishte në dëm të shqiptarëve. Nga ky moment, u mor vendim nga Fuqitë e Mësha në Londër që Shqipëria të copëtohej në dobi të shtetit serb, Greqisë dhe Malit të Zi, dhe si e tillë të figurojë ndërkombëtarisht vetëm brenda kufijve që sot e njohim.

Diplomacia osmane edhe pse tregoi paaftësi të madhe në këtë rast, edhe më tej nuk pranoi një vendim të tillë që do t'i largonte përgjithmonë forcat osmane nga Shqipëria,

Edhe më tej "qeveria e Vlorës filloi të ndiqte një politikë afrimi me Stambollin. Në një intervistë që Ismail Qemali dha për gazetën italiane "Giornale d'Italia", deklaroi se marrëdhëniet e Shqipërisë me Perandorinë Osmane ishin krejtë paqësore. Në Vlorë, -deklaroi ai,- kemi marrë një njoftim zyrtar të Vezirit të Madh, i cili e njeh pavarësinë e Shqipërisë dhe të drejtën që të kemi flamurin tonë. Qeveria osmane kishte njoftuar mytesarrifin e Beratit se ajo tani njohte pavarësinë shqiptare dhe kishte kërkuar nga autoritetet ushtarake që kishin mbetur në Shqipëri të respektonin flamurin shqiptar.¹³⁷"

¹³⁷Hasan Bello, po aty, f. 33

Përfundim

Studimi i ngjarjeve historike në aspektin diplomatik, mendoj që është nevojë e kohës në të cilën jetojmë. Lehtë ndoshta do të dinim ngjarjet historike por megjithatë nuk do të mundemi të japim një pasqyrim të ngjarjeve thellësisht pa mos u futur në detaje, konkretisht analizuar në aspektin diplomatik, dhe kjo ka qenë dhe detyra jonë, që ngjarjet historike, një periudhë mjaftë komolekse siç është periudha osmane në trojet shqiptare, të analizojmë duke e futur politikën dhe diplomacinë në zbërthimin e atyre ngjarjeve historike, me theks të veçantë, shtetit osman në hapësirat shqipëtare.

Studimi i ngjarjeve historike në mënyrë sipërfaqësore, paraqet vështirësi serioze për të arritur tek realja, tek e vërteta e dëshiruara, mu për këtë, në mungesë të studimeve serioze, informacioneve të pamjaftueshme, ndërtohet një e ardhme historike e një shteti apo kombi me argumente ireale dhe mite, e në fakt historia dhe e kaluara e një kombi duhet ndërtuar mbi bazën e argumenteve dhe figurave reale, e jo miteve dhe personazheve inegzistente, e fatkeqësisht ngjarjeve të paqena ndonjëherë.

Konsideroj që historia e popullit shqiptarë ka nevojë për një shtjellim serioz në një këndvështrim më kritik, duke i përdorur analizat politike dhe diplomatike përmes së cilave do të arrijmë të një epilog më korrekt i ngjarjeve.

Gjatë leximit të literaturës së përdorur për punimin e studimit tim, konstatoj që historisë së popullit shqiptarë i nevojitet një kapitull shtesë mbi jetën, veprimtarinë dhe aktivitetet e shqiptarëve gjatë periudhës osmane në hapësirat shqiptare, dhe kjo nuk do të arrihet ndryshe apo thënë më mirë, nuk do të mund të arrijmë tek e vërteta e dëshiruar pa ju qasur seriozisht dhe në mënyrë analitike ngjarjeve të periudhës osmane në hapësirat shqiptare, me një kujdes të madh dhe një paanësi absolute, fundja, nuk do ta ketë jetën e gjatë një histori e cila shkruhet mbi bazën nacionaliste ekstreme dhe të një anëshme.

- Sugjerojmë që hulumtimet lidhur me raportet, çështja shqiptare-shteti osman, të trajtohen nga një prizëm tej ideologjik, lirshëm nga sfondi i botëkuptimeve të ngarkuara pesë shekullore konformiste.
- Historia e afërt, të merret si bazë për ndërtimin e qëndrimeve diplomatike në raport me trashiguesin kryesorë të shtetit osman.
- Duke parë antagonizmat e shumta që dalin në pah kohëve të fundit në mesin e studjuesev, historianëve në trojet shqiptare, për disa ngjarje apo figura me rëndësi historike, rekomandoj që të punohet në drejtim të unifikimit të ideve dhe qëndrimeve hulumtuese, për të mos hamendur lexuesin shqiptar.
- Rekomandoj që institutet e specializuara për trashëgimi historike dhe politike në trojet shqiptare, të investojnë më shumë në një projekt i cili do të formonte grup specializantësh të politikave osmane, respektivisht të sundimit qindra vjeçarë osman në trojet shqiptare, të cilët specializant do të merreshin me hulumtimet dhe përkthimet e dokumenteve nga osmanishtja në gjuhën shqipe, nëpër arkivat e turqisë, ku të cilat dokumente do të na ndihmonin për ta kuptuar më drejtë veprimtarinë e shtetit osman

në Ballkan. Duke parë që dokumentet nëpër arkiva osmane numërojnë mbi dhjetëra mijra sosh, është e rugës që shteti të investoj njerëz specializantësh të fushës në fjalë.

- Jemi të vetëdijshëm që e kaluara jonë historike gjendet nëpër të gjithë arkivat evropiane, sugjerojmë që gjatë hulumtimeve arkivore të fokusohen kryesisht nëpër institutet evropiane, qoftë në Stamboll, Vienë, Bukuresht, apo Vatikan që njihen si historishkruesit më të mëdhenjë të së kaluarës në Evropën Perendimore.
- Shpeshherë njeriu është armiku më i madh i asaj që nuk e njeh, apo servuar gabimisht paraqitja e saj, si duket një gjë e këtillë mendoj se ka ndodhur edhe më paraqitjen e shtetit osman në historiografin shqiptare. E kemi parasyshë që tek shqiptarët Perandoria Osmane ka qënë një kob i zi që ka pushtuar trojet shqiptare dhe në vazhdimësi ka shkatërruar ato, në anën tjetër kemi një kategori intelektualësh dhe studjuesish që e thonë të kundërtën, duke u argumentuar me argumente të shumë anëshme, nga më të ndryshmet, rekomandoj që të rishikohet një pjesë e historisë së popullit shqiptar nga të dy palët, pro-kontra, duke i gërrshetur argumentet e tyre, por gjithësesi të jenë në tavolinat e tyre të punës dhe dokumentacioni arkivor osman i përkthyer me qëllim që ta nxjerrim të vërtetën e disa kundërshtimeve apo thënë shkurtë, mendimeve ndryshe që kanë filluar të paraqiten së fundi tek shqiptarët. Dhe kjo të bëhet për hirë të së vërtetës së kaluar, dhe gjeneratave që do të vijnë tu dorëzohet historia reale e popullit shqiptar, me pjesën më delikate të epokës osmane në Ballkan.
- Sugjeroj që ngjarjet me rëndësi historike të trajtohen në dimensionin politik dhe diplomatik, të nxirren konkluzione të sakta për ngjarjet dhe qëllimet apo kërkesat politike të asaj kohe, me theks të veçant, takimet e intelektualëve shqiptar, roli i rilindësve në atë periudhë jo të lakmueshme të shqiptarëve në momentin e zbehjes së shtetit osman.
- Ajo çka neve duhet të na nevojitet më shumë për tu trajtuar është, pozita dhe përgjegjësia e intelektualëve shqiptarë në udhëheqjen e shtetit osman, duke e ditur se Perandoria Osmane është udhëhequr dhe nga shqiptarët për një kohë të gjatë, hierarkia politike, udhëheqëse e tyre nëpër të gjitha nivelet e shtetit osman. Cila është pozita e tyre tek historiografia shqiptare, a duhet të jenë tradhëtar të kombit apo burrështetas të fuqishëm që kanë lënë gjurmë të fuqishme në evropë si udhëheqës të një perandorie të fuqishme evropiane. E themë këtë, ngase kur shfletojmë literaturën nga arkivi osman, na dalin që shqiptarët kanë udhëhequr me perandori më shumë se turqët, afërsisht 44 apo më pak së kaq kryeministra kanë qënë shqiptarë, ndërsa flitet për një numër tepër të vogël të kryeministrave turq, 8 apo 9 të jenë nga ta. Mendoj që personalitetet shqiptare në shtetin osman të kenë të definuar statusin e tyre tek historiografia shqiptare. Por nuk mendoj që të jemi dakord me epitetet më të këqia të quhen paraardhësit tanë, stërgjyshërit tanë, sepse dashtëm apo nuk dashtëm ne jemi loza e tyre sot.

BIBLIOGRAFIA

1. MANTRANIT, Robert, BACQUE GRAMMONT, Jean-Louis, BAZIN, Louis, BELDICEANU, Irene, BELDICEANU, Nicoara, DUMONT, Paul, GEORGEON, François, MANTRAN, Robert, RAYMOND, Andre, ROUX, Jean-Paul, VATIN, Nicolas, VEINSTEIN, Gilles, *Historia e Perandorisë Osmane*, perktheu: Prof. Asti PAPA, Dituria, 2014

3. INALCIK, Halil, *Perandoria Osmane: Periudha klasike 1300-1600*, perktheu: Edvin Cami, Dituria, Tiranë, 2013.

4. DUKA, Ferit, *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare*, studime dhe dokumente, UET Press, 2009

5. MAKSUDOGLU, Prof. Dr. Mehmet, *Historia Osmane dhe Institucionet*, perktheu: Enilda Meidani, Tiranë, 2013

6. BARTL, Peter, *Ballkani Perëndimor midis monarkisë spanjolle dhe Perandorisë Osmane*, perktheu: Pëllumb Xhufi, Dituria, 2011

7. Vilajeti i Kosovës në dokumentet arkivore osmane, Republika e Turqisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Shtetërore të Qeverisë së Turqisë, Departamenti i Arkivave Osmane, Stamboll, 2007

8. DURHAM, Edith, *Brenga e Ballkanit*, Tiranë, 2001

9. ORTAJLLË, Ilber, *Shekulli më i gjatë i Perandorisë*, Logos-a, 2010

10. BERISHA, Arbër, *Toleranca Osmane dhe Shqiptarët*, Prishtinë, 2012

11. SULSTAROVA, Enis, *Ligjërime nacionaliste në Shqipëri dhe studime të tjera*, Botimi i Dytë, Tiranë, 2015

12. GAWRYCH, George, *Gjysëmehëna dhe Shqiponja, Bota Shqiptare*, Tiranë, 2007

13. SALABI MUHAMED, Ali, *Perandoria Osmane, faktorët e ngritjes dhe rënies së saj*, Fjala e Bukur, Prishtinë, 2009

14. MUHAREMI, Amir, *Turqia*, Botime, Artini, 2014

15. ORTAYLI Ilber, *Paqja Osmane*, perktheu: Altin Qefalia, Logos-a, 2015

16. LOKA, Nikollë, *ARNAUTOMANIA: 44 Kryevezirë dhe 170 vjet qeverisje shqiptare në Perandorinë Osmane*, Botues, GEER

17. ÇAKIR, Coskun, *Civilizimi Osman*, Logos-a, 2014
18. SKENDI, Stavro, *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912*, Phoenix, Shqipëri, 2000
19. SCHMITT JENS, Oliver, *Shqiptarët, një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*, Tiranë, 2012
20. BUXHOVI, Jusuf, *Nga shqipëria Osmane te Shqipëria Evropiane*, Faik Konica, Prishtinë, 2010
21. BUXHOVI, Jusuf, KOSOVA, *Perandoria Osmane*, Faik Konica, Prishtinë, 2012
22. GAÇE, Bardhosh, *Ata që shpallën Pavarësinë Kombëtare*, Toena, 2012
23. *SHQIPËRIA në dokumentet Austro-Hungareze 1912*
Vëllimi 1, META, Beqir, GJERMANI, Sokol
Vëllimi 3, KABA, Hamit, META, Beqir
Vëllimi 4, LALAJ, Ana, KAMBO, Eriket, BOÇI, Sonila
Vëllimi 5, META, Beqir, DEZHGIU, Muharrem, MUSAJ, Fatmir
Vëllimi 7, VERLI, Marenglen, DUSHKU, Ledia, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Botime Albanologjike
24. Abdyli, Porf. Ramiz, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, Libri 1, Instituti i Historisë Prishtinë, 2014
25. RAHIM, Shukri, *Lufta e shqiptarëve për autonomi 1897-1912*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1978
26. Qemali, Ismail, *Kujtimet*, Toena, Tiranë, 2009
27. Bozborra, Nuray, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Tiranë, 2002
28. FRASHËRI, Kristo, *Historia e qytetërimit shqiptar: nga kohët e lashta deri në fund të Luftës së Dytë Botërore*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008
29. BELLO, Hasan, *Marrëdhëniet Shqiptaro-Turke 1912-1939*, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, Tiranë, 2015
30. CANA, Zekeria, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912*, Rilindja, 1979, Prishtinë

31. PLLANA, Emin, *Kosova dhe reformat në Turqi*, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1978
32. Vreto, Jani, *Vepra të zgjedhura*, Tiranë, 1972
33. Ibrahim D. Hoxha, *Nëpër udhën e penës shqiptare: nga historiku i ABC-së dhe i shkrimit shqip*, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1986
34. Osmani, Shefik, Kazazi, Niazi, *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*, Shkodër, Idromeno, 2000
35. BLAKAJ, Skënder, ISMAILI, Ismail, *Letërkëmbime të rilindjes kombëtare shqiptare*, Arbi Ltd Prishtinë dhe Vatra New York, 2014
36. IKONOMI, Ilir, *Pavarësia, udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit*, UET Press, 2012
37. VLORA, Eqrem, *KUJTIME 1885-1925*, Botimi i Tretë, Tiranë
38. Belegu, Xhafer, *Lidhja e Prizrenit*, Tiranë, 1939
39. BARTL, Peter, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare 1878-1912*, Dituria, 2016
40. DEMIRAJ, Shaban, PRIFTI, Kristaq, *Kongresi i Manastirit, Akademia e shkencave e Shqipërisë*, Instituti i Historisë, Tiranë, 2008
41. EGRO. Dritan, *Historia dhe ideologjia*, Tiranë, 2007
42. Luli, Faik, Islam Dizdari, *Hafiz Ali Ulqinaku-jeta dhe veprat*, Shkup: Logos-A, 2005
43. Hysa, Mahmud, *Alamiada shqiptare*, vëll.I, Shkup: Logos-a, 2000,
44. *Zëri i Popullit*, nr.136, 8.6.1978
45. *Veteranët e Klerit Mysliman, Zani i Naltë*, nr.11, Nanduer, 1937
46. Hafiz Ali Korça, *Pasqyrë atdhetarizme për brezin e ri*, *Kultura Islame*, nr.3-4, nëntor-dhjetor, 1941
47. Voka, Rexhep, Tetova, *Mendime*, Tetovë: Këshilli i Bashkësisë Islame, 1991, (Transkriptimi dhe përshtatja në gjuhën e sotme shqipe u realizua nga dr.Feti Mehdiu). Kjo vepër është botuar për herë të parë në Stamboll në vitin 1910.

48. Vaso, Pashko, *E vërteta për Shqipërinë dhe Shqiptarët*, Paris, 1879, (përkthyer nga gjermanishtja, Skënder Maçi,
49. Zenelaj, Eqrem, *Diplomacia e Ismail Kemal Bej Vlorës, rivalitetet e brendshme në Shqipëri dhe rruga e Pavarësisë 1912-1923*, Vatra, Prishtinë, 2013
50. Fishta, Gjergj, *Lahuta Malsisë*, Gjergj Fishta,
51. *Figura e Ali Pashës*. Grup Autorësh Tiranë, 2002
52. Ali Arslan, *Darülfünun‘dan Üniversiteye*, Istanbul: Kitabevi, 1995
53. Haxhiu, Ajet, *Hasan Prishtina*, Tiranë, 1981

Burime nga interneti

1. <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=24691>
2. <https://www.youtube.com/ëatch?v=tp4C1Ipgvxo>
3. <https://fr-fr.facebook.com/notes/islami-feja-e-vërtetë/arsyeja-e-kryengritjes-shqiptare-ishin-xhonturqit/10150099314697196/>
4. https://sq.m.wikipedia.org/wiki/Traktati_i_Shën_Stefanit
5. <http://www.albasoul.com/modules.php?op=modload&name=News&file=article&sid=715>
6. <http://bashkiaberat.gov.al/?p=2749>
7. <http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=1314>
8. https://sq.wikipedia.org/wiki/Sami_Frashëri
9. <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=4352>
10. <http://telegrafi.com/isa-boletini-mohikani-i-fundit/>
11. <https://www.youtube.com/watch?v=zdojbe4JUeE>
12. <http://www.tiranaobserver.al/news-item/perandoria-osmane-si-nisi-dhe-pse-u-rrezua/>
13. <https://www.youtube.com/watch?v=Y92YoB89eVI>
14. <https://www.youtube.com/watch?v=Y92YoB89eVI>
15. http://www.radioislame.com/index.php?frame_rd=artikulli.php?id=521
16. <http://www.forumivirtual.com/personalite-t-shquara-shqiptare-63/hoxhe-hasan-tahsini-61551/>
17. <http://shqiptarja.com/aktualitet/2731/7-marsi-126-vjet-nga-mesonjetorja-e-pare-shqipe-ne-korce-146429.html>
18. <http://www.lajmeshqip.com/kultura/mesonjtorja-e-pare-shqipe-ne-korce-pionere-e-arsimit-kombetar>
19. <http://www.germ-a.com/?p=1921>
20. [https://www.shqiperia.com/%C3%87elja-e-shkollave-shqipe-dhe-perhapja-e-mesimit-shqip-\(korrik-nentor-1908\).367](https://www.shqiperia.com/%C3%87elja-e-shkollave-shqipe-dhe-perhapja-e-mesimit-shqip-(korrik-nentor-1908).367)
21. <http://www.albeu.com/biografia-kush-eshte/kush-ishin-39-kryeministrat-shqiptare-te-perandorise-osmane/110018/>

22. https://sq.wikipedia.org/wiki/Mësonjëtorja_e_Korçës
23. <http://www.albaniapress.com/lajme/15224/Kongresi-i-Manastirit-1908.html>
24. <http://www.albaniapress.com/lajme/15224/Kongresi-i-Manastirit-1908.html>
25. <http://shqiptarja.com/aktualitet/2731/7-marsi-126-vjet-nga-mesonjetorja-e-pare-shqipe-ne-korce-146429.html>
26. <http://www.radiokosovaelire.com/hoxhe-hasan-tahsini-1811-1881-rilindes-atdhetar-filozof-dhe-matematikan-shqiptar/>
27. <https://www.youtube.com/watch?v=p9llgOFBmiw>
28. <https://www.youtube.com/watch?v=p3Pu1vmNVU0>
29. <http://www.ikub.al/Shkolla/15/05/07/Rrenjet-e-shtetit-osman-0133.aspx>

Revista elektronike

1. <http://www.albeu.com/biografia-kush-eshte/kush-ishin-39-kryeministrat-shqiptare-te-perandorise-osmane/110018/>
2. <http://koha.net/?id=4&l=5888>
3. <http://koha.net/?id=4&l=102928>
4. <http://gazetadielli.com/>, 30 nëntor 2013

Mediumet e shkruara

1. Gazeta: Bota Sot", 17 nëntor 1998
2. Zani i Naltë, Prill 1937.
3. Revistën "Paqja", nr. 10, 2007
4. Gazeta, SHEKULLI, 16 Gusht 2012
5. Gazetën "Rimëkëmbja", 18 Prill 2000, Tiranë
6. Revista, SHENJA, shtator 2012
7. The New York Times, 31 December 1911